



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Punë Sociale”

ofruar nga

Kolegji Universitar “LOGOS”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc.Dr. Fiona Todhri

Dr. Eris Dhamo Greca

Maj / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Bachelor në: “Punë Sociale”

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “LOGOS”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Punë Sociale
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS Nr.455, datë 26.07.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike, 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	- 2022-2023 7 PAE / 2 PAK; - 2023-2024 9 PAE / 15 PAK; - 2024-2025 11 PAE / 5 PAK;
18	Numri i studentëve:	- 2022-2023 5 studentë; - 2023-2024 5 studentë; - 2024-2025 11 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "LOGOS" është një Institucion i Arsimit të Lartë i cili ofron një larmi programesh studimi. Në vitin 2009 Instituti i Formimit Profesional "Frymë Dashurie" u shndërrua në Shkollë të Lartë Private "Logos" përmes VKM-së nr. 1055 datë 29.07.2009 në përbërje të së cilës kishte dy fakultete: Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Fakultetin Ekonomik. Pas miratimit të Ligjit 80/2015, "LOGOS" u njoh si Kolegj Universitar jo fitimprurës. Kolegji Universitar "LOGOS" është person juridik privat i njohur nga Legjislacioni Civil dhe tregtar Shqiptar, i regjistruar në regjistrin e organizatave jofitimprurëse me Vendim Nr. 284, datë 26.06.2008, dhe Vendim Nr. 184/1, datë 22.06.2011 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, në emër të Fondacionit "LOGOS". Aktualisht Kolegji Universitar "LOGOS", përbëhet nga tre fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor;
2. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara;
3. Fakulteti Ekonomik;

Propozimi për hapjen e programit "Punë Sociale" mbështetet në vendim Nr. 1, datë 27/09/2021, që administrohet nga Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor të Kolegjit Universitar Logos. Ky program është licensuar në bazë të Urdhërit të MAS Nr.455, datë 26.07.2022.

Programi i studimit bachelor në "Punë Sociale" realizohet me 180 kredite (ECTS), në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në gjuhën shqipe, e në përfundim të tij lëshohet diplomë bachelor në "Punë Sociale". Programi i studimit Bachelor në "Punë Sociale" është kodifikuar sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe europiane (Niveli 6 i Kornizës Shqiptare dhe Europiane të Kualifikimit). Ky program studimi është organizuar sipas ndarjes ku përfshihen lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese të programit, lëndë ndërdisiplinore/integruese, si dhe lëndët plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, ku si pjesë e të cilit është përmes përgatitjes së mikroteze dhe provimit të përgjithshëm përfundimtar. Numri i studentëve të regjistruar në programin e studimit bachelor "Punë Sociale" për vitin akademik 2022-2025 është 21.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Qëllimi i këtij vlerësimi për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Punë Sociale” është vlerësimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të cilat janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”. ASCAL bazuar në manualin “Për procedurën dhe afatet për vlerësimin e cilësisë për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit” ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga IAL, për të kryer vizitën në institucion si dhe për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm për këtë program studimi. Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) përbëhet nga: **Prof. Asoc. Dr. Fiona Todhri**, dhe **Dr. Eris Dhamo / Greca**. Gjatë gjithë etapave të punës për realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm ky grup u asistua nga koordinatori teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirmeli.

Vizita dy ditore në IAL u realizua në datat 21-22 Tetor 2024, ku GVJ realizoi të gjitha takimet e parashikuara, duke respektuar axhendën e vizitës në IAL. Gjatë ditëve të vizitës GVJ zhvilloi takime me, Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Përgjegjësin e Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi (*efektiv dhe me kontratë*); studentët e programit të studimi, dhe përfaqësues të Zyrave të Kolegjit. GVJ gjithashtu vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi nga afër mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj.

Gjatë takimeve të realizuara sipas axhendës u shqyrtuan çështje të ndryshme, që lidhen me vlerësimin e programit të studimit *Bsc në “punë Sociale”*, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga dosja e vetëvlerësimit. Krahas këtyre u shfrytëzuan edhe informacioni i depozituar në sistemin e menaxhimit të informacionit të ASCAL si dhe informacioni i vënë në dispozicion gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në IAL. Në përfundim të këtij procesi GVJ dorëzoi Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm në ASCAL. Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion, si dhe gjithë informacionin e mbledhur gjatë vizitës, GVJ arriti në konkluzionet se standardet për të gjitha fushat e vlerësimit përmbushen plotësisht. GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

Kolegji Universitar “LOGOS” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 16.04.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 62/14. Prot, datë 16.04.2025. Kolegji Universitar “LOGOS” njofton më datë 24.04.2025 nëpërmjet shkresës me Nr. 95/1. Prot, datë 23.04.2025 “*Kthim përgjigje shkresës tuaj, Nr. 62/14, datë 16.04.2025 për draft raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Bachelor në Punë Sociale*” ku shprehen se janë dakort me vlerësimin e ekspertëve dhe se janë të predispozuar të reflektojnë mbi sygjerimet e GVJ-së, për përmirësimin e mëtejshëm të programit. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Punë Sociale”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Kolegji Universitar “LOGOS” mbështetur në dokumentacionin e paraqitur vërehet se zotëron mekanizma të qartë në raport me funksionimin dhe organizimin e programit të studimit në përputhje me Statutin e tij të brendshëm miratuar me Vendimin Nr. 4/1, datë 28.01.2021 të Senatit Akademik dhe Vendimin Nr. 4, datë 27.01.2021 të Bordit të Administrimit, si dhe Rregulloren e KU “LOGOS”, e hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Kjo evidentohet në Statutin ¹ dhe Rregulloren ² e institucionit, si dhe atë të programit të studimit ³ që mbështetet në misionin dhe qëllimet e tij dhe në linjë me gjithë kuadrin ligjor të vendit për arsimin dhe shkencën. Propozim për hapjen e programit punë sociale, Vendim Nr. 1, datë 27/09/2021 ⁴
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Vërehet se program i studimit bachelor në “Punë Sociale” është hartuar në frymën e Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ⁵ si dhe në përputhje me politikat e brendshme të institucionit dhe nevojave social-ekonomike të vendit. Programi i studimit BA “Punë Sociale” është në përputhje me qëllimet dhe misionin e KU “LOGOS” dhe janë të integruara në linjë me fushën e studimit brenda njësisë bazë të tij.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet	Evidentohet se programi i studimit është hartuar në frymën e kuadrit ligjor dhe në përputhje me politikat e brendshme të

¹ Aneks 1 Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

² Aneks 14 Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

³ Aneks 6 Të dhëna mbi programin e studimit

⁴ Aneks 41 Propozim për hapjen e programit punë sociale, VENDIM Nr. 1, datë 27/09/2021

⁵ <https://arsimi.gov.al/ligji-nr-80-2015-per-arsimin-e-larte-dhe-kerkimin-shkencor-ne-institucionet-e-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-shqiperise-dhe-aktet-nenligjore-ne-zbatim-te-tij-2>

në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.

Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

institucionit dhe nevojave social-ekonomike të vendit. Programi i studimit është në përputhje me qëllimet dhe misionin e KU “LOGOS” dhe janë të integruara në linjë me fushën e studimit brenda njësisë bazë të tij. *Neni 2* në Rregulloren e Institucionit⁶ shpalos gjithë kuadrin ligjor të vendit ku mbështetet, si Ligji i AL, VKM, Udhezime, Statut të IAL-s⁷, etj. Në *Nenin 3* të po kësaj rregulloreje, përcaktohet dhe Fusha e Veprimit mbi të gjitha njësitë përbërëse të institucionit, personelit akademik, ndihmës akademik, atij administrativ si dhe studentët.

Programi i studimit në Punë Sociale ofrohet nga Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor të Kolegjit Universitar Logos. Referuar dokumentacionit të paraqitur dhe vizitave të drejtëpërdrejta në institucion, si dhe takimin me stafin akademik, vërehet se KU “LOGOS” ka infrastrukturën dhe kapacitete burimore të mjaftueshme për ofrimin e programit. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2023-2024 ka gjithsej 64 pedagogë, nga të cilët 24 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 40 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor	
	PAE	PAK
Prof.Dr	2	1
Prof.Asoc	4	6
Dr/PhD	10	21
Msc	8	12
Gjithsej	24	40

Ndërsa Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë, si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit për vitin akademik 2023-2024, ka këtë paraqitje:

Kualifikimi i stafit	Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë	
	PAE	PAK
Prof.Dr	1	1
Prof.Asoc	3	1
Dr/PhD	2	7
Msc	3	5

⁶ Aneks 14 Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

⁷ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

6

	Gjithsej	9	14
	<i>Për sa më sipër <u>GVJ</u> sygjeron që institucioni duhet të angazhohet që të rrisi gamën e profesoratit në fushën përkatëse, atë të punës sociale.</i> Disiplina e Punës Sociale është e mbështetur dhe në disiplina të tjera si Sociologjia, Psikologjia, Shkencat Humane, dhe siç pasqyrohet tek aneks 17, profesorët në këto disiplina janë të përfshirë, ato që mungojnë janë ato në fushën e Punës Sociale, të cilët duhet të mbulojnë lëndët me karakter profesional si: Intervistim dhe Këshillim në Punë Sociale, Sjellja Njerëzore dhe Mjedisi Social, Metoda dhe Shprehi në Punë Sociale.		
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor. Fakulteti ka tre departamente dhe ofron tre programe studimi. Departamenti i "Theologjisë dhe Kulturës", Departamenti i "Gjuhës dhe Civilizimit Grek", Departamenti i "Pedagogjisë dhe Psikologjisë"^{8,9,10,11},¹² është përgjegjës për programin Bachelor në "Punë Sociale". Programi i studimit Bachelor në "Punë Sociale" ofrohet si program me kohë të plotë dhe është kodifikuar sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe europiane (Niveli 6 i Kornizës Shqiptare dhe Europiane të Kualifikimit). Kohëzgjatja 3 vjet me (180 ECTS)¹³. <i>Shih neni 14 Krediti dhe llogaritja e tij.Rregullore përorganizimin e programit të studimeve ne "Punë Sociale"</i>¹⁴. Senati akademik ka miratuar udhëzimin për kodifikimin e lëndëve mësimore të programeve të studimit të ofruara nga KU Logos në zbatim të VKM 41datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL"¹⁵. GVJ vlerëson se Programi Bachelor në "Punë Sociale" është organizuar dhe strukturuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit duke respektuar kërkesat		

⁸ Aneks 21 Vendimi nr 2 Senati Akademik, dt 04.02.2020,

⁹ Aneks 21 Ibid

¹⁰ Aneks 1 Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

¹¹ Aneks 6 Të dhëna mbi programin e studimit

¹² Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

¹³ Aneks 6 Të dhëna mbi programin e studimit

¹⁴ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

¹⁵ Aneks 11 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016

	e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore në fuqi. Klasifikimi/kodifikimi i programit të studimit është kryer sipas direktivave dhe udhëzimeve në fuqi për IAL. Lëndët e programit të studimit janë të koduara sipas përcaktimeve ligjore.			
Konkluzione	-GVJ gjykon se përmbushja e standartit është e garantuar me dokumentacionin dhe mekanizmat që rregullojnë veprimtarinë e institucionit. -KU“LOGOS” ofron programe studimi në përputhje me interesat kombëtare dhe synon të ruaje vlerat akademike kulturore kombëtare; -Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor. -Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, që është të krijojë, zhvillojë dhe përcjellë dije përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të formojë specialist të lartë dhe shkencëtarë të rinj; -KU“LOGOS ka kapacitete intelektuale me personel akademik të kualifikuar dhe me përvojë infrastrukturore për të realizuar aktivitetet edukative dhe kërkimore shkencore, megjithatë, GVJ sygjeron që institucioni duhet të angazhohet që të rrisi gamën e profesoratit në fushën përkatëse, atë të punës sociale; -KU“LOGOS ka ambiente të mjaftueshme për zhvillimin e proceseve mësimore, kërkimore, laboratorike, etj;			
Shkalla e përmbushjes së standartit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të	IAL, KU “LOGOS”, për mbarëvajtjen e programit ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit, e cila sigurohet se pari nga rregulloret dhe

frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	dokumentet ekzituese si Statuti¹⁶, Rregullore e IAL-së¹⁷, Rregullore e Njësive të "Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor"¹⁸, Rregullore e programit të studimit në "Punë Sociale"¹⁹. Rregullore e zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Arkivit të Zyrës së Protokollit²⁰, Rregullore e Bibliotekës KU LOGOS²¹, Rregullore për Njësine e Sigurimit e Brendshëm të Cilësisë të Standarteve²², Rregullore e departamentit pedagogji psikologji²³ ku bën pjesë dhe programi i studimit në Punë Sociale. Institucioni ka një organizim të strukturave funksionale e cila është në formë piramidale dhe orientohet nga parimi i bashkëpunimit dhe kontrollit. Organograma e Kolegjit Universitar LOGOS²⁴ Stafi duket se ka ndërtuar një frymë bashkëpunimi institucional, kjo vihet re tek raporti vjetor i departamentit²⁵ si dhe tek raportimet mujore me e mail prane Shefit te Depatamentit²⁶ si dhe Raport Vjetor për Veprimtarinë e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Kolegjit Universitar "LOGOS" për vitin Akademik 2023-2024²⁷
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga IAL si dhe nga vizitat në institucion, takimi me drejtues dhe me stafin akademik, studentët u konstatua se KU LOGOS, për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve ka vendosur marrëdhënie të shumta dhe të konsoliduara bashkëpunimi me institucionet homologe si brenda dhe jashtë vendit. Ne vijim verifikohen një numër i caktuar i këtyre marrëveshjeve, të cilat ju vijnë në ndihmë si stafit dhe studentëve të programit të studimit. Lista e marrëveshjeve në programin Punë Sociale²⁸, Marrëveshje Bashkëpunimi me Fakultetin e Shkencave Sociale, UT, Fakulteti i Gjuheve te Huaja UT, Albanian University, Universiteti Marlin Barleti²⁹, Marrëveshjet me Universitet

¹⁶ Aneks 1 Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

¹⁷ Aneks 14 Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

¹⁸ Aneks 11 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016

¹⁹ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

²⁰ Aneks 124 Rregullore e Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Arkiv-Protokollit.

²¹ Aneks 136 Rregullore Bibliotekës së K.U. "Logos"

²² Aneks 151 Rregullore për Njësine e Sigurimit e Brendshëm të Cilësisë të Standarteve

²³ Aneks 200 Rregullore e departamentit pedagogji psikologji

²⁴ Aneks 61 Organograma e Kolegjit Universitar LOGOS

²⁵ Aneks 34 Raporti Vjetor i DPP, 2023-2024 / Analiza e kontributit ne program praktikës mësimore

²⁶ Aneks 188 Raportim mujor me e mail prane Shefit te Depatamentit

²⁷ Aneks 48 Raport Vjetor për Veprimtarinë e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Kolegjit Universitar "LOGOS" për vitin Akademik 2023-2024

²⁸ Aneks 19 Lista e marrëveshjeve në programin Punë Sociale

²⁹ Aneks 27 Marrëveshje Bashkëpunimi me Fakultetin e Shkencave Sociale, UT, Kolegji Universitar Wisdom, Fakulteti i Gjuheve te Huaja UT, Albanian University, Universiteti Marlin Barleti

	Homologe ³⁰ , Marrëveshja e KU Logos me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për stafin akademik ³¹ . Marrëveshja me akreditimin ndërkombëtar ³² , Lista e marrëveshje të partneritetit në funksion të programit të studimit ³³ , Axhenda nga aktiviteti Erasmus për pjesëmarrjen në Universitetin e Patrës ³⁴
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Për realizimin e programit të studimit, KU LOGOS ka nënshkruar disa marrëveshje të posaçme, të cilat duken afatgjata e të qëndrueshme me institucione të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, si më poshtë: Marrëveshja me: Shkollën 9 -vjeçare “Njazi Mastori”, Sukth; Qendrës Rinore Peshkopi, Qendrës “ALO 116111- Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë” Tiranë, Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Fier. ³⁵ , Panairi Work and Study foto ³⁶
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Referuar bazës së dokumentacionit të paraqitur nga IAL, verët se në mënyrë periodike, fakulteti dhe departamenti përgjegjës për programin e studimit Punë Sociale harton disa raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Raporti Vjetor i DPP, 2023-2024 / Analiza e kontributit në program praktikës mësimore ³⁷ , i cili jep informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Gjithashtu në Raport për trajnimin në Universitetin Mesdhetar në Podgoricë, Mali i zi, Qershor, 2024 ³⁸ flitet mbi mobilitetin e stafit dhe të studentëve projekt i finacuar nga BE në kuadër të programeve Erasmus. IAL ka hartuar dhe një Rregullore për Praktikën Mësimore Pasive në Arsimin e Lartë ³⁹ , (duhet specifikuar programi dhe fusha e studimit)
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i>

³⁰ Aneks 29 Marrëveshjet me Universitet Homologe

³¹ Aneks 55 -Marrëveshja e KU Logos me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për stafin akademik

³² Aneks 74 Marrëveshja me akreditimin ndërkombëtar

³³ Aneks 196 Lista e marrëveshje të partneritetit në funksion të programit të studimit

³⁴ Aneks 204 Axhenda nga aktiviteti Erasmus për pjesëmarrjen në Universitetin e Patrës

³⁵ Aneks 33 Marrëveshja me: Shkollën 9 -vjeçare “Njazi Mastori”, Sukth; Qendrës Rinore Peshkopi, Qendrës “ALO 116111- Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë”, Tiranë, Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Fier

³⁶ Aneks 167 Panairi Work and Study foto

³⁷ Aneks 34 Raporti Vjetor i DPP, 2023-2024 / Analiza e kontributit në program praktikës mësimore

³⁸ Aneks 35 Raport për trajnimin në Universitetin Mesdhetar në Podgoricë, Mali i zi, Qershor, 2024

³⁹ Aneks 43 Rregullore për Praktikën Mësimore Pasive në Arsimin e Lartë

	- Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit. Rregulloret e Institucionit, njësisë kryesore dhe të organeve të tjera rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet strukturave brenda institucionit; - KU LOGOS ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, dhe palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit dhe në kuadër të aftësimit profesional, si dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit "Punë Sociale"; - Nëpërmjet marrëveshjeve institucioni është më pranë tregut të punës, kërkesave të tregut të punës dhe do të mundësojë realizimin e praktikave mësimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi	Dokumentacioni që shoqëron procesin e organizimit të këtij program studimi në Punë Sociale, përmban të plotë elementët e nevojshëm që lidhen me objektivat formuese, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen dhe gjithashtu janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Bazuar në Statutin e Kolegjit Universitar LOGOS ⁴⁰ , Kreu IV,

⁴⁰ Aneks I Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Organizimi i Studimeve, <i>neni 28 pika 1</i>, Ciklet dhe Programet e Studimeve: KU LOGOS, ofron programe të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), pika 2. Numri i krediteve të të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite. Gjithashtu në nenin 29 Programet e ciklit të parë të studimeve pika 1, organizohen në jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tre vite akademike. Mbështetur në VENDIM Nr. 1, datë 27/09/2021⁴¹, Propozim për hapjen e programit punë sociale, pika 1, 2, 3 ku pasqyrohet kohëzgjatja 180 kredite, veprimtaria formuese është në përputhje me VKM nr 41 të ndryshuar për secilin nga prej drejtimit të studimit të grupohen në 5 kategori: a) Lëndë Bazë të Detyrueshme 29 Kredite; b) Lëndë Karakterizuese 97 Kredite; c) Lëndë Ndërdisciplinore 27 Kredite; d) Lëndë Plotësuese 23 Kredite; e) Detyrime Përmbyllëse 6 Kredite; Në referencë të të dhënave mbi programin e studimit⁴², në krye të saj mbi nivelin e studimeve deklarohet se është e bazuar në nivelin 6 në Kornizën Shqiptare dhe Europiane të Kualifikimeve. Modaliteti i studimeve është me kohë të plotë dhe kohëzgjatja e tyre 3 vite akademike dhe me 180 (ECTS). Të gjitha elementët përmendura më lartë gjejnë mbështetje dhe në shumë dokumentë të tjera si: Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022⁴³, neni 10, Elementë të Organizimit, ku në mënyrë eksplicite shpjegohet se si programi është organizuar në lëndë e module me gjithësej 180 kredite. Pas verifikimit dhe të planit mësimor të programit të studimit, "Punë Sociale"⁴⁴, shohim qartësisht kolonën e krediteve për cdo lëndë, të ndarë në 3 vite akademike. Gjithashtu reflektohen dhe tek sylabuset e lënëve, <i>shih Sylabuse 2023-2024</i>⁴⁵
---	--

⁴¹ Aneks 41 Propozim për hapjen e programit punë sociale, VENDIM Nr. 1, datë 27/09/2021

⁴² Aneks 6 Të dhëna mbi programin e studimit

⁴³ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

⁴⁴ Aneks 37 Plan mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale"

⁴⁵ Aneks 44 Sylabuse 2023-2024

Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit ka një koherencë në lidhje me elementët që synon të zhvillojë tek studenti në mënyrë që të lehtësojë realizimin e detyrave të kërkuara në tregun e punës për profesionin e “Punës Sociale”. Misioni, synime dhe objektiva e këtij program studimi është mbulimi i nevojave ekzistuese dhe ato të parashikuara të punës sociale si në sektorin publik dhe atë privat duke ofruar përgatitje të specialistëve në fushën e punës sociale. Programi i studimit ofron pajisjen me njohuri në lidhje me një sërë aspektesh të rëndësishme mbi proceset individuale dhe të grupit që lidhen me çështje bashkëkohore dhe fenomene që çënojnë drejtësi sociale për kategori të ndryshme individësh dhe grupesh shoqërore të cilët mund të gjenden në kushtet e pamjaftueshmërisë për të funksionuar në mënyrë të pavarur. Gjithashtu programi përfshin elementë mbi zhvillimin e disa shprehive profesionale që e ndihmojnë punonjësit social të realizojnë detyrat në kuadër të përkujdesit për këto target grupe individësh në mënyrë profesionale. Shish Rregullore për organizimin e programit të studimeve “Punë Sociale”⁴⁶, Të dhëna mbi programin e studimit⁴⁷, Plani mësimor i programit të studimit, “Punë Sociale”⁴⁸, Syllabuse 2023-2024⁴⁹.
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Sipas Rregullores për organizimin e programit të studimeve “Punë Sociale”⁵⁰ dhe tek aneksi me të dhëna mbi programin e studimit⁵¹ theksohet se studentët të cilët përfundojnë këtë program studimi⁵² aftësohen me shprehitë dhe teknikat e nevojshme për të punuar në sektorin e shërbimeve sociale, me kategori individësh të cilët kanë nevojë të veçanta. Lëndët në fushën e punës sociale dhe modulet e këtij programi studimor të japin mundësi për marrjen e njohurive bazë për të punuar me tipologji të ndryshme individësh. Prezenca e një larmishmërie metodash që aplikohen në këtë program studimi të japin mundësi të mira në avancimin e studentit në drejtim të përvetësimit të njohurive të nevojshme sidomos në aspektin profesional. Mbështetur në Planin mësimor të programit të studimit, “Punë Sociale”⁵³ realizohen si: Metoda dhe shprehitë në punë sociale,

⁴⁶ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve “Punë Sociale”, Nëntor 2022

⁴⁷ Aneks 6 Të dhëna mbi programin e studimit

⁴⁸ Aneks 37 Plani mësimor i programit të studimit, “Punë Sociale”

⁴⁹ Aneks 44 Syllabuse 2023-2024

⁵⁰ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve “Punë Sociale”, Nëntor 2022

⁵¹ Aneks 6 Të dhëna mbi programin e studimit

⁵³ Aneks 37 Plani mësimor i programit të studimit, “Punë Sociale”

	Intervistim dhe këshillim në punë sociale, Etikë në praktikën e punës sociale, Aspekte të menaxhimit në punë sociale, Puna sociale, në arsim, Puna sociale në shëndetësi, Puna sociale me individin, grupet dhe komunitetet, Praktikë në institucione.etj. <i>Shih Rregullore për Praktikën Mësimore Pasive në Arsimin e Lartë</i>⁵⁴
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit “Punë Sociale”⁵⁵ është organizuar duke respektuar vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “<i>Për Elementët e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë</i>”⁵⁶. Lëndët dhe modulet e tij janë të ndara duke respektuar përqindjen e kërkuar sipas ndarjeve në kategori. Numri i krediteve të grumbulluara sipas ndarjes në semestra dhe për çdo vit akademik gjithashtu është konform ligjit në fuqi. Gjithashtu, i është dhënë një hapësirë më e madhe në planin mësimor⁵⁷, veprimtarive praktike, duke iu përgjigjur në këtë mënyrë standardeve ligjore të vendimit Nr. 41. Ndarja sipas orientim për llogaritjen e orëve mësimore sipas krediteve⁵⁸ paraqitet si në vijim: Kategoria A: 5 lëndë bazë, me nga 5, dhe 7 kredite secila; në total 29 ECTS; Kategoria B: 20 lëndë, me 4 dhe 5 kredite secila; në total 100 ECTS; Kategoria C: 4 lëndë, 3 në vitin e parë me 5 ECTS secila dhe 1 në vitin e dytë me 7 ECTS secila; në total 22 ECTS; Kategoria D: gjuha e huaj Angleze 3 kredite dhe gjuhë Greke me 3 ECTS, Përdorim Kompjuteri 3 ECTS dhe Praktikë Aktive dhe Pasive në Institucione me nga 4 secila ECTS dhe Praktikum me 6 ECTS; në total 23 ECTS; Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – Punimi i diplomës, me 6 ECTS;
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në	Bazuar në vizionin e strategjisë së arsimit 2021-2016⁵⁹ ku theksohet se sistemi arsimor mbështetet në parimet e gjithëpërfshirjes dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Mbështetur në verifikimin e dokumentacionit si: Draft Rregullore për “Shërbimet Mbështetëse për Studentët me Aftësi Kufizuar”⁶⁰ ku nënvizohen filozofia që udhëheq

⁵⁴ Aneks 43 Rregullore për Praktikën Mësimore Pasive në Arsimin e Lartë

⁵⁵ Aneks 6 Të dhëna mbi programin e studimit

⁵⁶ Vendimi Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara”.

⁵⁷ Aneks 37 Plani mësimor i programit të studimit, “Punë Sociale”

⁵⁸ Aneks 38 Llogaritja e Krediteve

⁵⁹ Aneks 2 Strategjia Kombëtare e Arsimit, 2021-2026

⁶⁰ Aneks 51 Draft Rregullore për “Shërbimet Mbështetëse për Studentët me Aftësi Kufizuar”

përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	politkat dhe shërbimet në KU LOGOS për studentët me status të vecantë, gjithashtu, refruar vizitave në institucion dhe takimeve të drejtëpërdrejta me studentët e programit të studimit në Punë Sociale, ata u shprehën se institucioni dhe stafi akademik kishin ngritur një frymë bashkëpunuese dhe miqësore sidomos me studentët me nevoja të veçanta.
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nëse i referohemi Planit mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale" ⁶¹ vërehet se KU LOGOS e ka përmbushur këtë kriter, një pjesë e konsiderueshme e lëndëve kanë ngjashmëri me programe të tjera të punës sociale në vend, dhe mbështetur në argumentet e raportit të vetëvlerësimit citojnë programin e Universitetit të Tiranës. <i>Sugjerimet për këtë kriter shkojnë për ruajtjen e ngjashmërisë midis viteve me qëllim të krijohet mundësia për transferim kreditesh dhe mobilitetit të studentëve, në kuadër të Kartës së Bolonjës dhe të jenë konform udhëzimeve të MARS.</i>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Në bazë të vendimit numër 2, datë 04.02.2020, të marrë nga Senati i KU LOGOS, ka miratuar udhëzuesin për kodifikimin e lëndëve mësimore të programëve të studimit të ofruara nga KU LOGOS. <i>Shih</i> Udhëzues për kodifikimin e Programit "Punë Sociale", Departamenti Pedagogji Psikologji ⁶² , Planin mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale" ⁶³ , Sylabuse 2023-2024 ⁶⁴
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit bachelor në "Punë Sociale" ofrohet nga Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor në KU "LOGOS". Ky program studimi nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë vendas apo të huaj.
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module. Në planin mësimor lëndët janë paraqitur të ndara sipas tipit të veprimtarisë, në lëndë bazë, karakterizuese, lëndë ndërdisiplimore, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, në

⁶¹ Aneks 37 Planit mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale"

⁶² Aneks 54 Udhëzues për kodifikimin e Programit Pune Sociale, Departamenti Pedagogji Psikologji

⁶³ Aneks 37 Planit mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale"

⁶⁴ Aneks 44 Sylabuse 2023-2024

	përputhje me VKM nr. 41 datë 24. 01.2018 ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021; - Lëndët në programin e studimit kanë të përcaktuar ngarkesën në kredite ECTS; - Programi i studimit bachelor në “Punë Sociale” ka tendencë përmbajtje të ngjashme me programin e UT, por GVJ <u>sugjeron</u> ruajtjen e ngjashmërisë së lëndëve, kryesisht midis viteve me qëllim të krijohet mundësia për transferim kreditesh dhe mobilitetit të studentëve, në kuadër të Kartës së Bolonjës dhe të jenë konform udhëzimeve të MARS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit në “Punë Sociale” ofrohet nga Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor të Kolegjit Universitar Logos. Mbështetur në nenin 25 të “Ligjit të arsimit të lartë”⁶⁵, Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Departamenti mund të ketë në përbërje dhe personel ndihmës akademik. Në përputhje me këtë KU “LOGOS”, ka nënshkruar një marrëveshje me Ministrinë e Arsimit për të ndryshuar numrin minimal të anëtarëve të departamentit nga 7 në 5, kjo për shkak të numrit të ulët të studentëve që është më pak se 600 studentë në tre vitet e fundit.⁶⁶ Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor përbëhet nga 3 njësi bazë: 1. Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek; 2. Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë; 3. Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës; Në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor për vitin akademik 2023 - 2024 janë të angazhuar

⁶⁵ <https://arsimi.gov.al/ligji-nr-80-2015-per-arsimin-e-larte-dhe-kerkimin-shkencor-ne-institucionet-e-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-shqiperise-dhe-aktet-nenligjore-ne-zbatim-te-tij-2/>

⁶⁶ Aneks 55 Marrëveshja e KU Logos me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për stafin akademik

personel akademik efektiv dhe me kontratë, të cilët paraqiten në Aneks, Tabelat Përmbledhëse, tabela 1 si vijon:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor	
	PAE	PAK
Prof.Dr	2	1
Prof.Asoc	4	6
Dr/PhD	10	21
Msc	8	12
Gjithsej	24	40

Ndërsa Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë që është përgjegjës për programin e studimit në dy vite akademike ka përbërjen si më poshtë vijon:

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	1	1	1
Prof. Asoc.	2	2	3	1
Dr./PhD.	3	4	2	7
Msc.	2	4	3	5
Totali	8	11	9	14

Sugjerimi ynë shkon që njësia kryesore duhet të angazhohet seriozisht në rekrutimin e stafit akademik me kualifike në përputhje me programin.

Ky angazhim do garantoj cilësi më të lartë në formimin e studentëve dhe shprehi profesionale që do i ndihmojë në përgatitjen e tyre në tregun e punës. Tashmë profesioni i punës sociale është i rregulluar dhe gjithashtu që prej vitit 1992, formon profesionist në të tre ciklet e studimit, si dhe Universiteti i Tiranës ka të gjitha strukturat e nevojshme për promovimin e gradave dhe titujve akademik. Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale pranë Universitetit të Tiranës, numëron mbi 60 doktorë shkencash në fushën e punës sociale. Kolegji dhe njësia kryesore/bazë ka të gjitha mundësitë për të përmirësuar këtë kriter.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit

KU LOGOS dhe njësia kryesore/bazë në referencë me programin e studimit dhe planin mësimor për formimin e punonjësve social, është e impenjuar në përmbushjen e këtij

përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	kriteri duke qënë se ka krijuar marrëveshje bashkëpunimi⁶⁷ me institucione publike dhe private të mbarëvajtjen e praktikave profesionale sipas objektivave të programit por edhe misionit të profesionit. Aspekti praktik duket se preket përgjatë lëndëve të ndryshme teorike që studentët zhvillojnë në auditor si praktikum dhe angazhimit në praktikë aktive në institucion. Shih Plani mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale"⁶⁸. Elementi më i rëndësishëm në mbështetje të këtij kriteri lidhet me hapësirën dhe shtrirjen e praktikës profesionale përgjatë të dy viteve fundit të studimit për/semestër, përkatësisht 14 kredite ECTS. Mbështetur në sa më sipër mund të konkludojmë se programi i studimit ka në dispozicion një strukturë që favorizon përvetësimin e njohurive praktike në drejtim të rritjes së kompetencave profesionale të studentëve që ndjekin këtë program studimi.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Përsa i përket implementimit të këtij programi njësia kryesore/bazë ka krijuar kushtet e përshtatshme që studentët të prekin terrenin e punës në formën e duhur nën monitorimin e një profesionisti i cili kryen rolin e punonjësit social dhe koordinatori i programit⁶⁹ të studimit, i emëruar nga njësia kryesore dhe në përputhje me objektivat e programit dhe rregullores së njësisë bazë⁷⁰, ndjek ecurinë e tyre, Gjithashtu është hartuar dhe një instrument vlerësimi i institucionit për praktikën mësimore⁷¹ dhe një analizë përfundimtar i praktikave të studentëve⁷², në kuadër të marrëveshjeve me institucionet publike dhe private që ofrojnë praktika profesionale për studentët e punës sociale.
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike; - Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë ka përzgjedhur kordinatoren e programit të studimit. Koordinatori i Programit të studimit ka rol kyç në sigurimin e cilësisë së programit të studimit dhe siguron garantimin e suksesit të studentëve;

⁶⁷ Aneks 19 -Lista e marrëveshjeve në programin Punë Sociale

⁶⁸ Aneks 37 Plani mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale"

⁶⁹ Aneks 65 Vendim për emërim koordinatori

⁷⁰ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

⁷¹ Aneks 47 Format vlerësimi i institucionit për praktikën mësimore

⁷² Aneks 126 Analiza përfundimtar i praktikave të studentëve

	- <u>Sugjerimi</u> ynë shkon që njësia kryesore duhet të angazhohet seriozisht në rekrutimin e stafit akademik në përputhje me programin. Ky angazhim do garantoj cilësi më të lartë në formimin e studentëve dhe shprehi profesionale që do i ndihmojë në përgatitjen e tyre në tregun e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Lidhur me procedurat që ndjek institucioni në drejtim të realizimit të programit të studimit, kemi një informacion të pasur me të dhëna që rregullojnë organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Punë Sociale. Shih Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, ⁷³ Shih Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022 ⁷⁴ , Shih, Rregullorja për Ndarjen e Ngarkesës Mësimore ⁷⁵ , Shih, Rregullore për Praktikën Mësimore Pasive në Arsimin e Lartë ⁷⁶ .
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.	Nëse i referohemi planit mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale" ⁷⁷ kemi një ndarje deri disi të balancuar midis veprimtarive formuese të cilat zhvillohen në auditor dhe jashtë tij. Këto veprimtari kanë të ndërthurura aspektet teorike dhe praktike që të lejojnë aftësimin e studentit në përvetësimin e shprehive të nevojshme për të realizuar punën konkrete gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Lënda praktika pasive në institucion ⁷⁸ mbështet nevojat e programit profesional për zhvillim kompetencash dhe aftësish të nevojshme për tu përgatitur si profesionist në të ardhmen. Shih dhe Udhëzues mbi Praktikën Mësimore Pasive në

⁷³ Aneks 11 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016

⁷⁴ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

⁷⁵ Aneks 63 Rregullorja për Ndarjen e Ngarkesës Mësimore

⁷⁶ Aneks 43 Syllabuse 2023-2024

⁷⁷ Aneks 37 Plani mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale"

⁷⁸ Aneks 41-1 Shembull sylab

	Arsimin e Lartë ⁷⁹ : Struktura, Metodat dhe Përfshirja Studentore
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Sipas dokumentacionit të paraqitur, verifikojmë se programi i studimit i përmban të gjitha informacionet e duhura për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Për më shumë, në rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022 ⁸⁰ , ka gjithë informacionin e nevojshëm për studentët që në Kreun II, neni 8 mbi Kriteret dhe Procedurat e pranimit të studentëve. Shih, neni 9, Mobiliteti i Studentëve. Shih, neni 22 transferimi dhe pranimi i transferimeve. Shih, Rregullore e Transferimeve, 2019 ⁸¹ .
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Syllabuset e programit të studimit "Punë Sociale" janë konform modelit të përcaktuar nga MASR në shtojcën e vendimit Nr. 41, datë 24.01.2018 " <i>Për Elementët e Programit të Studimit të Ofruar nga Institucionet e Arsimit të Lartë</i> ". Syllabuset e secilës lëndë janë të organizuara sipas strukturës së mëposhtme: përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënies, objektivat dhe konceptet themelore, temat e lëndës dhe secila prej tyre përmbajnë një sërë veprimtarish praktike që realizohen si pjesë e seminareve, duke lehtësuar në këtë mënyrë përvetësimin e koncepteve teorike nga ana e studentit. Syllabusi i praktikës gjithashtu është organizuar në mënyrë që t'u jap mundësi studentëve të përfitojnë kompetenca dhe njohuri praktike nga prekja e terrenit të punës. Shih, Syllabuse ⁸² 2023-2024 dhe Shembull syllab. <i>Sugjerimet tona lidhen me nevojën për të hartuar syllabuset për lëndën Praktikum (seminare), duke qënë se është pjesë e planit mësimor dhe është e pajisur me kredite dhe është e përfshirë në ngarkesën mësimore të stafit akademik.</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen	Lidhur me procedurat që ndjek institucioni në drejtim të realizimit të programit të studimit sipas Raportit Vjetor i DPP, 2023-2024 / Analiza e kontributit në program praktikës mësimore ⁸³ , kemi një informacion të pasur me të dhëna që rregullojnë punën në drejtim të hartimit të syllabuseve si ajo e bashkëpunimit me komisionin e përhershëm të kurrikulave. Në këtë raport theksohet se gjatë mbledhjeve të departamentit

⁷⁹ Aneks 45 Udhëzues mbi Praktikën Mësimore Pasive në Arsimin e Lartë: Struktura, Metodat dhe Përfshirja Studentore

⁸⁰ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

⁸¹ Aneks 68 Rregullore e Transferimeve, 2019

⁸² Aneks 44 Syllabuse 2023-2024

⁸³ Aneks 37 -Plani mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale"

ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	në mënyrë serioze diskutohet vazhdimisht rishikimi i syllabuseve. Në vijim të të dhënave të mësipërme departamenti ka depozituar një porces verbal të datës 27.08.2024 ⁸⁴ ku në pikën e tretë diskutohet për dorëzimin e syllabuseve për programin e punës sociale, të dorëzohen pranë departamentit brenda datës 30.09.2024.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë, disponon informacionet dhe dokumentat e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor;</i> - <i>Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike në lidhje me kreditet dhe dokumentacionin e pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve;</i> - <i>Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm;</i> - <i>GVJ sugjeron nevojën e hartimit të syllabusit për lëndën Praktikum (seminare), duke qënë se është pjesë e planit mësimor, është e pajisur me kredite dhe është e përfshirë në ngarkesën mësimore të stafit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe	Ngarkesa e programit të studimit referuar planit mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale" ⁸⁵ reflekton një koherencë me parashikimet e akteve ligjore referuar numrit të

⁸⁴ Aneks 73/I Proçesverbal i DPP 27.08.2024

⁸⁵ Aneks 37 Plani mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale"

praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	krediteve, 180 kredite, kohëzgjatjes normale të tij në 3 vite akademike, tipologjisë së lëndëve sipas veprimtarive formuese që karakterizojnë programin duke u mbështetur në VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 <i>"Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë"</i> , vlerësimin në kredite e orë mësimore, si dhe shpërndarjes së ngarkesës mësimore në vite akademike dhe semestra. Plani mësimor është konform legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, me Statutin e Kolegjit Universitar LOGOS ⁸⁶ dhe Rregulloren e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017 ⁸⁷ .
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Lëndët dhe modulet kanë një shpërndarje të balancuar dhe në semestra ⁸⁸ , që respekton kuadrin ligjor ⁸⁹ përsa i përket vlerësimin në kredite dhe orë mësimore, si dhe u jep mundësinë studentëve të zhvillojnë të gjitha njohuritë që synojnë të përvetësojnë në formimin e tyre në fushën e punës sociale.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit të studimit ⁹⁰ , lëndët dhe emërtimi i tyre referuar programit Bachelor në "Punë Sociale", përfshin kryesisht lëndë të rezervuara metodologjisë dhe teorisë dhe praktikës së Punës Sociale, Sociologjisë, Psikologjisë, formimit të përgjithshëm. Për profilin e punonjësit social konsiderohet e rëndësishme formimi në disiplinat e mësipërme pasi profili i punonjësit social i tij, përgjatë rrugës së zhvillimit, është mbështetur në këto disiplina për t'u zhvilluar. Arsyeja pse kurrikula e këtij programi studimi bachelor në punë sociale përfshin lëndë të tjera bazë nga profile të përafërta, bëhet me qëllim që të balancohen njohuritë e mjaftueshme të studentit në lidhje me zhvillimin e dijeve, kompetencave në drejtim të studimit të individëve, grupeve dhe shoqërisë. Mbështetur në marrëveshjet e bashkëpunimit me: Shkollën 9 -vjeçare "Njazi Mastori", Sukth; Qendrës Rinore Peshkopi, Qendrës "ALO 116111-Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë", Tiranë,

⁸⁶ Aneksi Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

⁸⁷ Aneks 14 Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

⁸⁸ Aneks 37 Plani mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale"

⁸⁹ VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 *"Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë"*.

⁹⁰ Aneks 37 Plani mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale"

	Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Fier⁹¹, KU LOGOS ka hartuar për realizimin e praktikave profesionale. Më tej, sipas të dhënave të vëna në dispozicion, njësia në kuadër të programit të studimit ka organizuar e një sërë aktiviteteve ekstrakurrikulare, ndër to, leksione të hapura me të ftuar të fushave të ndryshme si: Shih, Raport mbi leksionin e hapur “Sfidat e Punës Sociale në arsim”⁹², shih, Raport mbi leksionin e hapur “Puna sociale në shëndetësi”⁹³. Në planin e përgjithshëm studentët e programit bachelor në “Punë Sociale” mund të përfitojnë nga këto aktivitete.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Përsa i përket planit mësimor⁹⁴ kemi një ndarje midis veprimtarive formuese të cilat zhvillohen në auditor dhe jashtë tij. Këto veprimtari kanë të ndërthurura aspektet teorike dhe praktike që të lejojnë aftësimin e studentit në përvetësimin e shprehive të nevojshme për të realizuar punën konkrete gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Praktika profesionale mbështetur dhe në Udhëzues mbi Praktikën Mësimore Pasive në Arsimin e Lartë: Struktura, Metodën dhe Përfshirja Studentore⁹⁵ gjithashtu mbështet plotësisht nevojat e programit profesional për zhvillim kompetencash dhe aftësish të nevojshme për të gjetur veten lehtësisht në tregun e punës. <i>Përsa i përket raportit teori/praktikë⁹⁶, për lëndët përkatëse, sugjerohet brenda mundësive të shtohet numëri i orëve praktike, mbase në semestrin e dytë të vitit të parë të studimeve.</i>
Kriteri 5. Syllabusët (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Syllabusët e programit të studimit “Punë Sociale” janë konform modelit të përcaktuar nga MASR në shtojcën e vendimit Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për Elementët e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Syllabusët e secilës lëndë janë të organizuara sipas strukturës së mëposhtme: përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit, objektivat dhe konceptet themelore, temat e lëndës dhe secila prej tyre përmbajnë një sërë veprimtarish praktike që realizohen si pjesë e seminareve, duke lehtësuar në këtë mënyrë përvetësimin e koncepteve teorike nga ana e

⁹¹ Aneks 33 Marrëveshja me: Shkollën 9 -vjeçare “Njazi Mastori”, Sukth; Qendrës Rinore Peshkopi, Qendrës “ALO 116111- Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë”, Tiranë, Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Fier

⁹² Aneks 83 Takim me Prof. Mr. Nikolaos Manesis drejtuesin e “Department of Educational Sciences and Social Work”, të Universitetit të Patrës

⁹³ Aneks 89 Raport mbi leksionin e hapur “Puna sociale në shëndetësi”

⁹⁴ Ibid

⁹⁵ Aneks 45 Udhëzues mbi Praktikën Mësimore Pasive në Arsimin e Lartë: Struktura, Metodën dhe Përfshirja Studentore

⁹⁶ Aneks 37 Plani mësimor i programit të studimit, “Punë Sociale”

	studentit. Syllabusi i praktikës gjithashtu është organizuar në mënyrë që t'u jap mundësi studentëve të përfitojnë kompetenca dhe njohuri praktike nga prekja e terrenit të punës. <i>Shih, Syllabuse</i> ⁹⁷ 2023-2024 dhe Shembull sylab.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit ⁹⁸ përcaktohet si qëllimi kryesor ofrimin e njohurive bazë në fushat që lidhen drejtpërsëdrejti me shkencën e punës sociale, si dhe të njohurive mbi degët më të aplikuara aktualisht të punës sociale në botë e në vendin tonë. Gjithashtu programi synon të pajisë studentin me aftësitë kryesore të një psikologu të përgjithshëm.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Ky program studimi ⁹⁹ i përgjigjet më së miri nevojave aktuale të vendit, por edhe nevojave të tregut ndërkombëtar përsa i përket profesionistëve që ofrojnë shërbime sociale në komunitete të ndryshme. Dinamika social-politiko-ekonomike që bashkëshoqëron orientimin e shoqërisë drejt zhvillimit dhe ndryshimeve që shpesh shoqërohen me efekte anësore, si papunësi, varfëri apo shqetësime të shëndetit mendor, tregon se kërkon profesionistë të kualifikuar të cilët kanë kompetenca profesionale për t'u kujdesur për të ato kategori që preken nga këto ndryshime. Kombinimi i njohurive, praktikave më të mira dhe shprehive profesionale ¹⁰⁰ që synohen të përvehtësohen përmes këtij programi studimi do t'i ndihmojë studentët të zotërojnë aftësitë e nevojshme dhe të pritshme nga tregu i punës. <i>Shih, Syllabuse</i> ¹⁰¹ 2023-2024 dhe Shembull sylab. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe kriteret për licensimin e psikologëve sipas Urdhrit të Punonjësit Social në Republikën e Shqipërisë
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Programi i studimit Bachelor Punë Sociale zhvillohet në tre vite akademike dhe ka një ngarkesë totale kreditesh Europiane prej 180 ECTS. Cdo vit akademik ka 60 kredite ECTS; - Programi i studimit ka qenë objekt i përditësimit vazhdimisht veçanërisht gjatë riorganizimeve të këtij programi studimi;

⁹⁷ Aneks 44 Syllabuse 2023-2024

⁹⁸ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

⁹⁹ Aneks 37 Plani mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale"

¹⁰⁰ Aneks 37 Ibid

¹⁰¹ Aneks 44 Syllabuse 2023-2024

	- GVJ vlerëson se ky program studimi me lëndët në përbërje të tij, mënyra e zhvillimit të programit dhe format e kontrollit të njohurive garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara; - Përsa i përket raportit teori/praktikë¹⁰², për lëndët përkatëse, <u>GVJ sugjeron brenda mundësive të shtohet numëri i orëve praktike, mbase në semestrin e dytë të vitit të parë të studimeve;</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Njësia kryesore/baze e cila është përgjegjëse për këtë program studimi është në fazën fillestare dhe pritet të ketë një analizë të punës së saj në drejtim të përmirësimit të cilësisë së këtij programi studimi në vijimësi pas daljes së brezit të parë. Kjo mund t'i jap mundësi njësisë bazë të analizojë edhe punën e saj të deritanishme duke u mbështetur në të gjitha bashkëpunimet si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, në drejtim të rritjes së cilësisë së vazhdueshme në formimin e punonjësve social sot edhe në të ardhmen. Në kuadër të dokumentacionit të raportuar nga njësia përgjegjëse vërejmë se ka një angazhim të madh për të përmbushur këtë kriter, duke ftuar aktorë të tjerë për të kuptuar më mirë tregun e punës dhe përmirësimin e strategjive të programit. Shih: Takim me Prof. Mr. Nikolaos Manesis drejtuesin e "Department of Educational Sciences and Social Work", të Universitetit të Patrës ¹⁰³ .
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për	Duke qenë se është një program studimi i ri për njësinë kryesore/bazë, dhe akoma janë në pritje të diplomimit të brezit të parë, kriteri nuk është i aplikueshëm për fazën në të cilën ndodhet programi bachelor në Punë Sociale. Por me kapacitetet që IAL ka dhe infrastrukturën e ngritur ka të gjitha gjasat për përfshirjen e studentëve të diplomuar

¹⁰² Aneks 37 Plan i mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale"

¹⁰³ Aneks 83 Takim me Prof. Mr. Nikolaos Manesis drejtuesin e "Department of Educational Sciences and Social Work", të Universitetit të Patrës

përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	(ALUMNI) dhe angazhimin e tyre për të përmirësuar kurrikulën dhe të kontribuojnë në të ardhmen.			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.	Departamenti Pedagogji -Psikologji që është përgjegjës për programin e studimit "Punë Sociale", mështetur dhe tek vetëraportimi i GVB, kanë pohuar se për hartimin e syllabuseve dhe përmirësimin e tyre bashkëpunojnë ngushtë me komisionin e përhershëm të kurrikulave. Gjithashtu në këtë raport theksohet se gjatë mbledhjeve të departamentit në mënyë serioze diskutohet vazhdimisht rishikimi i syllabuseve. Në vijim dhe të dokumentacionit të vënë në dispozicion, departamenti ka bërë një analizë mbi tregun e punës por duke u mbështetur më shumë në një desk reviu të të dhënave sekondare. Studimi i tregut të punës për programin e studimit,"Punë sociale" ¹⁰⁴ .			
Konkluzione	<i>KU "LOGOS" nëpërmjet strategjive dhe aktiviteteve të ndryshme nxit përfshirjen e studentëve, partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</i> <i>GVJ duke iu referuar kriterëve të këtij standarti reflekton se bazuar në angazhimin formal dhe të shoqëruar me dokumentacionet përkatëse në lidhje me përmbushjen e këtij standardi gjykojmë se përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

¹⁰⁴ Aneks 39 Studimi i tregut të punës për programin e studimit "Punë sociale"

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga bisedat e realizuara me stafin akademik të brendshëm e të jashtëm¹⁰⁵, si dhe takimet me studentët dhe të tjerë aktorë, mësohet se sistemi i transmetimit të dijeve bazohet kryesisht në leksionet dhe seminarët, kjo e mbështetur në formën interaktive të zhvillimit të njohurive, në funksion të një të kuptuari më të mirë të tematikave që diskutohen në leksione. Këtyre dy formave klasike të mësimdhënies e mësimnxënies u shtohen detyrat e kursit, shih, Shembull eseje detyrë kursit¹⁰⁶, punimet në grup, provimet e ndërmjetme, dhe provimet përfundimtare shish Format e kontrollit të njohurive¹⁰⁷. Veprimtaritë e tjera ndihmëse si leksionet e hapura, shih, Raport mbi leksionin e hapur "Sfidat e Punës Sociale në arsim"¹⁰⁸, shih, Raport mbi leksionin e hapur "Puna sociale në shëndetësi"¹⁰⁹ me të ftuar të profileve të përafërta me këtë program studimi, konferenca Ndërkombëtare Studentore "Sfidat e Shërbimit Social-Pedagogjik & Psikologjik"¹¹⁰, gjithashtu janë në funksion të diversifikimit të formave të mësimdhënies dhe mësimnxënies.
Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik si ai efektiv dhe me kontratë investohen vazhdimisht në drejtim të krijimit të aktivitete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Referuar Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, strukturave e institucionit janë angazhuar dhe në aktivitete plotësuese me projekte ndërkombëtare, workshopeve, trajnime, programe ERASMUS në qëllim të përmirësimit të mësimdhënies e mësimnxënies në kuadër të plotësimit të nevojave të studentëve. Në plotësim të këtij kriteri GVB ka renditur një sërë dokumentacionesh që mbështesin aktivitetet e tyre në përmbushje të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Shih, Relacion mbi Workshop-in: "Filozofia dhe Karakteristikat e Kurrikulës së Re, të Bazuar mbi Kompetenca"/Workshop

¹⁰⁵ Shënime Logos, minutat e takimit në institucion.

¹⁰⁶ Aneks 93 Shembull eseje detyrë kursit

¹⁰⁷ Aneks 105 Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15)

¹⁰⁸ Aneks 88 Raport mbi leksionin e hapur "Sfidat e Punës Sociale në arsim"

¹⁰⁹ Aneks 89 Raport mbi leksionin e hapur "Puna sociale në shëndetësi"

¹¹⁰ Aneks 32 Konferenca Ndërkombëtare Studentore "Sfidat e Shërbimit Social-Pedagogjik & Psikologjik

	Cështjet sociale në Punë Sociale ¹¹¹ . Shih, Trajnim nga Prof.Dr. Konstandinos Giakoumis ¹¹² . Shih, Relacion mbi procesin e vlerësimit të detyrave të kursit në Kolegjin Universitar LOGOS /Procedura aplikimi për rimbursim tarife të PhD. Edvaldo Begotaraj për pjesëmarrje në konferencë shkencore ¹¹³ . Shih, Foto ilustrim të studenteve me pedagoget në udhëtim, dhe foto ilustrim orë e hapur leksioni me të ftuar gjithë studentët ¹¹⁴ , Shih, Agjenda e takimit ROAMING mbi Erasmus + ¹¹⁵ .
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Personeli akademik në drejtim të përmirësimit të lëndës/modulit me një literaturë të 5 viteve të fundit, gjithashtu liria akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara, përdorimi i teknologjisë si videoprojektori, diskutimi në grup, role play janë aktivitete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. GVB, na vë në dispozicion forma të prezantimit të detyrave të kursit duke përdorur mjetet e teknologjisë dhe informacionit¹¹⁶, gjithashtu shoqëruar me foto nga ambientet e KU"Logos"si: kompjuter, video-projektor, kamera, tabelë smart, etj¹¹⁷, dhe ka hartuar një relacion mbi klasat dhe sistemin e provimeve të dixhitalizuara¹¹⁸, IAL, ka hartuar dhe një Draft Rregullore për "Shërbimet Mbështetëse për Studentët me Aftësi Kufizuar"¹¹⁹ në kuadër të diversitetit dhe nevojave të studentëve.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda	Mbështetur tek të dhënat e vëna në dispozicion nga institucioni, personeli akademik ¹²⁰ i angazhuar në këtë program studimi kanë kualifikimin e duhur dhe kompetencat e nevojshme për realizuar një proces të të nxënit i cili u mundëson studentëve të përfitojnë nga ndërthurja me një sërë formash interaktive në mësimdhënie. Duke vlerësuar

¹¹¹ Aneks 94 Relacion mbi Workshop-in: "Filozofia dhe Karakteristikat e Kurrikulës së Re, të Bazuar mbi Kompetenca"/Workshop Cështjet sociale në Punë Sociale

¹¹² Aneks 95 Trajnim nga Prof.Dr. Konstandinos Giakoumis

¹¹³ Aneks 98 Relacion mbi procesin e vlerësimit të detyrave të kursit në Kolegjin Universitar LOGOS /Procedura aplikimi për rimbursim tarife të PhD. Edvaldo Begotaraj për pjesëmarrje në konferencë shkencore

¹¹⁴ Aneks 99 -Foto ilustrim të studenteve me pedagoget në udhëtim, dhe foto ilustrim orë e hapur leksioni me të ftuar gjithë studentët

¹¹⁵ Aneks 165 Agjenda e takimit ROAMING mbi Erasmus +

¹¹⁶ Aneks 130 Prezantimi i detyrave të kursit duke përdorur mjetet e teknologjisë dhe informacionit

¹¹⁷ Aneks 131 Foto nga ambientet e KU"Logos"si: kompjuter, video-projektor, kamera, tabelë smart, etj

¹¹⁸ Aneks 106 Relacion mbi klasat sistemi provimeve të dixhitalizuara

¹¹⁹ Aneks 51 Draft Rregullore për "Shërbimet Mbështetëse për Studentët me Aftësi Kufizuar"

¹²⁰ Aneks 57/58 Personeli akademik në Programin e Punës Sociale 2022-2023 • Aneks 58 -Personeli akademik në Programin e Punës Sociale 2023-2024

të ndryshme të mësimeve interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik të student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	mënyrën se si janë hartuar syllabuset ¹²¹ , ka larmishmëri përsa i përket formave të përdorura në mësime, duke e vënë studentin në një pozicion aktiv gjatë orës së mësimit. Këto forma i përshtaten shumë mirë disiplinës së “Punonjësit Social” dhe ndihmojnë studentin të fitojë njohuri mbi fushën. Gjithashtu, nga studentët për pedagogët pati në përgjithësi komente pozitive mbi formën e realizimit të leksioneve dhe seminareve ¹²² .
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimeve në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Në drejtim të politikave të ndërmarra nga institucioni mbi mbështetjen e stafit për të avancuar në drejtim të zhvillimit të dijeve dhe kompetencave për fushën e tij të ekspertizës, kemi disa aktivitete të dokumentuara nga GVB, referuar dhe raportit të vetvlerësimit, ku nënvizohet se nëpërmjet formave të vlerësimit në kuadër të strukturës së NjSBC 2024 ¹²³ , bazohen tek opinionet e studentëve për përmirësimin e kurrikulës. Realizimi i një sërë aktiviteteve ekstrakurrikulare nga departamenti me fokus studentët programit të studimit në punë sociale, me lektorë të ftuar, të huaj dhe vendas është një tjetër element pozitiv në drejtim të rritjes së cilësisë në mësime dhe shkëmbimit të eksperiencave në format inovative të mësimit. Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendimmarrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit.
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimeve, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë	Institucioni ka në funksion të përmirësimit të cilësisë në mësime një sërë dokumentesh institucionale si Statuti ¹²⁴ dhe rregulloren e institucionit ^{125, 126, 127, 128} . Gjithashtu në mbështetje të programit të studimit bachelor “Punë Sociale” është dhe rregullorja e programit të studimit ¹²⁹ dhe përcaktimi i koordinatorit ¹³⁰ të programit të studimit në një rol monitorues në vijimësi. Përveç këtyre dokumentave, janë ngritur disa struktura të tjera që

¹²¹ Aneks 44/1 Shembull syllab

¹²² Shënime Logos, minutat e takimit në institucion.

¹²³ Aneks 199 -Dokument të Akreditimit për programin Mësuesi në Arsimin Parauniversitar

¹²⁴ Aneks 1 Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

¹²⁵ Aneks 14 Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

¹²⁶ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve “Punë Sociale”, Nëntor 2022

¹²⁷ Aneks 11 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016

¹²⁸ Aneks 48 Raport Vjetor për Veprimtarinë e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Kolegjit Universitar “LOGOS” për vitin Akademik 2023-2024

¹²⁹ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve “Punë Sociale”, Nëntor 2022

¹³⁰ Aneks 65 Vendim për emërim koordinatori

aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	monitorojnë avancimin e programit të studimit konform rregullave dhe në linjë me vizionin e KU "LOGOS", siç është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë¹³¹ e cila është e përbërë nga anëtarë të njësive kryesore të KU "LOGOS". Në drejtim të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë në mësimdhënie, kjo strukturë ndërmerr në mënyrë periodike aktivitete që kanë të bëjnë me administrimin e pyetësorëve për studentët¹³² dhe për stafin akademik të angazhuar në mësimdhënie¹³³. Gjithashtu ajo bën përpunimin e këtyre rezultateve dhe më pas bën shpërndarjen e informacionit në rang dekanati dhe departamenti. <i>Sugjerohet që informacioni të shpërndahet tek studentët, duke organizuar një takim të hapur me student dhe pedagog për të diskutuar mbi ecurinë dhe problematikat që kanë nevojë të adresohen.</i> Praktika të tilla do të respektojnë të drejtat e të gjitha palëve të përfshira për t'u informuar, duke mos përjashtuar asnjë individ. E drejta e studentit për t'u vënë në dijeni të rezultateve të vlerësimit nuk mund të tjetërsohet në asnjë formë.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Forma e mësimdhënies në këtë program studimi është ndërthurje formave të mësimdhënies si leksion, diskutime në auditor, detyrë kursi/ese etj, larmia e metodologjisë së përdorur pasqyrohet në syllabuse;</i> - <i>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit është kompetent dhe me eksperiencë në fushën e studimit;</i> - <i>Departamenti i Pedagogjisë psikologjisë përgjegjës për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike;</i> <i>Sugjerohet që informacioni të shpërndahet tek studentët, duke organizuar një takim të hapur me student dhe pedagog për të diskutuar mbi ecurinë dhe problematikat që kanë nevojë të adresohen;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹³¹ Aneks 101/199/151 Rregullore e Komisionit të Garantimit të Standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit/ Aneks 199 -Dokument të Akreditimit për programin Mësuesi në Arsimin Parashkollor/ Aneks 151-Rregullore për Njësien e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Standarteve

¹³² Aneks 100 Formular vlerësimi nga studenti për mësimdhënien e secilit pedagog

¹³³ Aneks 103 Dokumenti për sistemin e vlerësimit të studentëve

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloren mësimore të programit të studimit ¹³⁴ , sistemin e vlerësimit të studentit, formatin e tezës së provimit përfundimtar. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive bëhen publike dhe njihen nga studentët përmes sekretarisë mësimore dhe vetë pedagogut të lëndës në fillim të çdo semestri. Kjo procedurë respektohet nga stafi akademik dhe studentët informohen në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve, në orët e para, si dhe ky informacion i jepet studentit që ndjelin studimet bachelor në “Punë Sociale” pranë departamentin e pedagogji-psikologjisë. Shih, Formati për hartimin e sylabusi ¹³⁵ , Shih, ¹³⁶ Dokumenti për sistemin e vlerësimit të studentëve, Shih, Takim prezantues me studentët ¹³⁷
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në hartimin e lëndëve/moduleve të programit, në fillim të çdo semestri, nga titullari i lëndës bëhet njohja me të gjitha aspektet që përfshijnë studentët ¹³⁸ . Kjo procedurë ndiqet nga stafi akademik ¹³⁹ dhe u lejon studentëve të kishin informacion të plotë mbi metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe zhvillimit të kompetencave profesionale duke respektuar syllabuset e lëndëve apo moduleve të ndryshme të hartuara nga titullari dhe të miratuara nga përgjegjësi i njësisë bazë.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të	Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim ose me gojë. Llojet e provimeve që

¹³⁴ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve “Punë Sociale”, Nëntor 2022

¹³⁵ Aneks 102 Formati për hartimin e sylabusi

¹³⁶ Aneks 103 Dokumenti për sistemin e vlerësimit të studentëve

¹³⁷ Aneks 104 Takim prezantues me studentët

¹³⁸ Aneks 44-/44/1 Sylabuse 2023-2024 • Aneks 44/1 Shembull sylab

¹³⁹ Shënime Logos, minutat e takimit në institucion.

ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Ndjekja e lëndës, Plotësimi i detyrimeve (laborator, detyrat e kursit), Testime gjatë vitit, Provimi përfundimtar, Riprovime, Përmirësimi, Punim Diplome ¹⁴⁰ . Shih, Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15) ¹⁴¹ , Shih, Dokumenti për sistemin e vlerësimit të studentëve ¹⁴²
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Departamenti monitoron programin e studimit me synim përmirësimin e cilësisë së tij. Mbështetemi tek Politika per Sigurimin e Cilësisë ¹⁴³ , ku theksohen parimet mbi sigurinë e cilësisë, qëllimi i sistemit të sigurisë së cilësisë së brendshme, fusha dhe qasja të vlerësimeve mbi në kuadër të sigurimit të cilësisë, element që garantojnë cilësisë, veprimtari monitori, vlerësimi dhe përmirësimi. Në mënyrë të drejtpërdrejt nuk kemi evidence të qartë përse i përket vlerësimit dhe përmirësimit të formave e metodave të mësimdhënies në mënyrë periodike nga ana e stafit duke përfshirë studentët në këtë process, por vërtetohet se ka procedura që ndiqen nga institucioni për monitorimin e tij sipas Action Plan në pergjigje të Raportit NJSBC 2024 ¹⁴⁴ qëllimi është përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe programet akademike në përputhje me standartet e KU LOGOS dhe kërkesat ligjore të Arsimit të Lartë në Shqipëri. Duke iu referuar të dhënave të raportit të vlerësimit të brendshëm kemi përdorimin e videoprojektorit, power-point. Shih Aneks 130,-Prezantimi i detyrave të kursit duke përdorur mjetet e teknologjisë dhe informacionit ^{145, 146} .
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe	Mbështetur dhe në vizitën në institucion, takimi me stafin dhe strukturat drejtuese të KU LOGOS e kanë në fokus nevojën e rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe janë të angazhuar në realizimin e një sërë aktiviteteve dhe në krijimin e hapsirave të nevojshme për stafin akademik në funksion të rritjes së cilësisë në mësimdhënie, gjithashtu në këtë drejtim një rol ndihmës japin edhe aktivitete si workshope ¹⁴⁷ , simpoziume ¹⁴⁸ , konferenca ¹⁴⁹ , trajnime,

¹⁴⁰ Aneks 115 Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15)

¹⁴¹ Aneks 105 Struktura punim diplome

¹⁴² Aneks 103 Dokumenti për sistemin e vlerësimit të studentëve

¹⁴³ Aneks 186 Politika per Sigurimin e Cilësisë

¹⁴⁴ Aneks 192 Action Plan në pergjigje të Raportit NJSBC 2024

¹⁴⁵ Aneks 130 Prezantimi i detyrave të kursit duke përdorur mjetet e teknologjisë dhe informacionit

¹⁴⁶ Aneks 109 -Leje për përdorim laborator i Qendrës së Sipërmarrjes dhe Inovacionit

¹⁴⁷ Aneks 168 Trajnimi Roaming Project-Mobility for Internships/Apprenticeship

¹⁴⁸ Aneks 202 Pjesëmarrja në simpozium.

¹⁴⁹ Aneks 32Konferenca Ndërkombëtare Studentore "Sfidat e Shërbimit Social-Pedagogjik & Psikologjik

metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	mobilitete të stafit ¹⁵⁰ dhe studentëve duke siguruar bashkëpunim dhe përfshirje të vazhdueshme të partnerëve për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies të stafit akademik dhe implementimit të metodave të reja duke ftuar trajnues/lektorë vendas dhe të huaj ¹⁵¹ . Personeli akademik efektiv bazuar në evidenca por edhe takime të drejtpërdrejta, janë shumë të përfshirë në këto programe trajnimi, duke realizuar/ drejtuar procesin trajnues, ose leksionet e hapura të cilat krijojnë një klimë bashkëpunimi ^{152, 153} .			
Konkluzione	<i>Institucioni i ka hartuar rregulloret dhe procedura e posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</i> <i>GVJ duke iu referuar këtyre kritereve reflekton se bazuar në angazhimin formal dhe të shoqëruar me dokumentacionet përkatëse në lidhje me përmbushjen e këtij standardi gjykojmë se përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Sipas <i>nenit 17</i> të rregullores së programit të studimit¹⁵⁴ kontrolli i dijes dhe sistemi i vlerësimi i njohurive, thekson se provimi është forma kryesore dhe jo eskuzive për nivelin e vlerësimit të përvetësimit të njohurive që student ka përfituar gjatë lëndës teorike dhe praktike. Kontrolli i dijeve bëhet me shkrim me gojë ose kombinuar. Sipas pikës <i>a)</i> të <i>nenit 17</i> të kësaj rregulloreje kontrolli bëhet nga pedagogu në mënyrë të vazhdueshme.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike	Referuar relacionit mbi procesin e provimit në KU LOGOS ¹⁵⁵ , procesi i provimeve është i strukturuar dhe

¹⁵⁰ Aneks 190 Trajnimi I I-rë për stafin akademik , Universiteti Polis, Gusht 2024 ,Projekt 10112918 Homo Digitalis

¹⁵¹ Aneks 204 - Axhenda nga aktiviteti Erasmus për pjesëmarrjen në Universitetin e Patrës

¹⁵² Aneks 88 -Raport mbi leksionin e hapur "Sfidat e Punës Sociale në arsim"

¹⁵³ Aneks 89 -Raport mbi leksionin e hapur "Puna sociale në shëndetësi"

¹⁵⁴ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

¹⁵⁵ Aneks 106 Relacion mbi klasat sistemi provimeve të dixhitalizuara

të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	menaxhohet përmes një sistemi të mirëorganizuar dhe të integruar të teknologjisë së informacionit (IT). Në relacionin e sipër cituar në pikën 2, theksohet se sistemi i provimeve menaxhohet nëpërmjet platformave TEAMS dhe EduPage, dhe kjo platformë përdoret nga Studentët, Sekretaria dhe Pedagogët. Shih, Relacion mbi klasat sistemi provimeve të dixhitalizuara. Shih, Evidenc përdorimi Edupage/Teams ¹⁵⁶ .
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Sipas verifikimeve të bëra si në institucion nga takimi me studentët e stafin akademik ¹⁵⁷ si dhe dokumentacioni i dorëzuar, kemi konstatuar që syllabuset e programit të studimit "Punë Sociale" janë konform modelit të përcaktuar nga MASR në shtojcën e vendimit Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për Elementët e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë". Shih, Syllabuse ¹⁵⁸ 2023-2024 dhe Shembull syllab, Shih Raport Vjetor për Veprimtarinë e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Kolegjit Universitar "LOGOS" për vitin Akademik 2023-2024 ¹⁵⁹
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Njësia bazë ka një strukturë të mirëorganizuar në drejtim të hapave e procedurave që ndjek në drejtim të miratimit dhe kohës së përgatitjes së tezës së provimit nga pedagogu i lëndës. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për zhvillimin e provimit, por ai shoqërohet nga një anëtar i stafit akademik ¹⁶⁰ , bazuar në vendimin e komisionit të provimeve sezonale.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Neni 30 i rregullores së programit të studimit ¹⁶¹ parashikon masat disiplinore në raste shkelje, si Vërejtje me shkrim, b) Përrastim një vit nga Kolegji c) përjashtim përgjithmonë nga Kolegji. Në realizimin vlerësimin e praktikave profesionale, departamenti ka hartuar një rregullore ¹⁶² mbi vlerësimin e tyre duke u mbështetur tek pjesëmarrja aktive, performanës në detyrat praktike, dhe rezultatet në vlerësimet përfundimtare. Në kuadër të praktikave realizohet dhe monitorimi i praktikës, nga departamenti përkatës. Provimi i

¹⁵⁶ Aneks 144 Evidenc përdorimi Edupage/Teams

¹⁵⁷ Shënime Logos, minutat e takimit në institucion.

¹⁵⁸ Aneks 44 Syllabuse 2023-2024

¹⁵⁹ Aneks 48 Raport Vjetor për Veprimtarinë e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Kolegjit Universitar "LOGOS" për vitin Akademik 2023-2024

¹⁶⁰ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

¹⁶¹ Ibid

¹⁶² Aneks 43 Rregullore për Praktikën Mësimore Pasive në Arsimin e Lartë

	përgjithshëm përfundimtar, realizohen me komision prej dy ose më shumë anëtarësh. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim nga ana e sekretarisë mësimore, neni 51, pika 9, i rregullores së njësive kryesore¹⁶³, që bën sekretimin e tezave. Me përjashtim të pedagogut të lëndës, të monitoruesve të ngarkuar nga drejtuesi i departamentit, në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë. Tezat janë të sekretuara dhe provimi realizohet duke ruajtur anonimin e çdo studenti. Ç'sekretimi i tezave të korrigjuara të provimit dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, e cila bën ç'sekretimin e tyre dhe nxjerrjen e rezultatit për secilin student. Ndjekja e kësaj procedura krijon kushtet e nevojshme për një proces korrekt dhe që respekton të standardet e cilësisë përsa i përket nevojave të studentëve për të mësuar nga gabimet dhe për t'u përmirësuar në vazhdimësi.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	IAL ka ndërtuar një strukturë të mirë përsa i përket gjithë procesit që lidhet me procedurat e provimit, vlerësimit, shpalljes së rezultateve dhe ankimimit nga ana e studentit. Procedura që zbatohet nga institucioni përfshin rregullat e programit të studimit, sipas përcaktimeve përkatëse se si bëhet kontrolli i vazhdueshëm i dijeve, ku studentit i llogaritet nota në bazë të një vlerësimi të ndarë në vlersim nga pjesëmarrja aktive në diskutime, seminare/10 pikë, provimi i ndërmjetëm/ 30 pikë, detyrë kursi, 10 pikë, provimi final/ 50 pikë. Për hyrjen në provim dhe gjithçka tjetër që i përket këtij procesi kërkohet që studenti të ketë frekuentuar në masën mbi 50 %-75 %¹⁶⁴. Shih, Email njoftimi për notën¹⁶⁵, Shih, Dokumenti për sistemin e vlerësimit të studentëve¹⁶⁶
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni respekton procedurat e njohjes me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlerësimit. Kontrolli i djes së studentit është i shtrirë në kohë dhe realizohet nga pedagogu i lëndës. Si rregull në vlersimin e dijeve të studentit, pedagogu mbështetet në kontrollin e vazhdueshëm si frekuentimi, pjesëmarrje në leksione e seminare, detyra kursi e punë të tjera krijuese, kolekiume dhe provimin përfundimtar. Provimi është forma kryesore e vlersimit të nivelit të përvetësimit të njohurive gjatë kursit teoriko-praktik të një lënde. Këto procedura janë konform

¹⁶³ Aneks 14 Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

¹⁶⁴ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

¹⁶⁵ Aneks 182 Email njoftimi për notën

¹⁶⁶ Aneks 103 Dokumenti për sistemin e vlerësimit të studentëve

	legjislacionit në fuqi dhe rregullores së programit të studimit ¹⁶⁷ ¹⁶⁸			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Referuar <i>nenit 18</i> të Rregullores për organizimin e programit të studimeve “Punë Sociale”, Nëntor 2022 ¹⁶⁹ , studenti ka të drejtën e akimimit ndaj rezultatit të provimit, ankesa i paraqitet me shkrim shefit të departamentit, brenda 24 oreve nga marrja në dijeni të rezultatit të provimit. Shefi i departamentit brenda 48 orësh bën verifikimet e duhura duke dëgjuar mendimin e pedagogut dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, ai ngre një komision ad hoc. Ky komision përbëhet nga shefi i departamentit, një anëtar pedagog i asaj disipline dhe pedagogu i lëndës. Rezultati i shqyrtimit duhet t’i njoftohet me shkrim pjesëmarrësit të provimit, duke e shoqëruar me informacionin e nevojshëm. Vendimi i komisionit ad hoc është përfundimtar. Studenti nuk ka të drejtë të paraqesë ankesë kundër vlerësimit të komisionit.			
Konkluzione	<i>IAL ka ndërtuar një strukturë të mirë përsa i përket gjithë procesit që lidhet me procedurat e provimit, vlerësimit, shpalljes së rezultateve dhe ankimit nga ana e studentit.</i> <i>GVJ vlerëson që institucioni i respekton procedurat e njohjes me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlerësimit. Nga verifikimi i dokumentacionit verifikohet se kontrolli i dijes së studentit është i shtrirë në kohë dhe realizohet nga pedagogu i lëndës.</i> <i>GVJ konstaton se njësia bazë ka një strukturë të mirëorganizuar në drejtim të hapave e procedurave që ndjek në drejtim të miratimit dhe kohës së përgatitjes së tezës së provimit nga pedagogu i lëndës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

¹⁶⁷ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve “Punë Sociale”, Nëntor 2022

¹⁶⁸ Aneks 14 Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

¹⁶⁹ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve “Punë Sociale”, Nëntor 2022

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit ¹⁷⁰ bachelor në “Punë Sociale” Plani mësimor i programit të studimit, u jep mundësi studentëve të zgjerojnë njohuritë në një gamë të gjerë profilesh në kontekstin e punës sociale, kërkimit shkencor, praktikë profesionale, psikologjisë, sociologjisë dhe, dhe fusha të tjera formuese. Duket se kjo larmishmëri mund të shihet si pozitive në drejtim të thellimit të njohurive për aspektet më të imta që lidhen me fushën dhe në një aftësi për të zhvilluar kompetenca profesionale te studenti përse i përket profilit të “Punonjësit Social”.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	IAL nëpërmjet këtij programi studimi ka krijuar të gjitha kushtet që studenti të zhvillojë aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit si në aspektin teorik përmes lëndëve që janë pjesë e kurrikulës për këtë program studimi, por edhe praktikisht përmes hapësirave që u jepen studentëve për të përdorur sistemin online të shfrytëzimit të literaturës në bibliotekat online si: Adresa JSTOR, EBSCO ¹⁷¹ . Në drejtim të komunikimit dhe ndërveprimit kemi një sërë modulesh që ndikojnë pozitivisht në këtë drejtim të zhvillimit të kompetencave profesionale të studentëve shih, Sylabet dhe Plani Mesimor 2024-2025 ¹⁷² , si psh, praktikumet dhe praktikat profesionale në institucione ku janë përfshirë studentët. Veprimtari ekstrakurrikulare si konferenca dhe leksione të hapura, që u japin mundësi ndërveprimi duke mbështetur diskutimet në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve apo çështjeve të caktuara, janë aktivitete që ndihmojnë në përvetësimin e njohurive të reja mbi fushën. Shih, Relacion mbi konferencën studentore ¹⁷³
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për zbatimin e	Programi i studimit përfshin si pjesë të procedurave për stafin akademik një <i>raport Vjetor i DPP, 2023-2024./ Analiza e kontributit në program praktikës mësimore semestral</i> ¹⁷⁴ me qëllim analizën e vlerësimit të kompetencave dhe aftësive të fituara nga studentët për çdo modul apo lëndë. Raporti i vlerësimit të pedagogut në përfundim të lëndës mbi ecurinë e saj dhe arritjen e objektivave formative në raport me mësimnxënien është pjesë e procedurave që ndiqen nga

¹⁷⁰ Aneks 37 Plani mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale"

¹⁷¹ Aneks 71 Një format sylbusi të Shkërkimit Akademik

¹⁷² Aneks 37 Plani mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale"

¹⁷³ Aneks 113 Relacion mbi konferencën studentore

¹⁷⁴ Aneks 34 Raporti Vjetor i DPP, 2023-2024 / Analiza e kontributit në program praktikës mësimore

tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	institucioni. Shih, Udhëzuesi Didaktik për Studentët e Programit Punë Sociale ¹⁷⁵ .
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia ¹⁷⁶ bazohet në diskutimet e ndryshme, nxitjen e mendimit kritik mbi çështjet që trajtohen duke e vendosur studentin në një pozicion aktiv në drejtim të përvetësimit të dijeve dhe të nxënies në tërësi. Ky program, mbështetur tek misioni i vetë programit që përvec formimit teorik në fushën e punës sociale të aftësojë studentet në aspektin dhe profesional i jep një rëndësi të veçantë përvojës së praktikës profesionale si një aset i domosdoshëm për zhvillimin e kompetencave të studentëve ¹⁷⁷ . Shih, Udhëzues mbi Praktikën Mësimore Pasive në Arsimin e Lartë: Struktura, Metodrat dhe Përfshirja Studentore. Por, edhe një pjesë e moduleve të lëndëve karakterizuese, jo vetëm kërkojnë njohuri të thelluara teorike të marra përmes kualifikimit akademik, por gjithashtu edhe njohuri dhe kompetenca praktike që duhen zhvilluar përmes përvojës praktike të fituar drejtpërdrejtë në fushën përkatëse. Në drejtim të mobilitetit të studentëve të këtij programi studimi evidencat tregojnë përfshirjen e studentëve në institucione të ndryshme për praktikë, Shih, Lista e marrëveshjeve ¹⁷⁸ . Shih, Të dhëna mbi mobilitetin e stafit & studentëve ¹⁷⁹
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik duket se është i angazhuar në veprimtari ekstrakurrikulare si konferenca, shih Relacion mbi konferencën studentore ¹⁸⁰ dhe leksione të hapura, që u japin mundësi ndërveprimi duke mbështetur diskutimet në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve apo çështjeve të caktuara, janë aktivitete që ndihmojnë në përvetësimin e njohurive të reja mbi fushën e punës sociale, si: takim me Prof. Mr. N. M, drejtuesin e "Department of Educational Sciences and Social Work" ¹⁸¹ , të Universitetit të Patrës, Takim me drejtuesin e Njesisë Kryesore, Drejtuesin e Njesisë Bazë dhe Rektorin zhvillojnë takime me studentët ¹⁸² , Takim i studentëve me Prof As. E Sh ¹⁸³ . GVB ka vënë në

¹⁷⁵ Aneks 67 Udhëzuesi Didaktik për Studentët e Programit Punë Sociale

¹⁷⁶ Aneks 70/44/44-1 Sylabet dhe Plani Mesimor 2024-2025/Aneks 44-Sylabuse 2023-2024 • Aneks 44/1 Shembull sylab

¹⁷⁷ Aneks 45 Udhëzues mbi Praktikën Mësimore Pasive në Arsimin e Lartë: Struktura, Metodrat dhe Përfshirja Studentore

¹⁷⁸ Aneks 33 Marrëveshja me: Shkollën 9 -vjeçare "Njazi Mastori", Sukth; Qendrës Rinore Peshkopi, Qendrës "ALO 116111- Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë", Tiranë, Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Fier

¹⁷⁹ Aneks 84 Të dhëna mbi mobilitetin e stafit & studentëve

¹⁸⁰ Aneks 113 Relacion mbi konferencën studentore

¹⁸¹ Aneks 83 Takim me Prof. Mr. Nikolaos Manesis drejtuesin e "Department of Educational Sciences and Social Work", të Universitetit të Patrës

¹⁸² Aneks 85 Drejtuesi i Njesisë Kryesore, Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe Rektori zhvillojnë takime me studentët

¹⁸³ Aneks 86 Takim i studentëve me Prof As. Edo Sherifi

	dispozicion dhe dy raporte për aktivitetet ekstrakurrikulare të organizuara me studentët e KU LOGOS, si: Raport mbi leksionin e hapur “Sfidat e Punës Sociale në arsim” ¹⁸⁴ dhe Raport mbi leksionin e hapur “Puna sociale në shëndetësi” ¹⁸⁵ .			
Konkluzione	GVJ vlerëson angazhimin e institucionit në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie me struktura të posaçme. Impenjimi i personelit akademik i njësisw bazë ka realizuar aktivitetet të ndryshme dhe angazhimi i vazhdueshëm, përfshirë mobilitetin, ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e studentëve. Nevojitet përpjekje e qëndrueshme dhe e vazhdueshme për të siguruar një cilësi të qëndrueshme në arsimin e lartë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	Institucioni ka hartuar procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve, të mbështetura në rregulloren e programit të studimit ¹⁸⁶ bachelor në “Punë Sociale” dhe udhëzuesin mbi Strukturën e punimit të diplomës, të hartuara nga njësia bazë për përgatitjen e studentëve, të cilët do të marrin kreditet finale për përmbushen e ciklit të patë të studimeve, këtu klasifikohen studentët të cilët kanë një mesatare 8.5. Ndërsa pjesa tjetër e studentëve i nënshtrohen një provimi të përgjithshëm. Sipas nenit 51 të rregullores së Njësisë Kryesore ¹⁸⁷ , Sekretaria mësimore shpall datën e provimeve, ruan dokumentacionin dhe shpall rezultatin e provimeve, informon studentin mbi kreditet mbi numrin e krediteve për lëndën, komunikon dhe sqaron studentët për cdo lloj problematike, përgatit diplomat në bazë së listës së studentëve të cilët kanë fituar të drejtën për tu diplomuar, etj. Institucioni për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe pajisjen e studentit me informacionin e

¹⁸⁴ Aneks 88 Raport mbi leksionin e hapur “Sfidat e Punës Sociale në arsim”

¹⁸⁵ Aneks 89 Raport mbi leksionin e hapur “Puna sociale në shëndetësi”

¹⁸⁶ Aneks 70 Sylabet dhe Plani Mesimor 2024-2025

¹⁸⁷ Aneks 14 Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

	nevojshëm ndjek rregullat që i dikton legjislacioni. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në këtë program studimi, ende nuk është diplomuar brezi i parë i studentëve.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Nga takimi me aktorët përkatës mësohet se institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të instancave përkatëse, apo nevojave të vet institucionit. mbështetur në procedurat e njësishë bazë mbi administrimin e provimit final, komisioni i ngritur për këtë qëllim ndjek parimin e respektimit të kriterit ku për secilën kategori mund të ofrohen një fond pyetjesh ¹⁸⁸ , (Shih, Proçesverbal i DPP 27.08.2024), për lëndë të kategorisë A, lëndë të kategorisë B dhe C. Përgjithësisht respektohet balanca në testimin e njohurive të dhëna gjatë tre viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Shih, Raport Akademik mbi Arritjet e Studentëve dhe Verifikimin e Saktësisë së të Dhënave 2022 2023 ¹⁸⁹ , Shih,-Raport Akademik mbi Arritjet e Studentëve dhe Verifikimin e Saktësisë së të Dhënave 2023 2024 ¹⁹⁰ , Shih, Raport Analitik për Studentët ¹⁹¹
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Komisioni i ngritur, përgjithësisht respektohet balanca në testimin e njohurive të dhëna gjatë tre viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Përgjithësisht respektohet balanca në testimin e njohurive të dhëna gjatë tre viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Shih, Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017 ¹⁹² .
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i	Sikurse përmendur edhe më lart, ende nuk është diplomuar brezi i parë i studentëve në këtë program të ri studimi. Program studimi ¹⁹³ me karakter profesional, diplomimi i studentëve realizohet përmes mbrojtjes së diplomës, përmes përgatitjes së mikroteze dhe provimit të përgjithshëm përfundimtar, neni 17 i rregullores së programit ¹⁹⁴ , i cili

¹⁸⁸ Aneks 73/1 Proçesverbal i DPP 27.08.2024

¹⁸⁹ Aneks 177 Raport Akademik mbi Arritjet e Studentëve dhe Verifikimin e Saktësisë së të Dhënave 2022 2023

¹⁹⁰ Aneks 178 Raport Akademik mbi Arritjet e Studentëve dhe Verifikimin e Saktësisë së të Dhënave 2023 2024

¹⁹¹ Aneks 179 Raport Analitik për Studentët

¹⁹² Aneks 14 Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

¹⁹³ Aneks 70 Sylabet dhe Plani Mesimor 2024-2025

¹⁹⁴ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	hartohet nga komisioni i provimit. Studentët pajisen me një udhëzues për strukturën e diplomës dhe me fondin e pyetjeve për provimin e përgjithshëm përfundimtar ¹⁹⁵ nga departamenti me qëllim përgatitjen e tyre për t'u përballur me sukses me këtë proces. Staf i akademik i këtij programi studimi ka rol mbështetës dhe orientues në drejtim të përgatitjes së studentëve për provimin e përgjithshëm përfundimtar duke qenë të hapur të ndihmojnë studentët nëse kanë pyetje apo paqartësi në lidhje me lëndën e tyre.
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. Studentët mund të shfrytëzojnë bibliotekën fizike dhe online për sigurimin e informacioneve të nevojshme për të realizuar kërkimin shkencor si dhe për të kryer analiza krahasuese në varësi të fushës së studimit. Studentët mund të përdorin kompjuterat e laboratorit të institucionit për të kryer studimin.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Neni 25 i rregullores së programit të studimit bachelor në punë sociale ¹⁹⁶ , sqaron se shpallja e diplomomit të studentit bëhet me vendim departamenti. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Mbështetur nga raporti i vetvlerësimit por edhe dokumentave të paraqitura dhe të cituara deri tani në raport, si statuti i IAL, rregullore e njësisë kryesore dhe asaj bazë, rregullore e programit të studimit bachelor në "Punë Sociale", takimi me stafin, vizitat në strukturat e IAL-s, vërtetohet se institucioni ka hartuar të gjitha elementët e duhur për të pajisur studentët me Suplementin e Diplomës së programit Bachelor në Punë Sociale ¹⁹⁷ . Institucioni për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe pajisjen e studentit me informacionin e nevojshëm ndjek rregullat që i dikton legjislacioni. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në këtë program studimi, ende nuk është diplomuar brezi i parë i studentëve.

¹⁹⁵ Aneks 15 Biografi e shkurtër, Prof.Asoc.Dr Edo Sherifi

¹⁹⁶ Aneks 9 Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

¹⁹⁷ Aneks 118 Suplementi i Diplomës së programit Bachelor në Punë Sociale

Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Nga takimi me aktorët përkatës mësohet se institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të instancave përkatëse, apo nevojave të vet institucionit. Në këtë program studimi, ende nuk është diplomuar brezi i parë i studentëve.			
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar "LOGOS" shpalos impenjim në ndjekjen e një procedurë të qartë për përfundimin e detyrimeve të studentit në programin e studimit dhe siguron dokumentacionin e nevojshëm.</i> <i>GVJ, pas vlerësimit të të dhënave burimore dhe takimeve të drejtpërdrejta me personelin akademik, arrin në konkluzion se kriteret për këtë standard përmbushen plotësisht, dëshmuar nga angazhimi dhe efikasiteti i institucionit në këtë proces.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin	Referuar vlerësimit të dokumentacionit ¹⁹⁸ (Statuti i Kolegjit Universitar "Logos", Kreu IV, Personeli i Institucionit) rezulton se personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush

¹⁹⁸ Annex 1.pdf

kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	kërkesat ligjore në fuqi¹⁹⁹ dhe nga për këtë program studimi Bachelor “Punë Sociale”^{200, 201, 202} personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës²⁰³. Përsa i përket nivelit të kualifikimit akademik për drejtimin dhe angazhimin në program lidhur me lëndët që mbulojnë²⁰⁴, gjykojmë se të dhënat bazohen vetëm në CV²⁰⁵ e stafit PAE/PAK të angazhuar në këtë program studimi dhe nga dosjet e personelit të shqyrtuara gjatë vizitës²⁰⁶ ditore pranë BNJ. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi fizik rezulton se një pjesë e konsiderueshme e stafit akademik ka kualifikimin akademik në drejtimin Sociologjik e Psikologjik, dhe në fushat specifike, me kualifikimet dhe eksperiencat përkatëse, por jemi të mendimit se <i>stafi me formim Punë Sociale, është në numër shumë të ulët</i>. Vetë orientimi i programit “Punë Sociale”, orienton për një fushë studimi të balancuar drejt një profesioni të rregulluar, si një aktivitet profesional, që ndihmon individët, grupet ose komunitetet, të përmirsojnë ose shtojnë kapacitetet e tyre për funksionimin social si dhe krijon kushte të favorshme sociale për të realizuar këtë qëllim dhe formimi i studentëve nga staf akademik me profile specifike (të fushave të ndërmjetme) mund të ketë impakt negativ në fokusin e cilësisë së mësimdhënies. Shqetësim për t’u adresuar është dhe fakti se janë evidentuar raste kur pedagogë, të cilët i përkasin kategorisë “Dr” janë titullarë disa lëndëve dhe moduleve të cilat janë jo të ndërlidhura (rasti i Dr.J.B. e cila figuron titullare në gjashtë lëndë të këtij programi që nga “Bazat e Ekonomisë”, te “Hyrje në Sociologji” apo dhe “Hyrje në Punë Sociale” dhe “Etika në punë sociale” apo dhe më tej dhe “Analizë e problemeve sociale dhe punë sociale”)²⁰⁷, gjithashtu duhet adresuar dhe rasti i programeve të cilat nuk kanë titullar si rsasti i lëndës “Procese individuale dhe të grupit”²⁰⁸.
---	--

¹⁹⁹ Ligj Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 45, Pika 3.

²⁰⁰ Aneks 11 -Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016 , Kreu 3.

²⁰¹ Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017, Kreu V.

²⁰² Aneks 9 -Rregullore për organizimin e programit të studimeve “Punë Sociale”, Nëntor 2022

²⁰³ Ligj Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 59, pika 6.

²⁰⁴ Evidencw 6. Tabelat përmbledhëse.pdf

²⁰⁵ Evidencw 13.3. Cv e stafit akademik.pdf

²⁰⁶ Shënime gjatë vizitës në institucion

²⁰⁷ Aneks 70-Sylabet dhe Plani Mesimor 2024-2025

²⁰⁸ Aneks 70-Sylabet dhe Plani Mesimor 2024-2025

Bazuar në tabelat 6.1 – 6.3 të RVB, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Punë Sociale” për tre vite akademike është si më poshtë vijon:

Tituj/grada	2022 – 2023		2023 – 2024		2024 - 2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-	1	-	1	-
Prof.As.Dr	1	-	2	-	3	-
Dr/PhD	4	1	1	3	2	2
Msc	2	1	6	2	6	3
Në total	7	2	9	5	12	5

Për sa i përket kualifikimeve të personelit akademik:

- Për 2022-2023, 66.6% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 33.4 % janë Msc;
- Për 2023-2024, 50% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 50 % janë Msc;
- Për 2024-2025, 47 % e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, dhe 53% MSc;

Zyra e Burimeve Njerëzore²⁰⁹, e cila ka si mision të siguroj menaxhim efektiv të burimeve njerëzore kanë të dhënat për personelin e angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi. Ky sektor sipas rregullores kujdeset për kushtet e punës, merret me procedurat e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme si dhe me stafin ndihmës akademik, kontratat e punës²¹⁰. Përpilon dokumentacionin për konkurset për marrjen dhe pranimin e punonjësve në punë, plotësimin e tyre me librezat e punës si dhe bën shënimet përkatëse në këto librezat. Përgjigjet për plotësimin e dosjes personale me dokumentacionin e nevojshëm për çdo punonjës të institucionit, mban dokumentacionin e plotë dhe të rregullt mbi të dhënat biografike dhe të administratës qendrore, mbi bazën e analizës së të dhënave që disponon. Të dhënat mbi kualifikimet dhe arritjeve akademike ruhen në Departament, si dhe të dhënat e aktivitetit mësimor-shkencor. Nga vizita në institucion²¹¹ dhe përzgjedhja rastësore e dosjeve të stafit

²⁰⁹ Aneks 124 -Rregullore e Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Arkiv-Protokollit.

²¹⁰ Annex 123 -Kontrata individuale e punës rregullon Marrëdhëniet ndërmjet Kolegjit Universitar “Logos” dhe punëdhënësit].

²¹¹ Shënime gjatë vizitës në institucion

	akademik efektiv dhe të jashtëm rezulton se dosjet personale me të dhëna të plota dhe të përditësuara ruhen dhe administrohen sipas parashikimeve ligjore. <i>GVJ duke u bazuar në disa të dhëna të plota mbi stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi gjykon se si çështje e cila ka nevojë të adresohet është evidentimi i përfshirjes së stafit akademik me kualifikim akademik specifik në punë sociale, dhe më specifikisht mundësisht me tituj dhe grada në Punë Sociale, për realizimin dhe mbulimin e disa lëndëve dhe moduleve thelbësore në këtë program studimi, në përputhje me natyrën dhe veçoritë e moduleve. Kualifikimi dhe ekspertiza në punë sociale shihen me impakt negativ në implementimin e njohurive të thelluara dhe kompetencave profesionale tek studentët e këtij programi studimi dhe për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</i>												
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga analiza e informacionin të deklaruar në tabelat 12.1-12.3 të RVB²¹², për ngarkesën mësimore të personelit akademik PAE dhe PAK rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është si më poshtë: <table><tr><th>Viti Akademik</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>75 %</td><td>25 %</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>78 %</td><td>22 %</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>83 %</td><td>17%</td></tr></table> Nga sa më sipër rezulton se për 3 vite akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me <u>mbi</u> 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi”, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit. Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të plotë në auditor në IAL dhe specifikisht orët suplementare në auditor nuk mund të jenë më shumë se 200 orë²¹³ dhe me raste specifike ka të përcaktuar procedurën, ndërkohë nga analiza e dokumentacionit të paraqitur (tabela 4) rezulton se stafi PAE i angazhuar në këtë program mbulon orë mësimore që variojnë	Viti Akademik	PAE	PAK	2022-2023	75 %	25 %	2023-2024	78 %	22 %	2024-2025	83 %	17%
Viti Akademik	PAE	PAK											
2022-2023	75 %	25 %											
2023-2024	78 %	22 %											
2024-2025	83 %	17%											

²¹² 6. Tabelat përmbledhëse.pdf

²¹³ Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018, II, pika 1

	nga minimumi 40 orë mësimore (Msc.Xh.S.) në maksimumin 225 orë mësimore (Prof.As.Dr.E.Sh.) duke respektuar kriteret ligjore dhe mos e kaluar mbingarkesën e 200 orëve suplementare. Përsa i përket personelit akademik me kohë të pjesshme, ai mund të mbulojë ngarkesën vjetore 120 orë në auditor dhe nuk mund të ketë orë suplementare²¹⁴ dhe në këtë program mësimor janë të angazhuar pesë PAK me 10 deri në maksimumin 110²¹⁵ orë mësimore në auditor duke mos tejkaluar parashikimet e pikës 2 të Udhëzimit 29. Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të përmbajë në një vit akademik më shumë se 3 lëndë semestrale në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë, të shpërndarë në 2 semestre, ose 2 lëndë vjetore dhe 1 semestrale, ose 3 lëndë vjetore²¹⁶. Masivisht i gjithë stafi është me 2-3 lëndë semestrale²¹⁷. GVJ gjykon se ngarkesa si e PAE ashtu dhe PAK është konform parashikimit ligjor të VKM-së "Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë".
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit (kontratat, mbështetja me projekte afatgjata, mbështetja nga fondacioni, etj) institucioni përgjithësisht garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv²¹⁸, ²¹⁹²²⁰, ²²¹ që janë pjesë e njësisë bazë dhe ka në fokus dhe zhvillimin e programit²²². Lidhur me stafin e angazhuar në programin e studimit²²³, për të gjithë periudhën e akreditimit vlerësojmë këtë si aspekt pasi të dhënat përgjithësisht dëshmojnë qëndrueshmërinë e personelit akademik²²⁴ efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore²²⁵. Edhe nga takimi me pedagogët gjatë vizitës në institucion²²⁶ na u konfirmua si qëndrueshmëria shumë vjeçare

²¹⁴ Udhëzimi 29, datë 10.09.2018, pika 2

²¹⁵ 6. Tabelat përmbledhëse.pdf

²¹⁶ Udhëzimi nr.29, datë 10.09.2018, pika 6.

²¹⁷ 6. Tabelat përmbledhëse.pdf

²¹⁸ Aneks I -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

²¹⁹ Aneks 61 -Organograma e Kolegjit Universitar LOGOS

²²⁰ Aneks 124 -Rregullore e Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Arkiv-Protokollit.

²²¹ Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

²²² Aneks 20 -Plani Strategjik në Programin Punë Sociale, Kolegji Universitar Logos

²²³ Annex 123 -Kontrata individuale e punës rregullon Marrëdhëniet ndërmjet Kolegjit Universitar "Logos" dhe puëdhënësit].

²²⁴ 6. Tabelat përmbledhëse.pdf

²²⁵ Shënime nga vizita në institucion.

²²⁶ Shënime nga vizita në institucion.

	e tyre por dhe plotësimi i dokumentacioneve ligjore mbi punësimin²²⁷. Qëndrueshmëria e personelit akademik garantohet nëpërmjet tipologjisë PAE të stafit në këtë program, personel i cili ka kontrata paafat dhe është i punësuar pranë Kolegjit Universitar "Logos" prej kohës kur është hapur ky program studimi por dhe më herët. Nga vizita në institucion dhe konsultimi me materialet e DVV u konfirmua se dhe marrëdhëniet me stafet (egzistuese dhe të reja) ishin bashkëpunuese dhe mbështetëse. Procedurat për rekrutimin e personelit akademik, janë të reflektuara në aktet normative e rregulative të institucionit²²⁸,²²⁹ dhe në konformitet me bazën ligjore dhe aktet normative në fuqi. GVJ konstatoi që procedura e rekrutimit është në përputhje me Ligjin 80/2015²³⁰, Kodin e Punës në RSH dhe aktet ligjore e normative në fuqi. Gjithashtu edhe sektori i burimeve njerëzore ka të standartizuar politikat dhe procedurat për qëndrueshmërinë dhe statusin e personelit²³¹.
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni ndjek një procedurë rekrutimi²³² për personelin akademik transparente²³³, të bazuar në merita²³⁴ dhe me angazhimin e disa zyra apo sektorëve²³⁵. Kolegji Universitar "Logos"²³⁶ shpall konkursin për vende të lira pune, referuar kërkesave të cilat ju vijnë nga Departamenti²³⁷, sipas nevojave të evidentuara, dhe njoftimi bëhet jo vetëm në faqen Web të Institucionit, por dhe në të rrjetete sociale apo dhe në portale të tjera të ndryshme punësimi, si dhe në rrjetin e bashkëpunëtorëve²³⁸,²³⁹. Nga shqyrtimi i DVV-së u konstatua se Departamenti²⁴⁰ nuk ka treguar seriozitetin e duhur mbi përcaktimin e kriterëve të kërkuara përse i përket fushës (1.3) për PAE në Punë Sociale, duke lënë hapësirë edhe për punësim nga fusha të tjera. Zyra e burimeve njerëzore pranon aplikimet, verifikon dokumentacionin e paraqitur, nëse është në përputhje

²²⁷ Aneks 11 -Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016

²²⁸ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

²²⁹ Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

²³⁰ Evidenca-60-Ligji i Arsimit të Lartë nr.80, dt.22_07_2015.pdf

²³¹ Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

²³² Evidenca 35. Procedura e rekrutimit.pdf

²³³ <http://www.kulogos.edu.al/al/singlePunesime.html?id=66bb056a3062151701b7a83a>

²³⁴ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

²³⁵ Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

²³⁶ Aneks 121 -Njoftim per punesim te stafit akademik: Aneks 122 -Procedura rekrutimi e stafit akademik 2024-2025

²³⁷ Aneks 127 – Nevojat per personel akademik ne DPP

²³⁸ <http://www.kulogos.edu.al/al/singlePunesime.html?id=64c39aeb91bb8e2edfd3a359>

²³⁹ Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

²⁴⁰ Aneks 127 – Nevojat per personel akademik ne DPP

me dokumentacionin e shpalur në thirrjen për punësim dhe njofton Rektorin dhe Departamentin përkatës për përmbylljen e kësaj faze. Është Rektori autoriteti i cili miraton anëtarët e komisionit *ad hoc* i cili ka në përbërjen e tij përfaqësues nga dekanati, një përfaqësues nga administratori (i cili menaxhon strukturën e BNJ), i cili vijon me procedurat, siç janë intervistat dhe vlerësimet e tjera. Ky komision në përfundim i propozon Rektorit kandidaturën më të përshtatshme dhe është Rektori i cili merr vendimin përfundimtar për punësimin e personelit akademik. Zyra e Burimeve Njerëzore kujdeset që vendimi të jetë konform kriterve të përcaktuara nga baza ligjore në fuqi mbi rregullat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik²⁴¹, Ligjin Nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Ligji për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr.9887 dt.10.03.2008 ndryshuar me ligjin Nr.48/2012 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" etj. Procedurat e përcaktuara nga institucioni në lidhje me afatet, kriteret e përgjithshme dhe specifike për t'u bërë pjesë e stafit akademik të K.U "Logos" janë konform rregullores për burimet njerëzore dhe rregullores së institucionit, dhe në linjë me udhëzimet dhe legjislacionin për arsimin e lartë në vend. Kriteret shpallen publikisht në faqen online të Kolegjit dhe përzgjedhja bëhet me dy faza. Faza e parë është vlerësimi i dosjes, pasi secili kandidat paraqet kërkesën dhe dokumentacionin përkatës pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore ose dhe online ku në bazë të të cilave komisioni i ngritur nga Rektori bën vlerësimin paraprak të kandidaturave sipas kërkesave. Faza tjetër është ajo e intervistimit të kandidatëve, në përfundim të së cilës komisioni dërgon në formë propozimi për miratim në Rektorat kandidatin e përzgjedhur. Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për pedagogë përcaktohen nga departamenti konform ligjit për arsimin e lartë dhe udhëzimeve të tjera në fuqi. Punësimi realizohet me procedurë të konkurrimit të hapur, duke garantuar një process transparent, të paanshëm dhe objektiv²⁴². Duke iu referuar përzgjedhjes së stafit akademik duhet të justifikohet përputhshmëria e tyre në linjë me modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, si dhe duhet të kihet parasysh dhe përzgjedhja e stafit me kualifikim akademik brenda profilit punë sociale, pasi ai psikologjik, sociologjik, administrim socialk dhe i fushave të

²⁴¹ Aneks 124 -Rregullore e Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Arkiv-Protokollit.

²⁴² Aneks 11 -Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016

	përafërta është i përshtatshëm për lëndët ndërdisiplinore e integruese (C) dhe ato plotësuese (D). GVJ konfirmon që institucioni ka miratuar dhe zbaton me rigorozitet procedura rekrutimi dhe vlerësimi që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin minimal të kërkuar të kualifikimit.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Nga vizita në institucion si dhe referuar strukturës akademike dhe ndihmës akademike, numrit të studentëve dhe të infrastrukturës në shërbim të këtij programi²⁴³, gjykojmë se KU "Logos" plotëson më së miri nevojat e studentëve të këtij programi studimi duke garantuar angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për përmbushjen e objektivave të kësaj dege studimi bachelor në "Punë Sociale". Në lidhje me këtë kriter dhe duke analizuar mjediset në dispozicion, laboratorin dixhital edhe kurrikulën e programit të studimit²⁴⁴ konstatojmë se nuk ka orë laboratorike, por institucioni ka në dispozicion një laborator²⁴⁵ ku organizohen orët praktike dhe laborator aplikon inteligjencën artificiale dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor të përshtatshëm për mirëmbajtjen e mjediseve mësimore dhe të laboratorit, i cili përdoret në ndihmë të procesit mësimor. Institucioni ka ndërtuar një strukturë të tërë ndihmës akademike dhe sektorë mbështetës²⁴⁶ të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për mirëmbajtjen e mjediseve në përdorim të studentëve²⁴⁷. Komunikimi me stafin e pranishëm në takim gjatë vizitës në institucion²⁴⁸ na mundësoi të qartësohemi plotësisht në lidhje me këtë aspekt. Vërtetohet se ka procedurë që ndiqen nga njësitë përkatëse përgjegjëse për infrastrukturën dhe mbarëvajtjen e procesit të realizimit të orëve praktike që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të studentëve e stafit të angazhuar.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e	Kolegji Universitar "Logos", nëpërmjet strukturave të tij dhe konkretisht nëpërmjet Departamentit të Pedagogjisë dhe

²⁴³ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

²⁴⁴ Aneks 37 -Plani mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale"

²⁴⁵ Aneks 132 -Email me Forumin Ndërkombëtar për hapje të Laboratorit Punë Sociale në Logos & Aneks 5 -Relacion mbi hapjen e laboratorit të medias dhe edukimit digjital në Kolegjin Universitar LOGOS & Aneks 109 -Leje për përdorim laboratorit i Qendrës së Sipërmarrjes dhe Inovacionit

²⁴⁶ Aneks 37 -Plani mësimor i programit të studimit, "Punë Sociale"

²⁴⁷ Aneks 128 -Planimetria e kampusit nr.1 të Kolegjit Universitar "LOGOS" & Aneks 129 -Format i dokumentit të Licensimit të inxhinjerit që ka supervizuar rikonstruktimin e mjediseve të K.U." LOGOS"

²⁴⁸ Shënime gjatë vizitës në institucion

personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Psikologjisë²⁴⁹ dhe Zyrës të Burimeve Njerëzore²⁵⁰ garanton menaxhim efektiv të personelit të angazhuar në programin e studimit “Punë Sociale”. Zyra e burimeve njerëzore është struktura përgjegjëse për organizimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e procedurave të punësimit të personelit të ri, si dhe atë të promovimit të personelit efektiv. Zyra e sekretarisë mësimore²⁵¹ është përgjegjëse për ndjekjen e procesit të rregjistrimit, matrikullimit për të gjithë studentët e KU “Logos”; monitoron databazën elektronike qendrore të Kolegjit; kontrollon e mban përgjegjësinë për hedhjen e të dhënave në Regjistrin themeltar, Regjistrin e arritjeve akademike dhe Regjistrin e Grupit; merr masat e duhura për ruajtjen dhe mbrojtjen e dokumentacionit sipas legjislacionit; përpilon statistikën dhe të dhënat rreth studentëve; mbajtjen e dokumentacionit të plotë dhe të rregullt mbi të dhënat biografike, të kualifikimit dhe të aktivitetit mësimor-shkencor. Nga vizita në institucion u verifikuan rregullësitë mbi rregjistrat e administruar dhe duke qenë se programi i studimeve “Punë Sociale” është në vitin e tretë të tij Regjistri i lëshimit të diplomave ende nuk administrohej në këtë sekretari²⁵². Zyra e burimeve njerëzore²⁵³ merret me procedurat e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshëm si dhe me stafin ndihmës akademik si dhe plotëson, përditëson dhe ruan dosjet personale të personelit të KU “Logos”; gjithashtu organizon dhe ruan evidencat e vlerësimeve periodike. Departamenti dhe ky sektor dhe mban evidenca për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër²⁵⁴. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik^{255, 256}, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. GVJ kontrolloi në mënyrë rastësore dosje të personelit akademik dhe vërejti se dokumentacioni i tyre ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit dhe rregulloreve të institucionit.
---	---

²⁴⁹ Aneks 200 -Rregullore e departamentit pedagogji psikologji & Aneks 11 -Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016

²⁵⁰ Aneks 124 -Rregullore e Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Arkiv-Protokollit.

²⁵¹ Aneks 173 -Rregullore e Sekretarisë Mësimore KU Logos

²⁵² Aneks 124 -Rregullore e Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Arkiv-Protokollit.

²⁵³ Aneks 11 -Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016

²⁵⁴ 6. Tabelat përmbledhëse.pdf

²⁵⁵ 6. Tabelat përmbledhëse.pdf

²⁵⁶ Aneks 125 -Përmbledhese e dokumentacionit në dosjen e personelit akademik dhe formularë

Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Kolegji Universitar “Logos” ka nënshkruar marrëveshje me një sër institucione dhe organizatash të tjera me qëllim krijimin e gjithë infrastrukturës së nevojshme për realizimin e praktikave profesionale, përmbylljen e studimeve të diplomës dhe të aktiviteteve të tjera formuese për programin e studimit “Punë Sociale” ^{257, 258}. Rregullorja e praktikës profesionale²⁵⁹ përcakton detyrat e departamentit, stafit akademik dhe studentëve. Praktikë mësimore²⁶⁰ profesionale realizohen në institucione të ndryshme private ose publike me të cilët universiteti ka marrëveshje²⁶¹ dhe për këtë proces ka dhe një udhëzues të dedikuar²⁶². Institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar duke marrë në konsideratë edhe nevojat e veçanta të kategorisë AK. Bazuar në informacionin e dosjes së vet-vlerësimit dhe takimeve apo informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GJV konstatoi për përmbushjen e objektivave të këtij program studimi. KU “Logos” ka angazhuar personel akademik dhe kërkues, personel ndihmës akademik dhe personel administrativ në përmbushje të këtij kriteri. Personeli akademik me gradë shkencore “Doktor në proces” dhe “Master Shkencor” janë angazhuar në role të ndryshme si atë të kordinatorit, udhëheqësit për temën e diplomës supervizorit të praktikës dhe veprimtarish të tjera specifike sipas nevojave dhe natyrës të këtij programi studimi.
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë	Kolegji ka nënshkruar një sër marrëveshjes institucionale²⁶³ të lidhura me institucione dhe organizata në funksion të realizimit të vizionit të tij, i cili synon të jetë një qendër moderne e të mësuarit dhe e kulturës për transformimin e jetëve. Ashtu siç dhe na u konfirmua nga vizita në institucion, këto marrëveshje janë gjithashtu dhe një mundësi më tepër për përmbushjen e objektivave formuese në funksion të procesit mësimor për programin e studime bachelor “Punë Sociale”. Mbështetja e studentëve është e pakushtëzuar nga ana e KU duke ju

²⁵⁷ Aneks 196 -Lista e marrëveshje të partneritetit në funksion të programit të studimit

²⁵⁸ <http://www.kulogos.edu.al/al/collaborations.html> ; <http://www.kulogos.edu.al/al/projects.html> & <http://www.kulogos.edu.al/al/erasmus.html>

²⁵⁹ Aneks 45 -Udhëzues mbi Praktikën Mësimore Pasive në Arsimin e Lartë: Struktura, Metodën dhe Përfshirja Studentore

²⁶⁰ Aneks 126 -Analiza përfundimtar i praktikave të studentëve

²⁶¹ Aneks 196 -Lista e marrëveshje të partneritetit në funksion të programit të studimit

²⁶² Aneks 45 -Udhëzues mbi Praktikën Mësimore Pasive në Arsimin e Lartë: Struktura, Metodën dhe Përfshirja Studentore

²⁶³ Aneks 196 -Lista e marrëveshje të partneritetit në funksion të programit të studimit & <http://www.kulogos.edu.al/al/collaborations.html> ; <http://www.kulogos.edu.al/al/projects.html> & <http://www.kulogos.edu.al/al/erasmus.html>

pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	mundësuar studentëve një sër kontaktesh²⁶⁴, ndërsa duke qënë se ky program ka një fokus të mirëfilltë aplikativ, sygjerohet ndërtimi i strukturave të mirëfillta për të garantuar praktikën sa më profesionale të studentëve dhe asistimin në të edhe të profesionistëve punonjës social, mundësisht nga ata të licensuar si të tillë. <i>GVJ i sygjeron institucionit të ndërtojë politika specifike për organizimin e praktikës për Programin "Punë Sociale", duke përcaktuar në to dhe mënyrën e përzgjedhjes së personelit mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale, me detyrimet përkatëse të studentëve për t'u përmbushur gjatë praktikave dhe me kriteret e vlerësimit pasi punonjësi social është një profesion i rregulluar dhe praktika profesionale është një element kyc.</i>			
Konkluzione	GVJ referuar dokumentacionit në lidhje me ngarkesën e stafit akademik të angazhuar në këtë programi studimi na lejon që të shprehemi se ai përmbush standardet sasiore, ndërsa përsa i përket kualifikimit të posaçëm akademik gjykojmë se një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë kualifikimin akademik në profilin psikologjik dhe fusha të tjera të përafërta dhe vetëm një pjesë e vogël në punë sociale, mundësisht në të tre cilket e studimit në këtë disiplinë. <i>Ndaj sygjerojmë që KU "Logos" të impenjohet në përfshirjen në këtë program të personelit akademik me kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën punë sociale për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të	Kolegji Universitar "Logos" është një institucion që siguron mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse ²⁶⁵ . Aktiviteti i tij

²⁶⁴ Aneks 36 -Vlerësimet që institucionet mikëpritëse të praktikës iu kanë bërë studenteve

²⁶⁵ 6. Tabelat përmbledhëse.pdf (Tabela 16)

përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	ushtrohet në dy kampuse, një në Durrës dhe tjetri në Tiranë, ku Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor (krijuar si njësi bazë në përputhje me Urdhrin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 408, datë 13.07.2018), Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë) i cili ofron programin e studimit "Punë Sociale" gjendet në Kampusin 1, Rruga: "Dritan Hoxha" përballë Pallatit të Sportit "Asllan Rusi", pranë Zogut të Zi. Mjediset²⁶⁶ ku ofrohet ky program e përmbushin këtë kriter nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjediseve të nevojshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse²⁶⁷. Mjediset e godinave plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral. Personeli akademik ka një zyrë të veçantë, e cila shërben edhe si zyrë mbledhëse dhe takimesh. IAL disponon gjithashtu auditorë për leksione/seminare, salla kompjuteri dhe laborator, sallë interneti, të pajisura me infrastrukturën bazike mësimore. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerëzore, IT, Biblioteka janë të akomoduar në mjediset e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktivitetit të tyre²⁶⁸. Mësimi në Programin e studimit Bachelor në "Punë Sociale" ka në dispozicion salla leksioni, seminari, zyra dhe një sallë laboratorit të cilat kanë infrastrukturën e duhur për një proces normal të të nxënësve dhe me facilitetet e duhura për t'i ardhur në ndihmë dhe studentëve AK²⁶⁹.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e	Nga vizita në institucion konfirmojmë se të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektor, laptop, whiteboard, platform online dhe të gjitha mjetet e tjera logjistike²⁷⁰. Mjediset mësimore në dispozicion të programit të studimit "Punë Sociale" janë salla për leksion; klasa për seminare; sallë për aktivitete promovionale; një laborator për lëndët me orë praktike, të cilat janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet), që mundësojnë zhvillimin e mësimin në kushte bashkëkohore²⁷¹.

²⁶⁶ Aneks 128 -Planimetria e kampusit nr.1 të Kolegjit Universitar "LOGOS"

²⁶⁷ Aneks 129 -Format i dokumentit të Licensimit të inxhinjerit që ka supervizuar rikonstruktimin e mjediseve të K.U. "LOGOS"

²⁶⁸ Aneks 129 -Format i dokumentit të Licensimit të inxhinjerit që ka supervizuar rikonstruktimin e mjediseve të K.U. "LOGOS"

²⁶⁹ Shënime gjatë vizitës në institucion

²⁷⁰ Shënime gjatë vizitës në institucion

²⁷¹ Aneks 130 -Prezantimi i detyrave të kursit duke përdorur mjetet e teknologjisë dhe informacionit

praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Vlen të përmendet fakti se institucioni ka një vëmendësim ndaj të gjithë nevojave të studentëve, duke ju krijuar akses në të gjithë mjediset e tij edhe studentëve me nevoja të veçanta²⁷².
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vizita në institucion, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit DVV rezulton se mjediset mësimore të ofruara nga KU "Logos" janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme²⁷³, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike. Programi i studimit kryen aktivitetin e tij në Godinën e Kampusit 1, ku institucioni siguron hapësirë të përshtatshme, të tilla si: laboratore, klasa, zyra dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe teknologji informacioni, siç janë: videoprojektorët, kompjuteret dhe interneti për të realizuar programin e studimit²⁷⁴. Mjediset mësimore, auditoret, janë të mirëpajusura me tabela dhe dërrasa dhe në çdo klasë ka të instaluar pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit (si PC, videoprojektor, TV, kamera dixhitale dhe pajisje CD /DVD/VHS)²⁷⁵. Rrjeti i internetit është shtrirë në të gjithë mjediset e universitetit, në mjediset mësimore dhe në të gjitha mjediset e tjera rrethuese. Në institucion ndodhet dhe zyra e IT, e cila asiston me teknologjinë e informacionit në të gjithë rastet e nevojshme, por gjithashtu asistohen dhe studentët me nevoja të veçanta nga i gjithë stafi akademik dhe administrativ²⁷⁶. Klasat dhe auditoret e Kolegjit janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një proces efektiv të mësimdhënies në përputhje me qëllimet e programit. Gjithashtu në këtë program përdoren metodologjitë teknologjike bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies, sisteme që mundësojnë përditësimin dhe ndërveprimin me materialet e lëndës dhe me pedagogun përgjegjës. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmon se mjediset mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit dhe që garantojnë realizimin e procesit mësimor. Më shumë se 50% e hapësirës anësore të të

²⁷² Aneks 50 -Udhëzuesi individual për studentët AK, hartuar nga Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë dhe Aneks 51 -Draft Rregullore për "Shërbimet Mbështetëse për Studentët me Aftësi Kufizuar

²⁷³ Aneks128 -Planimetria e kampusit nr.1 të Kolegjit Universitar "LOGOS" & Aneks129 -Format i dokumentit të Licensimit të inxhinjerit që ka supervizuar rikonstruktimin e mjedisëve të KU "LOGOS"

²⁷⁴ 6. Tabelat përmbledhëse.pdf

²⁷⁵ Shënime gjatë vizitës në institucion & <http://www.kulogos.edu.al/al/distance-learning.html>

²⁷⁶ Aneks 131 -Foto nga ambientet e KU "Logos"si: kompjuter, video-projektor, kamera, tabelë smart, etj]

	gjitha sallave ku realizohet mësimi është me dritare, duke garantuar ndriçim natyror dhe ajrosje të mjaftueshme.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Kur flasim për profesionistë të fushës punë sociale dhe programin e studimit i cili i referohet këtij dimensionit profesional, jemi në një fushë të shkencës të aplikuar dhe si e tillë ndikimi laboratorik nuk është aq i rëndësishëm sa ndikimi praktik, i cili këshillohet të realizohet nëpërmjet seminareve ose në mënyrë më të drejtpërdrejtë nëpërmjet praktikës pasive dhe profesionale në institucione me aplikimin dhe të teknologjisë²⁷⁷. Në mjediset e institucionit ka një mjedis laboratorik, pajisje dhe aparatura të cilët vihen në përdorim të studentëve²⁷⁸ sipas kërkesave të tyre për realizimin e detyrave të kursit ose edhe për aktivitete të tjera jashtëshkollore dhe aktivitete të ndryshme studentore. Labororet e teknologjisë së informacionit që janë në funksion të zbatimit të këtij program studimi²⁷⁹, janë të kompletuar me pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet) dhe janë të aksesueshëm për të gjithë studentët. Laboratori ishte në dispozicion të studentëve për të realizuar detyrat, disa orë edhe për mësimdhënie edhe për takimet apo projektet e ndryshme studentore. Studentët dhe stafi akademik kanë akses në një sër aplikacionesh dhe programesh teknologjike dhe si na u konfirmua gjatë vizitës në institucion edhe në inteligjencën artificiale. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmon se mjediset e vëna në dispozicion përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve siç janë vidioprojektorët, mjetete audiovozove, interenti apo edhe tabelat e shënimeve, të cilat mundësojnë aftësimin teorik e praktik dhe realizimin e objektivave formues të programit të studimit punonjës social.			
Konkluzione	GVJ konkluton se mjediset mësimore dhe infrastruktura e vënë në dispozicion nga KU "Logos" është e përshtatshme, garanton realizimin e procesit mësimdhënës dhe formimin teorik, ndërsa në atë praktik, të posaçëm referuar natyrës dhe fushës së studimit në punë sociale, duhen të bëhen më tepër përpjekje nga ekspertët e fushës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

²⁷⁷ Aneks 24 -Asistecë teknike nga IT i Kolegjit Universitar LOGOS

²⁷⁸ Aneks 18 -Relacion mbi infrastrukturën e godinës së Kolegjit Universitar LOGOS

²⁷⁹ Aneks 132 -Email me Forumin Ndërkombëtar për hapje të Labororit Punë Sociale në Logos

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme)

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë në gjuhën shqipe²⁸⁰, e cila është dhe gjuha e realizimit të këtij programi studimi përfshin tekste të cilat nëse i referohemi syllabuseve të lëndëve mësimore të vënë në dispozicion krijojnë hapsira për përmirësim. Një pjesë e literaturës bazë gjykohej si literaturë akademike, dhe pse jo e 5 viteve të fundit, jo e përditësuar duke mos plotësuar marrjen e dijeve bashkëkohore nëpërmjet leksioneve të vënë në dispozicion nga pedagogu i lëndës. <i>Por duhet riparë literatura me fushën e punës sociale si dhe duhen referuar botime të viteve të fundit, ashtu dhe autorë vendas.</i> Përsa i përket literaturës në formë elektronike²⁸¹ në gjuhë të huaj mund të thuhet se është bërë një përpjekje pozitive përmes abonimit në bibliotekën online²⁸² rezultojnë se për nevojat e studentëve janë vënë në dispozicion një sër platformash elektronike, të cilat mund të lehtësojnë aksesin në burime bibliografike të viteve të fundit dhe që janë publikime shkencore të indexuara dhe me faktor impakti. Sfidë për studentët e këtij programi studimi mbetet niveli i njohurive në gjuhën angleze ose greke me qëllim që të përfitojnë nga këto mundësi që u krijohen nga insititucioni, të cilat vijojnë të përmirësohen²⁸³. <i>GVJ sugjeron se ky aspekt garantohej, por ka ende hapsira për përmirësim duke rishikuar programet e studimit me përmirësim mbi literaturën bazë dhe të detyruar të përditësuar me tekste akademike veçanërisht ato të punës sociale të 5 viteve të fundit.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të	Duke iu referuar dokumentacionit të DVV të shqyrtuar një tjetër aspekt lidhet me kërkesën për tituj nga ana e njësive bazë sipas të cilës ka dhe metodologji për përzgjedhjen e teksteve për këtë departament ²⁸⁴ .

²⁸⁰ Aneks 134 -Lista e Titujve te Librave & Aneks 44-Syllabuse 2023-2024

²⁸¹ Aneks 137 -Adresa JSTOR, EBSCO

²⁸² <http://www.kulogos.edu.al/al/books.html>

²⁸³ Aneks 135 -Email dhe Fondi e librave të Bibliotekës së KU. " LOGOS" për Programin "Punë Sociale"

²⁸⁴ Aneks 140 -Format Relacion për Fondi i Bibliotekës së KU LOGOS

literaturës me botime të viteve të fundit.	Duke iu referuar burime të literaturës në format libër fizik, të depozituar dhe të aksesueshëm lirisht nga stafi dhe studentët e këtij programi studimi²⁸⁵ numri i titujve në fushën e punës sociale, në bibliotekën e institucionit, të cilat janë kryesisht në gjuhën shqipe dhe disa në gjuhë huaj është rreth 90. Nga vizita në bibliotekë rezultoi se aty ka investime për mënyrën e aksesimit të librave online, por dhe hapësirë fizike, vendqëndrime për lexime, kompjutera me akses të drejtëpërdrejtë në literaturë, apo për infrastrukturën në përgjithësi²⁸⁶. Një pjesë e botimeve të përditësuara të bibliotekës së KU "Logos" janë dhe botime të vetë stafit akademik. <i>GVJ sygjeron që të adresohet sa më herët pasurimi me literaturë të përditësuar në gjuhën shqipe me tekste akademike punë sociale. Të përpilohen rregullore dhe të forcohen politikat e institucionit të cilat të përcaktojnë procedurat për përditësimet e literaturës të silabuseve dhe reflektimin e tyre të menjëhershëm në fondin e bibliotekës dhe aksesimin nga studentët e programit punë sociale.</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e KU "Logos"²⁸⁷ është në dispozicion të studentëve dhe operon pa pagesë për të gjithë studentët e universitetit. Në këtë Institucion²⁸⁸ gjenden gjithsej 2 biblioteka në secën prej kampuseve, të cilat bashkëpunojnë edhe për shkëmbimin e fondit të librave ndërmjet tyre. Biblioteka, e cila ndodhet në të njëjtën godinë ku organizohen edhe studimet e programit "Punë Sociale", ka një sipërfaqe prej 173 m², gjë e cila garanton akses dhe mundësi të barabartë shfrytëzimi për të gjithë studentët e këtij institucioni. Biblioteka e vizituar nga GVJ-ja ndodhet në katin 3 të godinës së Kolegjit, me mbi 40 vende leximi dhe 18 poste për shfrytëzimin e bibliotekës on-line²⁸⁹. Biblioteka mbulon një sër shërbimesh si arkivim të çdo kopje të libri të ri fizik që hyn, dixhitalizim të skedarëve, vendadresim i stafit dhe studentëve për nevojat që lidhen me literaturën mësimore²⁹⁰, kërkimore dhe ekstrakurrikulare, me një fond mbi 26330 titujsh në gjuhë të huaj dhe në shqip²⁹¹. Si një bibliotekë me fonde të hapura dhe hibride, ajo mundëson kërkim të informacionit "online",

²⁸⁵ Aneks 135 -Email dhe Fondi e librave të Bibliotekës së K.U. "LOGOS" për Programin "Punë Sociale"

²⁸⁶ Aneks 139 -Plani Strategjik i Bibliotekës. Plan i detajuar strategjik për përditësimin e fondit

²⁸⁷ <http://www.kulogos.edu.al/al/books.html>

²⁸⁸ Evidencw 6. Tabelat përmbledhëse.pdf

²⁸⁹ Shënime gjatë vizitës në institucion

²⁹⁰ Shënime gjatë vizitës në institucion

²⁹¹ Shënime të vizitës në institucion

	në sallën e leximit, skedarë elektronikë, lehtësira në kërkimin bibliografik të informacionit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike pranë kompjuterave të sallës. Biblioteka është lehësisht e aksesueshme nga të gjithë studentët dhe stafi akademik. GVJ konfirmojnë që ambjenti ishte i përshtatshëm me ajër dhe ndriçim natyral, me vendosje të tavolinave në mënyrë që shfrytëzimi i tyre të bëhet në mënyrë të barabartë nga studentët. Studentët kanë të drejtë të huazojnë libra dhe të përdorin shërbimet e bibliotekës gjatë gjithë kohës.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Bibliotekat e Kolegjit Universitar "Logos" funksionojnë sipas Ligjit Nr. 8576, datë 3.2.2000 "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve rregullative të institucionit. Literatura bazë në gjuhën shqipe, e cila është dhe gjuha e realizimit të këtij programi studimi, paraqet disa mangësi në shumëllojshmëri, kryesisht atë të punës sociale. Janë bërë investime mbi hapësirat fizike dhe mbi infrastrukturën në përgjithësi në vitin 2019. Përsa i përket literaturës në formë elektronike në gjuhë të huaj mund të thuhet se është bërë një përpjekje pozitive përmes ndërtimit të marrëdhënieve me disa biblioteka në vend dhe abonimit dhe aksesimit të bibliotekave ndërkombëtare online²⁹². Biblioteka bashkëpunon dhe me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë me një fond të pasur²⁹³. <i>GVJ sygjeron që të merren masat e nevojshme nga organet drejtuese të Kolegjit në mënyrë që për të gjithë modulet e veprimtarive mësimore të programit "Punë Sociale" që në bibliotekë të gjenden, jo vetëm tekstet mësimore bazë, por dhe literatura ndihmëse, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të përditësuara referuar specifikës së programit të studimit.</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Kapacitetet e bibliotekës garantojnë mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë e pa pagesë nga të gjithë studentët e programit të studimit dhe nga i gjithë stafi akademik, por dhe nga lexues të tjerë. Biblioteka përfaqësohet në Bibliotekën Virtuale të Shqipërisë "COBISS.AL", dhe koleksioni i saj përpunohet nga ana shkencore bibliografike konform standardeve ndërkombëtare duke përdorur UDC (sistemi i klasifikimit), ISBD (International Standard Bibliographic Description), formatin MARC, Z39.50 SRU. Kolegji ofron platformën e bibliotekës digjitale në dy nga fondet më të pasura

²⁹² <http://www.kulogos.edu.al/al/books.html>

²⁹³ Aneks 135 -Email dhe Fondi e librave të Bibliotekës së KU. "LOGOS" për Programin "Punë Sociale"

	akademike Jstore dhe Ebsco ²⁹⁴ . Shërbimi i informacionit elektronik ofrohet me e-mail/katalog elektronik. Çdo student ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë dhe të aksesit të platformave online.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka në godinën ka një hapsirë të konsiderueshme, lehtësisht të aksesueshme dhe me vende leximi dhe pajisje kompjuterike dhe pajisje të cilat mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë përdoruesit e saj jo vetëm të studentëve. Biblioteka gjithashtu është e pajisur me programet kompjuterike të shërbimeve të bibliotekës dhe me pajisjet teknike si kompjutera me akses në internet ²⁹⁵ . Në këtë bibliotekë mundësohet shfrytëzimi i sistemeve me bazë “kod në burim të hapur”, si modul i sistemit të integruar për menaxhimin e fondit të Bibliotekës. Për përdorimin e bibliotekës online në dispozicion të studentëve dhe të të interesuarve janë në dispozicion punonjëset e bibliotekës për lehtësimin dhe asistimin në shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë literaturën e nevojshme.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka qëndron e hapur çdo ditë nga ora 08.00 – 18.00, në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj, kështu për periudhat e sezonit të provimeve orari shtyhet deri në orën 21.00 dhe gjatë fundjavave orari është nga ora 09.00-17.00. Oraret e shërbimit janë të përcaktuara më specifikisht në referencë edhe të orareve të proceseve dhe strukturës mësimore. Nga vizita në bibliotekë konfirmohet se punonjësjë e saj ishte duke kryer procese pune, të gatshme t’i shërbenin të interesuarve. Sipas punonjëses së bibliotekës ky orar krijonte kushte optimale për akses tek fondi i librave. Hapësira fizike dhe kapaciteti i saj i jepnin mundësi një numri të konsiderueshëm studentësh për shfrytëzim të ambjenteve në të njëjtën kohë, dhe duke pasur mundësi për shfrytëzimin e disa këndeve të saj që të lejonin të punojë në privatësi dhe pa u shpërqëndruar. Të gjithë të interesuarit mundet gjithashtu që të vihen në kontakt me punonjësen e bibliotekës dhe të kërkojnë shërbime dhe informacione edhe më të specializuara. ²⁹⁶

²⁹⁴ Aneks 137 -Adresa JSTOR, EBSCO

²⁹⁵ 6. Tabelat përmbledhëse.pdf

²⁹⁶ Aneks 138 -Relacion mbi Disponueshmërinë dhe Fleksibilitetin e Orarit të Bibliotekës për Studentët

Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Bazuar në dokumentacionin që na është vënë në dispozicion në DVV²⁹⁷, për programin e studimit “Punë Sociale”, dhe vizitës në institucion²⁹⁸ u informuam se secili pedagog harton periodikisht kërkesat për tituj librash për programin dhe biblioteka për përditësimin e fondit fizik, të cilat janë vlerësuar nga institucioni. Nga vizita në bibliotekë rezultoi se është pasuruar fondi i librave, por nga një analizë e shpejtë e titujve reflektohet mungesa e literaturës dedikuar specifikisht punës sociale. Gjenden literatura bazë dhe ndihmëse të fushës sociale. Përsa i përket fondit të librave online ai është rritur dhe përditësuar, kjo dhe falë bashkëpunimeve dhe projekteve, por kjo literaturë është kryesisht në anglisht dhe në gjuhë të tjera të huaja, por jo në shqip. <i>GVJ sugjeron shtimin e fondit të librave veçanërisht të fushës punë sociale në ndihmë të studentëve e të personelit akademik të kësaj dege studimi.</i>			
Konkluzione	GVJ bazuar në këtë standart gjykon se institucioni ka vënë në dispozicion mjediset mbështetëse të mësimnxënies, si bibliotekën dhe mjediset e tjera mbështetëse, por përsa i përket literaturës GVJ sugjeron shtimin e fondit të librave veçanërisht të fushës punë sociale, i të pakten 5 viteve të fundit, dhe të përafruara me literaturën bazë e të detyrueshme që sot përdor UT.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

²⁹⁷ Aneks 138 -Relacion mbi Disponueshmërinë dhe Fleksibilitetin e Orarit të Bibliotekës për Studentët; Aneks 139 -Plani Strategjik i Bibliotekës.Plan i detajuar strategjik për përditësimin e fondit; Aneks140 -Formati Relacion për Fondi i Bibliotekës së KU LOGOS &Evidenca 42. Material per biblioteken.pdf

²⁹⁸ Shënime gjatë vizitës në institucion

Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sipas dokumentacionit të DVV-së institucioni përdor një sistem informimi për studentët, që nga fletëpalosjet²⁹⁹ apo me anë të shpërndarjes së dokumentacioneve në hard copy³⁰⁰, sistemin elektronik dhe të faqes Web³⁰¹ të Kolegjit apo dhe me njoftime me shpallje në këndin e informimit të institucionit. Të gjithë format e informimit të cilat lidheshin me studentët njiheshin nga ata, ata zotëronin informacion të plotë që në fazat e para të regjistrimit në Kolegj deri tek mënyrat e diplomimit, studentët gjithashtu kanë dhe hapësirën e vet në portalin studentor të institucionit³⁰².
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Referuar statutit³⁰³ të Kolegjit, planit të zhvillimit strategjik³⁰⁴ dhe rregullores së tij³⁰⁵, administrimi i informacionit menaxhohet sipas strukturave përgjegjëse të institucionit. Ky informacion ruhet në formën hardcopy dhe elektronike në disa njësi të universitetit, siç janë: Fakulteti³⁰⁶, Departamenti³⁰⁷, Kolegji, Zyra e Burimeve Njerëzore³⁰⁸, Sekretaria mësimore³⁰⁹ dhe një sër zyrash të tjera të cilat secila sipas funksionit është e mandatuar të menaxhojë, monitorojë, krijoj apo auditoj aktivitete të ndryshme të personelit akademik, ndihmës akademik administrativ apo dhe të tjera veprimtari jashtë universiteti. I gjithë komunikimi në Kolegjin Universitar mundësohet përmes rrjetit të brendshëm të tij dhe sistemit Edupage³¹⁰, i cili garanton ndarjen në mënyrë të sigurt të informacioneve universitare dhe burimet kompjuterike prej nga nisen këto informacione. Gjithashtu institucioni përdor dhe platformat Outlook dhe Teams të cilat lehtësojnë këtë proces.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni zbaton me rigorozitet detyrimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale që lindin nga Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008 dhe gjithë akteteve të tjera ligjore³¹¹ mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve të sektorit privat.

²⁹⁹ Aneks 141 -Fletë palosje

³⁰⁰ Aneks 142 -Guida e studentëve

³⁰¹ Aneks 143 -<http://www.kulogos.edu.al/al/index.html>

³⁰² <http://kulogos.edu.al/al/student-portal.html>

³⁰³ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

³⁰⁴ Aneks 13 -Plani Strategjik i Zhvillimit, 2018-2024 (Tiranë 2018)

³⁰⁵ Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

³⁰⁶ Aneks 11 -Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016

³⁰⁷ Aneks 9 -Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

³⁰⁸ Aneks 125 -Përmbledhese e dokumentacionit në dosjen e personelit akademik dhe formularë

³⁰⁹ Aneks 124 -Rregullore e Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Arkiv-Protokollit.

³¹⁰ <https://kulogos.edupage.org/>

³¹¹ Aneks 107 -Materiale Komunikimi

	Sistemi SMS³¹² siguron në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Çdo përdorues ka kodin dhe fjalëkalimin e tij në sistemin e menaxhimit të të dhënave.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Bazuar në dokumentet e dorëzuar në DVV³¹³, lundrimi në faqen zyrtare të kolegjit³¹⁴ dhe vizita në institucion³¹⁵, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion për komunikimin e brendshëm interaktiv të stafit akademik dhe studentëve platformën LSM (Edupage dhe Teams). Sistemi i menaxhimit komfirmohet edhe nga studentët se ju ofron akses në një fushë të gjerë informacioni si regjistrimi dhe informimi në lëndët përkatëse, aksesit i plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin dhe në informacionet shitesë dhe ndihmëse, vlerësimet e vijueshme nga pedagogu, vlerësimet përfundimtare të lëndës. Të gjithë përdoruesit kanë akses në informacion dhe mund të menaxhojnë detyra dhe aktivitete në lidhje me punën, sipas rolit dhe pozicionit të tyre të punës nëpërmjet Edupage³¹⁶. GVJ nga vizita në institucion³¹⁷ dhe takimet me stafin akademik dhe studentët e konfirmuan shkëmbimin në kohë reale të informacioneve dhe të njoftimeve që realizoheshin nëpërmjet sistemeve të menaxhimit dixhital.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Për të gjithë përdoruesit e tij, sistemi i menaxhimit siguron transmetim e monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik, administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për ta. Të dhënat me më tepër frekuencë janë listat emërore të studentëve, raportimet statistikore mbi kurset, notat, aplikimet për bursë, por dhe të dhëna të tjera si oraret dhe frekuentimet dhe kërkesat e tjera ligjore. Nga vizita në institucion, dhe konkretisht në zyrën e sekretarisë mësimore aksesuam sistemin dhe në kohë reale u informuam për shënimet në regjista nga pedagogët e lëndëve. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimi të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti. Po ashtu institucioni ruan dhe komunikimin dhe koordinimin midis stafit akademik dhe studentëve si fizikisht ashtu dhe me anë të kontakteve

³¹² <https://kulogos.edupage.org/privacy/>

³¹³ Evidenca 31. Manual i përdorimit të platformes elektronike.pdf

³¹⁴ <http://kulogos.edu.al/al/index.html>

³¹⁵ Shënime gjatë vizitës në institucion

³¹⁶ Aneks 144 -Evidenc përdorimi Edupage/Teams

³¹⁷ Shënime gjatë vizitës në institucion

	telefonike dhe e-maileve zyrtare të tyre dhe platformave sociale. GVJ gjatë vizitës në institucion dhe kryesisht gjatë takimit me studentë konfirmoi që të gjithë përdoruesit kanë akses në informacionet e tyre të personalizuar sipas roleve dhe njësive përkatëse. Stafi akademik dhe administrativ çlirohen nga detyrat e lodhshme manuale. Sistemi i menaxhimit u siguron atyre informacione të përditësuara.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare të KU "Logos" http://www.kulogos.edu.al/al/mision.html# paraqitet një informacion i plotë mbi historikun, misionin dhe filozofinë, partnerët, stafin drejtues dhe administrimin, guidat për studentët e ardhshëm si dhe mbi programet, së bashku me botimet e kolegjit dhe kërkimet shkencore, etj. Përmes saj, por edhe rrjeteve sociale, institucioni promovon veprimtaritë e ndryshme me karakter akademik por edhe social-kulturor. Kjo faqe bën publikimin në dy gjuhë, shqip dhe anglisht³¹⁸. Faqja Web paraqet në mënyrë të strukturuar informacione mbi universitetin, pranimet, fakultetet, programet e studimit, për studentët³¹⁹, si jeta studentore, klubi studentor, këshillat, financimet dhe bursat, projektet dhe shërbimet për studentë. Kjo faqe është lehtësisht e aksesueshme dhe në të gjendet informacion i përgjithshëm mbi pranimin dhe bursat³²⁰, objektivat e programit dhe kurrikulat. Kolegji jep informacion të dedikuar për studentët e tij dhe jetën akademike, por i kushton vëmendje dhe aspekteve të tjera zhvillimore rinore nëpërmjet faqes së dedikuar studentëve, kërkimit shkencor, ndërkombtarizimit dhe Erasmus³²¹. Gjatë vizitës GVJ konstatoi se informacionet e publikuara në faqen e internetit ishin të përdorshme e të nevojshme për studentët.			
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe në informacionet e marra gjatë vizitës në institucion gjykon se KU "Logos" disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional LSM dhe e ka vënë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për të gjithë universitetin, ashtu dhe për programin e studimit "Punë Sociale".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

³¹⁸ <http://www.kulogos.edu.al/en/sociale.html>

³¹⁹ <http://www.kulogos.edu.al/al/student-affairs-office.html>

³²⁰ <http://www.kulogos.edu.al/al/scholarship.html>

³²¹ <https://erasmus.kulogos.edu.al/>

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në të dhënat e shqyrtuara nga GVJ, në materialet e DVV-së informohemi se Kolegji Universitar “Logos” ka hartuar dhe miratuar buxhetet afatmesëm³²², ku ka marrë në konsideratë të gjithë mundësitë e mundshme të gjenerimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve të nevojshme, vlen të përmendet fakti se kjo IAL është e mbështetur fort nga Fondacioni “Logos”³²³. Fondacioni “LOGOS” është krijuar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin nr.284, dt.26.06.2008 dhe objekti i veprimtarisë së tij është hapja dhe funksionimi i institucioneve arsimore si: IAL, institute të formimit profesional etj. Nga shqyrtimi i DVV-së nuk rezulton raport financiar specifik për programin të studimit Bachelor në “Punë Sociale” dhe nuk mund të gjenerojmë dot të dhëna financiare sipas zërave përkatës për këtë program. Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua dhe fondacioni garanton në total shpenzimet për të gjithë IAL-në sipas kërkesave të Bordit të Administrimit. GVJ nuk arriti të evidentoj pasqyra dhe raporte financiare të të ardhurave e shpenzimeve të Departamentit dhe specifikisht planin³²⁴ për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi, si dhe nuk evidentoi raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit “Punë Sociale” dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi nga universiteti. <i>Ndaj në këto kushte GVJ sygjeron që të ndërtohen politika specifike për çdo njësi bazë përgjegjëse për programet e studimit dhe të hartohen e miratohen plane për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit “Punë Sociale” për të paktën një cikël të plotë studimi.</i>

³²² Aneks 148 -Miratim Buxheti qe harton Administrata e institucionit në përgjegjësinë e Administratorit per projekt buxhetin afat mesëm dhe atë të vitit respektiv.

³²³ <http://www.kulogos.edu.al/al/foundation.html>

³²⁴ Aneks 146 -Sugjerimet e njësisë bazë mbi përpilimin e Projekt-Buxhetit

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Bordi i Administrimit është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të Kolegjit Universitar “Logos”, referuar statusit³²⁵ dhe akteve të tjera rregullative, i cili garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit, miraton rregulloret financiare në këtë IAL, përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni dhe mbikqyr përdorimin e burimeve të financimit, si dhe miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit. Përgjegjësi e Bordit të Adminiustrimit është dhe emërimi dhe shkarkimi i administratorit të Kolegjit Universitar “Logos”. Nga DVV³²⁶ e shqyrtuar arritëm të evidentonin miratimin e buxhetit sapo projekt buxhetin afat mesëm apo dhe raport auditimi, por nuk u evidentua plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse (Departamenti Pedagogjisë dhe Psikologjisë) për programin e studimit “Punë Sociale”.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Kolegji Universitar “Logos” kryen auditim të përvitshëm bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe nga shqyrtimi i DVV-së, GVJ nuk konstatoi periodicitet të auditimeve ku të mund të evidentohet edhe dokumentacioni i gjendjes financiare nga viti në vit për periudhën e auditimit, dhe as vlerësimi i vijueshëm i efektivitet financiar të mundshëm. Institucioni kryen auditim dhe për këtë evidentohet edhe raporti i auditit të jashtëm³²⁷. Raporti i fundit i auditit të jashtëm është hartuar nga “K&L Auditing” shpk i cili përfshin pozicionin financiar më datën 31 Dhjetor 2023. Me anë të këtij dokumenti në informohemi se Fondacioni “Logos” plotëson të gjithë standardet e nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e plotë të aktiviteteve duke siguruar plotësimin e të gjithë kriterëve ligjore të Standardadeve të Cilësisë.

³²⁵ Aneks 1 Rregullo - Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS, neni 10

³²⁶ Aneks 14 Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017: Aneks 13 -Plani Strategjik i Zhvillimit, 2018-2024 (Tiranë 2018); Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit te programit SPS.pdf; Evidenca 16.1_16.2_16.3. Tabela e raportit financiar.pdf; Evidenca 15. Permbledhese e tabelave.pdf Tabela 18

³²⁷ Aneks 149 -Raporti i Audituesit të jashtëm i paraqitur Bordit Drejtues të Fonacionit i bashkëshoqëruar nga pasqyrat financiare te vitit financiar respektiv

Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Referuar shqyrtimit të 'DVV-së, Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal, i cili garanton si përmbushjen e misionit të Institucionit ashtu dhe mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij dhe zyra e financës është përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikës ndjek zbatimin e gjithë procedurave financiare të realizimit të pagesave, shpenzimeve, investimeve, të ndarjes dhe realizimit të buxhetit³²⁸. Një nga detyrat e kësaj zyre është dhe analiza, llogaritja, përgatitja dhe kryerja e pagesave e të gjitha shpenzimeve³²⁹. Nga takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion³³⁰ ata na konfirmuan se ishin pjesë e analizave vjetore të punës së institucionit, dhe në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit "Punë Sociale" dhe informoheshin mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Nga shqyrtimi i DVV-së evidetohet raporti i auditit të jashtëm për shpenzimet dhe të ardhurat e realizuara për vitet 2023-2024³³¹, por raportimet janë në nivel universiteti, duke mos mundur kuptueshmërinë mbi realizimin e buxhetit specifikisht për këtë program studimi.
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion³³² në raportin e GVB-së dhe vizitës pranë Kolegjit Universitar "Logos", GVJ ka konkluduar se institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve, kjo pasi ai ka mbështetjen e Fondacionit "LOGOS" i cili është një garanci për ecurinë dhe zhvillimin e programeve dhe specifikisht edhe në mbështetjen me bursa të studentëve të cilët i përkasin kategorive në nevojë. Gjithashtu institucioni është i përfshirë në disa projekte të cilat sigurojnë mbështetje si me infrastrukturën (laboratorët apo programet kompjuterike) por dhe me rritjen e kapaciteteve të stafit akademik. Ndaj GVJ është e mendimit se referuar programit të studimit Bachelor në "Punë Sociale" dëshmohej një qëndrueshmëri financiare për sigurimin në vijimësi të veprimtarive akademike të programit, e cila vjen nga garancia e sigurisë së institucionit.
Konkluzione	GVJ gjykon se bazuar në evidencat e mësipërme, institucioni i arsimit të lartë Kolegji Universitar "Logos" garanton

³²⁸ 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017, neni 28 dhe 54

³²⁹ 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017, neni 54

³³⁰ Shënime gjatë vizitës në institucion

³³¹ Aneks 149 -Raporti i Audituesit të jashtëm i paraqitur Bordit Drejtues të Fonacionit i bashkëshoqëruar nga pasqyrat financiare të vitit financiar respektiv

³³² Aneks 149 -Raporti i Audituesit të jashtëm i paraqitur Bordit Drejtues të Fonacionit i bashkëshoqëruar nga pasqyrat financiare të vitit financiar respektiv

	<i>financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, dhe rrjedhimisht dhe mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve të cilët dhe aktualisht janë duke u mbështetur me bursa, falë kjo dhe Fondacionit "Logos", i cili është një garanci e qëndrueshmërisë së Kolegjit Universitar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Kolegji Universitar "Logos" ka hartuar statutin ³³³ dhe rregulloren e universitetit ³³⁴ , të cilat përcaktojnë dhe specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo përfundimin e marrëdhënieve dhe diplomimin e studentëve nga programi i studimit. Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik ³³⁵³³⁶ të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore ³³⁷³³⁸³³⁹ . Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin ³⁴⁰ dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet

³³³ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

³³⁴ Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

³³⁵ Ligji i Arsimit të Lartë nr.80, dt.22_07_2015.pdf

³³⁶ Aneks 11 -Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016

³³⁷ <http://www.kulogos.edu.al/al/student-clubs.html#>

³³⁸ Aneks 9 -Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

³³⁹ Aneks 11 -Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016

³⁴⁰ Aneks 141 -Fletë palosje, Aneks 142 -Guida e studentëve: <http://www.kulogos.edu.al/al/schedules.html>

	komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Ky program studimi është organizuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në fuqi. Dhe të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme e këtij programi studimi. Informacioni për kriteret³⁴¹ dhe kuotat e pranimit, dokumentacionin³⁴² dhe organizimi i programit të studimit³⁴³, procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese dhe është pjesë e fushatave informuese përmes fletëpalosjeve dhe aktiviteteve të Departamentit³⁴⁴. GVJ përmes dokumentacionit të dorëzuar konfirmon që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Konkretisht për regjistrimet në këtë cikël studimi, pranohen studentët bazuar në kuotat e pranimit dhe kriteret e përzgjedhjes së miratuara nga MAS.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe vizitës në insitucion GVJ konstaton se institucioni në statutin³⁴⁵ dhe rregulloren e tij³⁴⁶ sanksionohen të gjithë procedurat nga hyrja (Kreu IX), te regjistrimi dhe transferimi (Kreu X), ndjekja e studimeve (Kreu XI) të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë studentët e programit. Kandidati duke ndjekur një procedurë të caktuar dhe në afatet ligjore të përcaktuara me ligj mund të kryej ndërprerjen, transferimin e studimeve në përputhje me rregulloren e programit të studimit³⁴⁷ duke siguruar të drejta të plota për të gjithë. Të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme³⁴⁸ të këtij institucioni. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese dhe është pjesë e fushatave informuese përmes fletëpalosjeve³⁴⁹.

³⁴¹ <http://www.kulogos.edu.al/al/admissions.html>

³⁴² <http://www.kulogos.edu.al/al/fee.html>

³⁴³ <http://www.kulogos.edu.al/al/scholarship.html>

³⁴⁴ http://www.kulogos.edu.al/al/student_union.html

³⁴⁵ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

³⁴⁶ Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

³⁴⁷ Aneks 9 -Rregullore për organizimin e programit të studimeve “Punë Sociale”, Nëntor 2022

³⁴⁸ Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

³⁴⁹ <http://www.kulogos.edu.al/al/admissions.html>

Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Referuar Udhëzimit³⁵⁰ të MAS kriteret dhe procedura e pranimit në universitet realizohet nëpërmjet QSHA-së dhe portalit përkatës. Në faqen zyrtare të institucionit³⁵¹ janë të shpallura të gjitha informacionet që lidhen me procedurat e pranimit bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, dokumentacioni që kërkohet, kohëzgjatja e programit dhe numri i krediteve të nevojshme që duhet të ketë studenti për të kaluar në vitin pasardhës. E gjithë procedura është paraqitur në mënyrë transparente. Referuar rregullores së institucionit, për t'u pranuar në programin e studimit së pari duhet të regjistrohesh pasi të kesh dorëzuar një listë me dokumente të nevojshme, dhe çdo studenti i jepet një numër unik matrikulltimi. Kriteret³⁵² dhe kuotat parashikojnë pranime edhe për shtetasit e huaj në kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe konform akteve normative në fuqi.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret e pranimit për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë janë të pasqyruara si informacione specifike edhe në faqen zyrtare, po ashtu dhe duke dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim³⁵³ në programet e studimit, si dhe procesi i transferimit³⁵⁴, si një e drejtë e ligjshme e çdo studenti; duke lehtësuar kështu praktikën e çdo studenti në këtë institucion. Në DVV gjendet dhe vendimi mbi miratimin e kuotave të pranimeve për vitin akademik 2023-2024 edhe për programin Bachelor në "Punë Sociale", të cilat janë 35 kuota, - 15 për shtetas shqiptar brenda vendit; - 7 kuota për trojet; - 1 për shtetas të huaj; - 3 për aplikantë për program të dytë studimi; - 2 për transferim studimesh; - 2 për minoritetin Romë dhe Ballkano-Egjiptian; - 3 kuota për personat me aftësi ndryshe; - 2 kuota për studentët me status jetimi; Në rregulloret e institucionit dhe statutin³⁵⁵ dhe në ato mësimore të programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në

³⁵⁰ <https://arsimi.gov.al/udhezim-nr-10-date-15-05-2019-per-procedurat-e-aplikimit-dhe-te-regjistrimit-ne-programet-e-ciklit-te-pare-te-studimeve-ne-programet-e-studimeve-me-karakter-profesional-si-dhe-ne-programet-e-integr/>

³⁵¹ <http://www.kulogos.edu.al/al/admissions.html>

³⁵² Aneks 154 -Kuotat, VENDIM Nr. 7, datë 3.05.2023 „Për Miratimin e Kuotave të Pranimit të Studentëve në Programet e Studimit të Ofruara nga Kolegji Universitar "Logos" dhe ato në Proces Licensimi për Vitin Akademik 2023-2024"

³⁵³ <http://www.kulogos.edu.al/al/admissions.html>

³⁵⁴ Aneks 68 -Rregullore e Transferimeve, 2019 dhe Aneks 69 -Vendim për Ngritje Komisioni Transferimi dhe Ekuivalentim Diplome

³⁵⁵ Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

	“Punë Sociale” ka të specifikuar formën e organizimit të studimeve (neni 90), kalimin në vitin pasardhës (neni 80), kohëzgjatja e studimeve (neni 83), ndërprerja dhe rifillimi i studimeve (neni 84), si dhe transferimi i studimeve (neni 85). Procedurat e mësipërme i mundësojnë aksesin kujtdo që është i interesuar në kryerjen e studimeve pranë këtij kolegji në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet rregullative të institucionit. Të gjithë informacionet e mësipërme janë lehtësisht të aksesueshme edhe në formatin print pranë Kolegjit, por dhe në faqen web të Kolegjit Universitar “Logos”³⁵⁶. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konfirmon që kriteret, procedurat e pranimit, të përzgjedhjes së studentëve janë në përputhje me VKM në fuqi. Edhe procedurat për përparimin e studentëve, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e institucionit.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ edhe gjatë vizitës në IAL konfirmoi organizimin për informimin publik dhe atë të të maturantëve të shkollave të mesme në veçanëri, në faqet publike dedikuar studentëve³⁵⁷, dhe në faqen zyrtare të institucionit³⁵⁸. Gjithashtu maturantët informohen për kriteret e pranimit dhe kërkesat për t’u regjistruar edhe nga mediat sociale shumë lehtësisht të aksesueshme nga të rinjtë. Përveç informacioneve të gjera mbi programet e studimit të cilat janë në dispozicion në internet, maturantëve gjithashtu ju jepet mundësia të takohen dhe me stafin akademik³⁵⁹ të programit të studimit për të cilin kanë interes gjatë vizitave në institucion. Kolegji universitar “Logos” angazhohet përmes një sërë formash në promovimin e programit dhe realizon një fushatë informimi³⁶⁰ dhe ndërgjegjësimi, për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre në “Logos”: Format me të cilat realizohen informimi në lidhje me kriteret e përgjithshme/të veçanta, për t’u regjistruar në programin “Punë Sociale”, janë të shumta, përveç atyre të kërkesës për informim zyrtar³⁶¹ me anë të broshurave edhe në forma të tjera si këshillimi në ambiente të

³⁵⁶ <http://www.kulogos.edu.al/al/sociale.html>

³⁵⁷ <https://www.portalistudentor.al/lista-universiteteve/kolegji-universitar-logos/pune-sociale/>

³⁵⁸ <http://www.kulogos.edu.al/al/sociale.html>

³⁵⁹ Aneks 163 -Relacion Open Day

³⁶⁰ Aneks 155 -Pranimi i studentëve të rinj, aktivitetet e realizuara me maturantët

³⁶¹ Aneks156 -Broshura në Punë Sociale 2022

	dedikuara në qytete të ndryshme ³⁶² , dërgimi i ftesave në email, rrjete sociale etj.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Kolegji Universitar “Logos”, referuar ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Senati shqyrton dhe miraton kriteret e pranimit për programet e studimit të ciklit të parë dhe institucioni ka të miratuara kritere edhe për kandidatët e kategorive të marginalizuara si dhe atyre me aftësi të veçanta apo pakicave e trojeve. Kuotat³⁶³ për vitin akademik pasardhës hartohen nga Departamenti dhe Fakulteti dhe miratohen nga Senati Akdemik. Për shkak edhe të natyrës së programit, por dhe në filozofinë e institucionit mbështetja e studentëve të cilët vijnë nga kategori të veçanta është e institucionalizuar edhe me anë të njësisë së aksesueshmërisë, e cila siguron që nevojat e studentëve të identifikohen dhe adresohen nga të gjithë si nga stafi akademik dhe ai administrativ. Përzgjedhja e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara mbështet jo vetëm me shërbime mbështetëse por dhe me programin e bursave³⁶⁴. Gjithashtu në mbështetje të kategorisë PAK, ky institucion ka të miratuar edhe një rregullore specifike³⁶⁵. Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësinë të takoj studentë, përfaqësues të shtresave të marginalizuara të cilët konfirmonin mbështetjen institucionale.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Institucioni harton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera, duke siguruar që procesi i aplikimit dhe përzgjedhjes të jetë i qartë dhe transparent³⁶⁶. Karakteristë tjetër në këtë institucion është dhe informimi i studentëve potencial ndërkombëtar me anë të seminareve apo webinarëve ku jepet informacion i detajuar mbi të gjithë procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm, jetën studentore dhe mbështetjen e mundshme³⁶⁷. Gjithashtu nga vizita në institucion informohemi se ka interes nga studentët nga shtete të tjera, kryesisht aty ku ka dhe

³⁶² Aneks 157 -Qytetet Roll Up dhe Stendat

³⁶³ Aneks 154 -Kuotat, VENDIM Nr. 7, datë 3.05.2023 “Për Miratimin e Kuotave të Pranimit të Studentëve në Programet e Studimit të Ofruara nga Kolegji Universitar “Logos” dhe ato në Proces Licensimi për Vitin Akademik 2023-2024”.

³⁶⁴ Aneks 158 -Vendim nr.5/1 datë 25.07.2023 Për Miratimin e Programit të Bursave për Kolegjin Universitar “Logos”.

³⁶⁵ Aneks 51 -Draft Rregullore për “Shërbimet Mbështetëse për Studentët me Aftësi Kufizuar”

³⁶⁶ Aneks 154 -Kuotat, VENDIM Nr. 7, datë 3.05.2023 „Për Miratimin e Kuotave të Pranimit të Studentëve në Programet e Studimit të Ofruara nga Kolegji Universitar “Logos” dhe ato në Proces Licensimi për Vitin Akademik 2023-2024”

³⁶⁷ Aneks 159 -Raport nga zyra për studentët ndërkombëtarë, trafiku online i webinarit/Pranimet

	komunitete shqiptare, por për këtë program studimi ende nuk kanë pasur asnjë rast aplikimi. Ata garantojnë se cilido student që shpreh interes qoftë edhe me kërkesa online trajtohet me profesionalizëm si dhe asistohet në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm konform legjislacionit shqiptar, për përzgjedhjen e drejtimit të studimeve që dëshiron dhe informacionet e tjera të nevojshme për jetën studentore.
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Kolegji Universitar “Logos” ka të përfshirë në politikat mbështetjen e studentëve dhe bursat³⁶⁸ për shtresat e marginalizuara ekonomikisht për përfitimin e ndihmës së tyre për të rritur cilësinë e pranimi në programin e BA në “Punë Sociale” dhe për të ndihmuar kështu në zhvillimin ekonomik të vendit. Bursat janë të mbështetura nga Fondacioni “LOGOS” organizatë jofitimprurëse, i cili ka si qëllim të tij parësor t’i shërbejë shoqërisë nëpërmjet arsimit duke përgatitur profesionistë dhe duke ndihmuar studentët në rrugëtimin e tyre akademik. Përveç bursave të ekselencës, një vend të posaçëm zënë bursat me karakter social dhe ekonomik pa asnjë dallim përkatësie sociale, politike, gjinore apo besimi fetar. Bursat e akorduara nga Kolegji Universitar “Logos” ndahen në këto kategori: - Bursa Sociale; - Bursa Ekselence; - Bursa Mbështetëse; - Bursa nga Partnerët; Ofrimi i bursave bazohet në Vendimin Nr.5/1, datë 25.07.2023, të Bordit të Administrimit, “Për miratimin e programit të bursave për Kolegjin Universitar LOGOS”, ku përcaktohen specifikisht kriteret e përfitimit të secilës lloji mbështetjeje, të plotë ose të pjesshme (30%-100%)³⁶⁹. Për ta aplikuar për njërin nga kategoritë e bursave, studentët ftohen të aplikojnë në studenti@kulogos.edu.al e cila është lehtësisht e aksesueshme edhe online, por gjithashtu ka mundësinë ti drejtohet dhe zyrave të mbështetjes studentore të cilat e orientojnë për dokumentacionin e nevojshëm për secilën kategori. Nga vizita në institucion GVJ pati mundësinë të takoj edhe studentë të cilët mbështeteshin pjesërisht ose totalisht nga programi i bursave dhe të cilët konfirmonin dhe mbështetjen e cila ofrohej dhe për integrimin e tyre, lehtësimin e procesit të të studiuarit dhe asistimit me aspekte të tjera sipas kategorisë dhe nevojës. Në DVV gjenden dokumente për rimbussim

³⁶⁸ Aneks 160 -Shkresë/Format për aplikim burse & <http://kulogos.edu.al/al/scholarship.html>

³⁶⁹ Aneks 161 -Programi I Bursave 2024

	tarifash dhe ulje pagesash dhe nga takimi me drejtuesit e Kolegjit informohemi për bashkëpunimin me Fondacionin dhe asistimin e pakushtëzuar në diskutimin e kërkesave dhe mbështetjen e tyre.			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në evidencat e mësipërme dhe në shqyrtimin e DVV-së konkludon se Kolegji Universitar "Logos" ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve, mbështetjen financiare dhe diplomimin në programin e studimit.</i> <i>Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore.</i> <i>Institucioni publikon përpara fillimit të çdo viti akademik, kriteret dhe procedurat e pranimin në programin e studimit duke garantuar akses në informacion dhe barazi në procesin e pranimin të aplikimeve dhe të përzgjedhjes për të gjithë kandidatët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e institucionit ³⁷⁰ dhe më specifiku gjenden dhe në rregulloren e programit të studimit "Punë Sociale" ³⁷¹ . Informacion i plotë dhe i qartë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin ju jepen atyre në takimin e parë që ata zhvillojnë çdo vit akademik me përgjegjësin e departamentit dhe koordinatoren e programit. Studentët edhe nëpërmjet faqes online të institucionit, por dhe në ambientet e tij mund të aksesojnë guidën e studentit ³⁷² , e cila ka informacion të detajuar e të

³⁷⁰ Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

³⁷¹ Aneks 9 -Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022, Kreu II, neni 8 dhe 9

³⁷² Aneks 142 -Guida e studentëve

	hollësishëm mbi detyrimet e tyre akademike dhe përparimin nga njëri vit në tjetrimn. Gjithashtu në fillim të çdo lënde mësimore pedagogu informon jo vetëm mbi detyrimet e lëndës, por dhe çdo informacion në lidhje me kriteret e përparimit akademik dhe të kalimit në vitin pasardhës. GVJ konfirmion se studentët ishin të informuar mbi detyrimet e përgjithshme të programit të studimit si dhe për detyrimet specifike për çdo lëndë nga pedagogu përgjegjës.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	KU, çdo vit realizon procesin e pritjes dhe orientimit të kandidatëve për të gjithë studentët³⁷³ edhe ata të rinj të regjistruar ku ndërmjet të tjerave informohet dhe në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme të kryera më herët, të cilat nisin me një kërkesë dhe me ngjitje komisioni³⁷⁴. Në hollin e institucionit gjenden kënde pritjeje dhe stenda informuese ku realizohen takime për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve dhe procedurave administrative të institucionit, të cilat gjenden lehtësisht edhe online. Në aktet normative gjenden dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose e studimeve të pjesshme, e cila bazohet në baza ligjore të përcaktuara në rregulloren dhe udhëzimet e Senatit Akademik. Procesi i transferimeve realizohet me përgjegjësi nga njësia bazë dhe specialistët e saj në bashkëpunim të ngushtë me njësitë kryesore, duke u përmbajtur me saktësi Ligjit të Arsimit të Lartë, Statutit, Rregullores dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi më specifikisht Vendimi Nr.24, datë 11.09.2019, "Mbi miratimin e rregullores së transferimeve të Kolegjit Universitar "Logos"³⁷⁵. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh dhe me praktikën konkrete të transferimeve.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve³⁷⁶ dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuara në të gjithë tërësinë e rregulloreve të KU-së, dhe specifikisht gjenden edhe në rregulloren e programit të studimit dhe në atë të Departamentit³⁷⁷, kreu VIII "Provimet", si dhe në syllabusin e çdo lënde³⁷⁸ studentët njihen edhe me mënyrën e vlerësimit në çdo lëndë. Pedagogu i lëndës, por edhe njësia bazë përmes strukturave të saj informon studentët e programit të studimit

³⁷³ Aneks 142 -Guida e studentëve

³⁷⁴ Aneks 69 -Vendim për Ngritje Komisioni Transferimi dhe Ekuivalentim Diplome

³⁷⁵ Aneks 68 -Rregullore e Transferimeve, 2019

³⁷⁶ Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

³⁷⁷ Aneks 200 -Rregullore e departamentit pedagogji psikologji, Kreu VIII.

³⁷⁸ Aneks 70-Sylabet dhe Plani Mesimor 2024-2025; Aneks 44-Sylabuse 2023-2024

	përgjatë fazës së parë të regjistrimit, fillimit të semestrit, në javën orientues në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve³⁷⁹. Përtej kësaj, parimet e përgjithshme të vlerësimit në këtë program studimi shpalosen gjithashtu dhe në dokumentacione të tjera të lidhura me të³⁸⁰, duke sjellë një qasje të pasur dhe të diversifikuar për vlerësimin e performancës së studentëve GVJ në takimin me studentët konfirmoi që gjatë javës orientuese studentët e vitit të parë informohen në detaje rreth programit të studimit, përfshirë kriteret dhe procedurat për vlerësimin e njohurive dhe aftësive. Ky informim është i vijueshëm edhe gjatë lëndëve të veçanta, gjithashtu ata konfirmojnë se edhe procesi i adresimit të shqetësimeve të ndryshme mbi vlerësimin ishte shumë i qartë për ta.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e studimeve të programit të studimeve në "Punë Sociale",³⁸¹ konkretisht në Kreun III si dhe në korpusin tjetër rregullativ, deri në atë të Fakultetit³⁸² dhe Kolegjit, gjithashtu ato janë lehtësisht të aksesueshme edhe në faqen web³⁸³. Departamenti gjithashtu ka miratuar dhe mbështetet në rregulloren e tij, Kreu III, "Diplomimi"³⁸⁴ ku specifikohen edhe modalitetet e miratimit të personelit akademik që do të udhëheqë temat e diplomave, për ata studentë që diplomohen me diploma, dhe pjesa tjetër e cila diplomohet me provim përfundimtar formimi. Udhëzimi në lidhje me strukturën e temës së diplomës iu vihet në dispozicion studentëve në fillim të vitit të tretë. Fazat kohore të mbrojtjes së diplomës përmes provimit me shkrim ose verbalish bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik dhe janë lehtësisht të aksesueshme edhe online³⁸⁵, duke ju dhënë mundësi studentëve të organizohen me procesin e përgatitjes. Studentëve ju vihen në dispozicion dhe pyetjet orientuese për provimin e formimit të këtë program dhe modeli i punimit të diplomës³⁸⁶
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe	KU LOGOS dallohet për praktikën e tij të veçantë duke bërë publike udhëzues të posaçëm dhe duke organizuar takime të

³⁷⁹ Aneks 142 -Guida e studentëve; eks 162 -Takime me studentet në hollin e KU Logos

³⁸⁰ Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017, pika 14, "Rregullore e studentit për provime, fq. 47-60

³⁸¹ Aneks 9 -Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

³⁸² Aneks 11 -Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016

³⁸³ <http://www.kulogos.edu.al/plani-mesimor-pune-sociale-al.pdf>; Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

³⁸⁴ Aneks 9 -Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

³⁸⁵ <http://www.kulogos.edu.al/al/schedules.html>

³⁸⁶ Aneks 56 -Draft -Diploma; Aneks 115 -Struktura punim diplome

në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	hapura me qëllim të informimit të të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit, para se të fillojë çdo vit akademik dhe në mënyrë periodike ³⁸⁷ . Kolegji Universitar "Logos" realizon dhe prezantime të veçanta me shkollat e mesme gjatë ditëve të hapura për maturantët, duke sjellë një përmbledhje të institucionit dhe programeve të studimit që ofrohen ³⁸⁸ . Duke analizuar regjistrimet dhe takimet vërehet se institucioni vijueshmërisht ka organizuar takime informuese me studentët në fillim të vitit të parë të studimeve. Prej disa vitesh KU LOGOS ka ndërmarrë një përpjekje të re duke realizuar sesionin e informimit gjatë panairove "Work & Study" ³⁸⁹ .			
Konkluzione	<i>Institucioni ka hartuar dhe zbaton rregullore dhe udhëzues që përcaktojnë qartë kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe të transferimit të studentëve. Ky informacion është i aksesueshëm në rregulloren e fakultetit, të rregulloren e programit të studimit dhe në syllabuset e moduleve. Kriteret e pranimi, shlyerjes së detyrimeve vjetore, pragun e kalimit nga një vit në tjetrin dhe procesin e diplomimit janë specifikuar në dokumentet zyrtare.</i> <i>Para fillimit të çdo viti akademik, Logos publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për të informuar të interesuarit dhe studentët e ardhshëm. Takimet informuese me maturantët dhe panairët janë organizuar për të prezantuar institucionin dhe programet e studimit.</i> <i>GVJ konfirmon se "KU Logos" ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimeve punë sociale të gjithë informacionin e nevojshëm mbi pranimin, programin, vlerësimet dhe kriteret për kalueshmërinë deri në formatin e diplomimit dhe konkludon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

³⁸⁷ Aneks 104 -Takim prezantues me studentët

³⁸⁸ Aneks 155 -Pranimi i studentëve të rinj, aktivitetet e realizuara me maturantët • Aneks156 -Broshura në Punë Sociale 2022

³⁸⁹ Aneks 167 - Panairi Work and Study foto

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit ³⁹⁰ të studimit.	Studentët informohen për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit në Kolegjin Universitar "Logos". Procesi fillon që në momentin kur studentët shfaqin interes për një program të veçantë, përmes aktiviteteve të organizuara nga institucioni në bashkëpunim me Zyrën për Çështjet Studentore³⁹¹. Informacioni vazhdon të ofrohet gjatë regjistrimit në institucion në një program studimi, duke përfshirë nënshkrimin e kontratës dhe komunikimin e vazhdueshëm nga departamenti në fillim të procesit mësimor. Detajet e profilizuara rreth strukturës, organizimit dhe kohëzgjatjes së programit të studimit gjenden në Rregulloren e Fakultetit³⁹² dhe në Rregulloren e Programit të Studimit (neni 27 - Statusi i Studentit). Për më shumë transparencë, të gjitha këto informacione janë të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit, http://www.kulogos.edu.al. Komunikimi i brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore përdoret për të alternuar kanale të informimit të studentëve. Koordinatori i marrëdhënieve me studentët kujdeset që informacioni i rëndësishëm në lidhje me syllabuset, format e vlerësimit, frekuentimin, grafikun e provimeve dhe auditorët të transmetohet me efektivitet³⁹³. GVJ konfirmoi sa më sipër gjatë takimit me stafin dhe me studentët.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Gjatë vizitës në institucion GVJ-së, iu konfirmua që studentët njihen që ditën e parë me rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit. Nëpërmjet faqes web³⁹⁴, gjatë fazës së regjistrimit, gjatë ditëve të orientimit, takimeve informuese me stafin dhe pedagogët, studentët marrin çdo informacion të nevojshëm në lidhje me kurrikulën dhe programin e studimit (lëndët), regjistrimet, orarin dhe provimet, regjistrimi për provime dhe vlerësimet e notat përkatëse. Informacion i detajuar për çdo lëndë ju jepet nga pedagogu i lëndës nëpërmjet komunikimit me e-mail ose dhe formafin hard-copy në ditën e

³⁹⁰ Aneks 9 -Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

³⁹¹ Aneks 183 -Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës në KU Logos 2020

³⁹² Aneks 11 -Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016

³⁹³ Aneks 152 -Rregullore Mbi Funksionimin e Udhëheqjes/Kujdestarisë për studentët e KU Logos; & Aneks 153 -Procervat takimi me studentet

³⁹⁴ <http://www.kulogos.edu.al/al/sociale.html>

	parë të prezantimit të syllabusit³⁹⁵ me informacione specifike për temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar, duke ofruar një burim të pasur dhe të qartë për studentët për të kuptuar më thellësisht strukturën dhe përmbajtjen e lëndëve të tyre. Studentët gëzojnë mundësinë e një aksesimi të gjerë ndaj informacionit rreth programeve të studimit, lëndëve dhe veprimtarive formuese përmes një sërë burimesh, duke përfshirë broshurat informative, guidat e studentit, materiale të printuara, si dhe në faqen zyrtare të universitetit dhe platformën Microsoft Teams³⁹⁶. GVJ e konfirmoi këtë gjatë takimeve që realizoi me stafin dhe studentët.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni ka në dispozicion të nevojave profesionale të studentëve një sërë zyrash që bashkërendojnë punën me njëra tjetrën si, Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës³⁹⁷, e cila ka mision të sajën që të drejtojë dhe mbështesë studentët gjatë procesit të formimit universitar të tyre, si dhe t'i orientojë dhe këshillojë ata me kërkesat e tregut të punës dhe praktikave profesionale si dhe mundësitë e zgjedhjeve³⁹⁸. Zyra e Këshillimit të Karrierës zhvillon trajnime periodike për përmirësimin e CV-ve dhe strategji të aplikimit për punë³⁹⁹. Gjithashtu, kjo zyrë organizon dhe drejton këshillimin e studentëve në lidhje me procesin akademik; këshillon dhe udhëzon ata në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale; mbështet Këshillin Studentor⁴⁰⁰, i cili është një organizëm i pavarur në KU "Logos" që përfaqëson dhe mbron interesat e studenteve; si dhe mbështet njësitë bazë përgjatë procesit të Praktikave mësimore dhe profesionale. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, dhe për këtë është përherë⁴⁰¹ në studim të treguesve dhe aftësive që kërkohen për punësim dhe orientojnë drejt studentët e tij dhe në tregun e punës⁴⁰². Të dhënat për këtë program mungojnë sepse ende nuk kemi të diplomuar. Institucioni ka konsoliduar partneritete me institucione⁴⁰³ për sigurimin e mundësive të praktikës dhe shanseve të punësimit pas

³⁹⁵ Aneks 44-Sylabuse 2023-2024;

³⁹⁶ Aneks 107 -Materiale Komunikimi

³⁹⁷ Aneks 183 -Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës në KU Logos 2020

³⁹⁸ <http://www.kulogos.edu.al/al/employment-and-internship.html>

³⁹⁹ Aneks 167 - Panairi Work and Study foto • Aneks 168 -Trajnimi Roaming Project-Mobility for Internships/Apprenticeship

⁴⁰⁰ http://www.kulogos.edu.al/al/student_union.html

⁴⁰¹ Evidenca 15. Permblodhje e Tabelave.pdf, Tabela 23

⁴⁰² Aneks 39 -Studimi i tregut të punës për programin e studimit "Punë sociale"

⁴⁰³ Aneks 33 -Marrëveshja me: Shkollën 9 -vjeçare "Njazi Mastori", Sukth; Qendrës Rinore Peshkopi, Qendrës "ALO 116111- Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë", Tiranë, Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Fier

	përfundimit të studimeve, duke prezantuar një perspektivë të qartë për studentët. Takimet ALUMNI⁴⁰⁴, janë një mundësi tjetër që shërben si një eksperiencë e vlefshme për studentët aktualë, duke iu mundësuar atyre të nxjerrin mësim nga perspektiva dhe përvoja e ish-studentëve në tregun e punës në praktikë.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Kolegji Universitar "Logos" (KU LOGOS) përkujdeset që studentët të kenë akses të plotë dhe të përditësuar në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet që ndihmojnë në realizimin e tij. Në dispozicion të studentëve është një nga sistemet IT më të mira përse i përket të gjithë procesit të menaxhimit universitar,⁴⁰⁵ i cili i siguron akses në një numër informacioni si regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, akses i plotë në informacionin, detyrimet dhe literaturën e lëndëve që ndjekin. Secili pedagog është regjistruar në sistem në lëndët e veta dhe kështu mund të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë procesin akademik. Akses i këtyre platform bëhet nëpërmjet kredencialeve të cilat ju jepen studentëve sapo fitojnë status student nga Zyra IT. Informacion mbi organizimin e procesit mësimor gjendet lehtësisht edhe në faqen web⁴⁰⁶ të KU LOGOS.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Kolegji Universitar "Logos" shquhet për përdorimin e teknologjisë së avancuar për të siguruar një akses të lehtë dhe të përmirësuar për studentët në lidhje me programin e studimit. Përmes një platforme të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe sistemeve digjitale si EduPage dhe MS Teams⁴⁰⁷, studentët gëzojnë një përvojë të pasur, duke mundësuar marrjen e informacionit në një mënyrë të lehtësisht të arritshme, madje edhe në distancë. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit, që përdoret për çështjet akademike të studentëve, si regjistrimi, menaxhimi i studentëve, stafi akademik, degët e studimit, lëndët, syllabuset e lëndëve, materialet e studimit, oraret mësimore, provimet, pagesat studentore, komunikime e njoftime të ndryshme etj. Gjithashtu edhe platforma Teams⁴⁰⁸ me të gjithë aplikacionet e saj është gjithashtu e aplikueshme nga pedagogët, si një platformë e cila mundëson më shumë mundësi ndërveprimi. Vlen të theksohet se aksesit në internet por edhe në sistemet e

⁴⁰⁴ <http://www.kulogos.edu.al/al/alumni.html#>

⁴⁰⁵ Aneks 144 -Evidenc perdorimi Edupage/Teams

⁴⁰⁶ <http://www.kulogos.edu.al/al/schedules.html>

⁴⁰⁷ Aneks 144 -Evidenc perdorimi Edupage/Teams

⁴⁰⁸ Aneks 107 -Materiale Komunikimi

	sipërcituara është i garantuar nga interneti në mjediset e universitetit dhe nga aksesit në kompjuterat e vënë në dispozicion të studentëve në bibliotekën, e cila ndohet gjithashtu në mjediset e fakultetit⁴⁰⁹. Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkesë që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forume diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Gjatë vizitës në institucion, nga takimi me stafin akademik por edhe me grupin e punës na u referua se çdo pedagog ofron komunikimin me e-mail me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në institucion. Për të rritur kanalet e komunikimit, për të qënë sa më praktikë dhe bashkëkohor, përveç kanaleve zyrtare si faqja web e institucionit⁴¹⁰ dhe komunikimet zyrtare, edhe platformat sociale gjithashtu janë përdorur si platforma të aksesueshme e transparente mbi publikimin e informacionit. Përdorimi i këtyre platformave ka bërë që informacioni të jetë i arritshëm edhe kur studentët janë larg kampusit universitar. Ky përparim teknologjik është një shembull pozitiv i përdorimit të inovacionit për të përmirësuar eksperiencën e studentëve, duke rritur ndjeshëm qasjen dhe përfshirjen e tyre në procesin e studimit
Konkluzione	<i>KU "Logos" kujdeset për sigurimin e një informacioni të plotë dhe të hollësishëm për studentët në lidhje me strukturën, organizimin, dhe kohëzgjatjen e programit të studimit Bachelor në "Punë Sociale".</i> <i>Informacioni i plotë e i hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësit dhe mundësitë e punësimit gjënden dhe në faqen web të institucionit.</i> <i>Përdorimi i platformave si edupage dhe ms teams siguron që studentët të kenë qasje të lehtë dhe të përditësuar në informacion, duke përfshirë leksionet e regjistruara, komunikimin me pedagogët dhe këshilltarët e tyre. Kjo</i>

⁴⁰⁹ Aneks 131 -Foto nga ambientet e KU"Logos"si: kompjuter, video-projektor, kamera, tabelë smart, etj]

⁴¹⁰ <http://www.kulogos.edu.al/al/student-portal.html>

	ndihmon në përmirësimin e qasjes dhe përfshirjes së studentëve në procesin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	KU "Logos" disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. Institucioni paraqet pranë MASR-së raportet vjetore për veprimtarinë e tij çdo vit akademik, duke përfshirë informacione rreth numrit aktual të studentëve dhe të diplomuarve për çdo program studimi. Këto statistika janë të arritura nëpërmjet Analizës Vjetore të Kolegjit Universitar "Logos" dhe përfshijnë të dhëna të organizuara dhe të përditësuara nga Sekretaria Mësimore. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore edhe mbi numrin e studentëve të diplomuar dhe cilësinë në dalje. Referuar <i>tab.nr.21 të RVB</i>⁴¹¹ dhe vizitës në institucion për 3 vitet e fundit akademike numri i studentëve të regjistruar është si më poshtë vijon: 2022 – 2023 5 studentë; 2023 – 2024 5 studentë; 2024 – 2025 11 studentë; GVJ vizitoi Sekretarinë mësimore⁴¹² ku mbahen regjistrat në lidhje me regjistrimin, ecurinë akademike dhe diplomimin e studentëve. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është më i ulët sesa kapacitetet pritëse të institucionit. Sipas drejtuesve të njësive bazë dhe njësive kryesore në këtë trend ka ndikuar situata e përgjithshme e numrit të studentëve në vend, kryesisht emigracioni. Ndërkohë mesatarja në hyrje ka qënë mbi 7.5 në të tre vitet e fundit akademike. Gjatë vizitës në institucion u vërejtën se sekretaria mësimore administronte, regjistron themeltar të studentëve të regjistruar dhe të transferuar si dhe regjistron e arritjeve akademike me lëndë të

⁴¹¹ 6.Tabelat Përmbledhëse.pdf

⁴¹² Aneks 172 -Rregjistër Themeltar • Aneks 173 -Rregullore e Sekretarisë Mësimore KU Logos

	zgjedhura rastësisht dhe nuk vërejtë rubrika të paplotësuar apo parregullësi në administrimin e tyre.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni disponon statistika⁴¹³ për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalëse apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në Bachelor në “Punë Sociale”⁴¹⁴, në respektim të kuadrit ligjor e rregullativ. Kolegji disponon statistika vjetore të Sekretarisë Mësimore dhe përmes këtyre statistikave siguron informacionin e nevojshëm për menaxhimin, monitorimin dhe raportimin e procesit të regjistrimit dhe zhvillimit të programit të studimit, duke ndarë këto të dhëna edhe me Departamentin përgjegjës për programin për vetëvlerësim dhe planifikimin në të ardhmen. GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vitet e fundit akademike ishte: Viti 2022-2023 5 studentë, (Nota mesatare H 7.85)⁴¹⁵; Viti 2023-2024 5 studentë, (Nota mesatare H 7.69); me 2 studentë të transferuar Viti 2024-2025 11 studentë, (Nota mesatare H 7.86); me 5 studentë të transferuar Numri total i studentëve të regjistruar në programin “Punë Sociale” për 3 vitet e fundit akademike është 21. Këto të dhëna janë në formë të shkruar dhe ruhen në Sekretarinë e Fakultetit në mënyrë konfidenciale.
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve, përfshirë numrin e regjistrimeve, transferimet, çregjistrimet, ecurinë akademike, numrin e ECTS të grumbulluara, dhe të diplomuarve, janë të menaxhuara nga Sekretaria Mësimore. Këto të dhëna ruhen në sistemin EduPage në format elektronik dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke ofruar një mjet efikas për analizë dhe raportim⁴¹⁶. Zyra që merret me regjistrimin e studentëve dhe sekretaria mësimore⁴¹⁷ janë strukturat e posaçme që merren me ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave statistikore nga hyrja deri në dalje. Punën e tyre e kryejnë edhe përmes Portalit studentor që përdoret për menaxhimin e rekordeve të studentëve e

⁴¹³ <http://ams.asc.al/ams/components/dokumentat/proceduraview.php?id=190658>

⁴¹⁴ 2_ Tabelat 1-24 _plotësuar me 2024-25.pdf (dokumentacioni shtesë)

⁴¹⁵ 2_ Tabelat 1-24 _plotësuar me 2024-25.pdf (dokumentacioni shtesë)

⁴¹⁶ Aneks 107 -Materiale Komunikimi

⁴¹⁷ Aneks 173 -Rregullore e Sekretarisë Mësimore KU Logos

	realizojnë edhe përmes sistemit informatik të regjistrave dhe arkivave të të dhënave të plota, kjo referuar dhe kuadrit rregullativ të përdorimit të platformave elektronike⁴¹⁸. Këto të dhëna disponohen për të gjithë studentët e universitetit dhe janë të sigurta, pasi sistemi është pjesë e RASH, i cili garanton sigurinë, si dhe në të kanë akses vetëm personat e autorizuar. Studenti ka dosjen personale⁴¹⁹, e cila ka të gjitha të dhënat që janë marrë në fazën e regjistrimit dhe vazhdojnë të përditësohen në vijim përgjatë viteve të studimit. Personat e autorizuar mbështeten në sistemin informatik për të gjeneruar statistika mbi studentët në mënyrë të shpejtë dhe të saktë.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Institucioni ka hartuar një sërë dokumentesh që favorizojnë kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin e sekretarive mësimore si dhe sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit si dhe vlerëson e dokumenton gjendjen dhe saktësinë e dokumentacionit që lidhet me studentët dhe me veprimtaritë e tyre^{420, 421, 422}. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme vetëm nga persona të autorizuar. Të gjithë përdoruesit kishin akses të personalizuar sipas roleve të tyre dhe njësive përkatëse në sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve. GVJ bëri verifikime të të dhënave të studentëve të regjistruar e të transferuar, si dhe të ecuarisë akademike në mënyrë rastësore dhe nuk konstatoi mangësi.
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Kolegji Universitar “Logos” ka praktikën e paraqitjes së raporteve vjetore pranë MASR-së dhe disponon statistika nga Sekretaria Mësimore për numrin e studentëve dhe cilësinë në hyrje dhe dalje⁴²³. Departamenti dhe departamentet e fakultetit, nëpërmjet raporteve vjetore dhe analizave të cilësisë, monitorojnë punësimin e studentëve, duke reflektuar dhe përmirësuar masat në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Të dhënat statistikore mbi mesataren janë lehtësisht të aksesueshme nga sistemi i menaxhimit dhe vëmendje e shtuar është treguar në nivel institucional ndaj masave që duhet të merren për përmirësimin e treguesve.

⁴¹⁸ Evidenca 31. Manual i përdorimit të platformës elektronike.pdf

⁴¹⁹ Aneks 119 -Përmbajtje e dosjes së studentit

⁴²⁰ Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

⁴²¹ Aneks 11 -Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016

⁴²² Aneks 124 -Rregullore e Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Arkiv-Protokollit

⁴²³ Aneks 174 -Raport Vjetor për Veprimtarinë e Fakultetit Viti Akademik 2022-2023, Kreu LX, fq. 11

	Si dhe raportohet në DVV Kolegji Universitar "Logos" ka një qasje të përmbyllur në gjurmin dhe bashkëpunimin me studentët, duke organizuar kontakte dhe aktivitete nëpërmjet Zyrës Studentore dhe Zhvillimit të Karrierës që fillon që në fazën e shkollës së mesme dhe vazhdon përgjatë studimeve të tyre. Përmes kësaj njësie, institucioni mbledh informacion dhe evidenca për kërkesat e tregut të punës dhe zhvillon bashkëbisedime dhe kurse⁴²⁴ për të ndihmuar studentët në përgatitjen për jetën profesionale. Angazhimi i vazhdueshëm nëpër ciklet e studimeve shërben për përmirësimin e kualifikimeve dhe përshtatjes së studentëve me sfidat e zhvillimeve të mëtejshme në karrierë. GVJ konfirmon se institucioni ka sistem për menaxhimin e të dhënave dhe sekretaria mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të detajuara në lidhje me studentët, vlerësimet dhe profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit "Punë Sociale". Të dhënat ruhen edhe në rregjistra të posaçëm nga pranimi dhe rregjistrimi në programin e studimit deri në diplomimin e tyre, gjithashtu institucioni disponon të dhëna edhe për mundësitë e punësimit të studentëve. Ecuria akademike e studentëve është në fokusin e vijueshëm të stafit universitar dhe njësia bazë ka hartuar raporte analitike, periodike mbi profilin e studentëve, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të treguesve⁴²⁵.			
Konkluzione	<i>Institucioni disponon statistika vjetore të cilat përfshijnë të dhëna të organizuara dhe të përditësuara nga sekretaria mësimore dhe paraqiten pranë agjencisë për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë (MASR) përmes raporteve vjetore.</i> <i>Institucioni. mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre</i> <i>Të dhënat ruhen në sistemin EDUPAGE në format elektronik dhe janë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

⁴²⁴ Aneks 175 -Trajnim RIT Kosova; & Annex 176 -Workshop nga RIT KOSOVA

⁴²⁵ Aneks 177 -Raport Akademik mbi Arritjet e Studentëve dhe Verifikimin e Saktësisë së të Dhënave 2022 2023 •
 Aneks 178 -Raport Akademik mbi Arritjet e Studentëve dhe Verifikimin e Saktësisë së të Dhënave 2023 2024 •
 Aneks 179 -Raport Analitik për Studentët

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Referuar RVB-së, Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre⁴²⁶ në organet vendimmarrëse⁴²⁷ si Senatin Akademik, komisionin për garantimin e standarteve dhe cilësisë⁴²⁸, GVB⁴²⁹, këshillin e etikës, si dhe në këshillin e studentëve⁴³⁰, i cili është grupim i studentëve dhe përzgjedh përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të Kolegjit Universitar "Logos" dhe në vlerësimet e ndryshme të procesit mësimor⁴³¹. Përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese është e përcaktuar konform akteve ligjore dhe atyre rregullatore, në statusin⁴³² e vetë institucionit. Përfaqësuesit e studentëve luajnë një rol aktiv në procesin vendimmarrës dhe japin një kontribut vlerësues përmes sugjerimeve të tyre, të cilat diskutohen me seriozitet në mbledhjet e Departamentit. Departamenti ndjek rregulloret dhe statutet e institucionit në lidhje me këshillin studentor, duke u siguruar studentëve të drejtën për të themeluar organet e tyre që synojnë përmirësimin dhe avancimin e procesit mësimor, ashtu siç është shprehur në dokumentet rregullative⁴³³. Komunikimi i brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore funksionon si një mjet për shkëmbimin e informacionit në mënyrë efektive⁴³⁴. Koordinator i marrëdhënieve me studentët⁴³⁵ është përgjegjës për transmetimin e informacionit në lidhje me syllabuset, format e vlerësimit, frekuentimin, grafikun e provimeve, auditorët dhe çdo problematikë apo shqetësim që lidhet me jetën studentore.

⁴²⁶ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS.

⁴²⁷ Evidenca 49. Rregullore ZKSK.pdf

⁴²⁸ Aneks 101 -Rregullore e Komisionit të Garantimit të Standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit

⁴²⁹ Aneks 206 -Vendim për Ngritje Komisioni të Akreditimit të Punë Sociale- me student.

⁴³⁰ Aneks 180 – Rregullore e Këshillit Studentor, Tiranë 2020 /Rregullore e këshillit studentor 2020

⁴³¹ Aneks 205 -Relacion mbi shqetësimet e shprehura nga studentët dhe vendimi për rinovimin e kontratës së pedagoges

⁴³² Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

⁴³³ Aneks 180 – Rregullore e Këshillit Studentor, Tiranë 2020 /Rregullore e këshillit studentor 2020

⁴³⁴ Aneks 152 -Rregullore Mbi Funksionimin e Udhëheqjes/Kujdestarisë për studentët e KU Logo

⁴³⁵ Aneks 78 -Email i Koordinatorit të programit punë sociale drejtuar pedagogëve të lëndësve në 2023 2024,

Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	KU “Logos” ka një angazhim të vërtetë për përfshirjen e studentëve në vlerësimin e procesit akademik përmes zhvillimit të instrumenteve matës. Organizimi i pyetësorëve periodikë nga NJSBC u mundëson studentëve të shprehin vlerësimin e tyre për aspektet e ndryshme të mësimdhënies dhe ofron hapësirë për sugjerime. Në dokumentacionin e institucionit përcaktohet që studentët janë pjesë e proceseve vendimarrëse dhe këshillimore në Senatin Akademik⁴³⁶, Komisionin e Përhershëm të Garantimit të Cilësisë⁴³⁷, Këshillin e Etikës⁴³⁸ dhe Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm. Në të gjitha strukturat dhe sektorët apo zyrat në të cilat përcaktohet me ligj përfshirja e tyre, kemi një angazhim të shprehur qartë në lidhje me rolin e studentëve⁴³⁹. Ato janë pjesë aktive e mbedhjeve të senatit akademik, punojnë së bashku me stafin në grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë dhe janë në të përfshirë dhe të angazhuar plotësisht në procesin e punës së tyre në këtë veprimtari⁴⁴⁰. Studentët janë të përfshirë në grupime studentore në lidhje me fushën e studimit dhe sipas interesave personale. Studentët janë të përfshirë në klube të ndryshme studentore⁴⁴¹. Në lidhje me vlerësimin e stafit akademik studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogut përmes pyetësorëve⁴⁴² dhe përmes takimeve në grup⁴⁴³.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në	Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe është e gatshme të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre⁴⁴⁴. Është në praktikën e këtij departamenti dhe në përvojën e deritanishme të realizojë takime dhe fokus grupe⁴⁴⁵ me studentët për të nxitur përfshirjen e tyre si në proceset akademike, ashtu dhe në ato ekstrakurrikulare. Përmes komunikimit të vazhdueshëm, përfshirjes së studentëve në grupet e punës dhe reflektimit të kontributit të tyre në raportet për vetëvlerësimin e cilësisë njësia përgjegjëse garanton jo vetëm përfshirja e studentëve por

⁴³⁶ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

⁴³⁷ Aneks 101 -Rregullore e Komisionit të Garantimit të Standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimi

⁴³⁸ Aneks 72 -Kodi i Etikës i Kolegjit Universitar “Logos”

⁴³⁹ Aneks 101 -Rregullore e Komisionit të Garantimit të Standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimi; Aneks 151 -Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Standardeve

⁴⁴⁰ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

⁴⁴¹ http://www.kulogos.edu.al/al/student_union.html

⁴⁴² Aneks 100 -Formular vlerësimi nga studenti për mësimdhënien e secilit pedagog

⁴⁴³ Aneks 181 -Procesverbal ku ka firmosur Armando dhe margarita

⁴⁴⁴ Aneks 85 -Drejtuesi i Njesisë Kryesore, Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe Rektori zhvillojnë takime me studentët &

• Aneks 86 -Takim i studentëve me Prof As. Edo Sherifi

⁴⁴⁵ Aneks 85 -Drejtuesi i Njesisë Kryesore, Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe Rektori zhvillojnë takime me studentët

departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	dhe përmirësimi programit të studimit. Përfaqësuesit e studentëve, zgjedhur nëpërmjet procesit të konkursit, janë pjesë e grupit të punës për akreditimin e programit "BA Punë Sociale" dhe shprehin kontributin e tyre në procesin e hartimit dhe rishikimit të programeve të studimit. Anketimet semestrale dhe vjetore përdoren për të identifikuar mangësitë dhe për të ndërmarrë masat për verifikime dhe përmirësime të nevojshme, duke garantuar përfshirjen e studentëve në këtë proces sipas Statutit dhe Rregullores së Kolegjit ⁴⁴⁶ . Nëpërmjet pedagogëve mentorë studentëve ju është dhënë një mundësi me tepër për t'u shprehur dhe për të dhënë sygjerimet dhe kontributin e tyre për përmirësimin e e programit të studimit, dhe stradegjia e zhvillimit të programit është një mundësi tjetër përfshirjeje. Vlen të theksohet fakti se ky program studimi nuk ka shumë vite që është hapur dhe në përgjithësi drejtimi psikosocial është relativisht i ri në vendin tonë, ndaj gjykohet se është herët për të vlerësuar këtë aspekt edhe pse takimi me kordinatorin ⁴⁴⁷ e programit nxit dhe sygjerimet dhe mundësitë për përmirësim ⁴⁴⁸ . Një tjetër aspekt që lidhet me përfshirjen e tyre janë dhe ftesat për takime për aktivitetet të ndryshme, të cilat gjithashtu një forum i hapur kontributi i të gjithë aktorëve ⁴⁴⁹ .
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/	Rregulloret e brendshme të programit të studimit "Punë Sociale" ⁴⁵⁰ si dhe ato të Fakultetit ⁴⁵¹ dhe IAL-së ju mundësojnë studentëve një proces transparent mbi mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve ⁴⁵² duke shtuar përdorimin e teknologjisë edhe në vlerësimin dhe kontrollin e dijeve ⁴⁵³ . Procesi i vlerësimit të dijeve dhe kontrollit të studentëve në Kolegjin Universitar "Logos" është një shembull i zbatimit të përpiktë të Rregullores së Fakultetit dhe programit të studimit. Në përputhje me këto udhëzime, rezultatet e testimeve ⁴⁵⁴ u komunikohen studentëve brenda një periudhe prej 5 ditësh nga momenti i kryerjes së testit me shkrim. Kjo garanton të drejtën e studentëve për ankimim, rishikim dhe rivlerësim të rezultatit

⁴⁴⁶ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS & Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

⁴⁴⁷ Aneks 65 -Vendim për emërim koordinatori

⁴⁴⁸ Aneks 152 -Rregullore Mbi Funksionimin e Udhëheqjes/Kujdestarisë për studentët e KU Logos • Aneks 153 -Procervat takimi me studentet

⁴⁴⁹ <http://www.kulogos.edu.al/al/student-affairs-office.html>

⁴⁵⁰ Aneks 9 -Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

⁴⁵¹ Aneks 11 -Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016

⁴⁵² Aneks 103 -Dokumenti për sistemin e vlerësimit të studentëve

⁴⁵³ Annex 182 -Email njoftimi për notes; Aneks 177 -Raport Akademik mbi Arritjet e Studentëve dhe Verifikimin e Saktësisë së të Dhënave 2022 2023 • Aneks 178 -Raport Akademik mbi Arritjet e Studentëve dhe Verifikimin e Saktësisë së të Dhënave 2023 2024 • Aneks 179 -Raport Analitik për Studentët

⁴⁵⁴ Aneks 9 -Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022 & Aneks 11 -Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016

njesisë/pedagogut përgjegjës.	para se të dalë rezultati përfundimtar dhe procesverbalit. Në drejtim të ndershmërisë së kryerjes së procesit janë sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim. Studentët kanë mundësi të parashtrojnë ankesat e tyre ⁴⁵⁵ .			
Konkluzione	<i>Studentët janë të inkurajuar dhe të përfshirë në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit, ata formojnë organet e tyre përfaqësuese për përmirësimin dhe mbështetjen e procesit mësimor.</i> <i>Departamenti siguron përfshirjen e studentëve në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit dhe mbështetjen e tyre në jetën studentore.</i> <i>Procesi i kontrollit të vlerësimit të dijeve dhe vlerësimit të procesit akademik të studentëve përputhet me rregulloret dhe statutet e institucionit. Sigurohet komunikimi i rezultateve në kohë të arsyeshme dhe ofrohet mundësia e ankimit dhe rishikimit të rezultateve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Procedurat për informimin e studentëve në Kolegjin Universitar "Logos" shquhen për qartësinë dhe përshtatjen e tyre me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit, të cilat kanë krijuar strukturën e vet ⁴⁵⁶ , e cila u siguron studentëve mbështetjen e nevojshme akademike, duke vënë në dispozicion burimet dhe plotëson kërkesat që iu duhen për të pasur sukses në universitet (Sekretaritet, Zyra e IT, Zyra e Financës, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës). Kjo realizohet përmes një rrjeti të zyrave të specializuara, duke përfshirë sekretarinë mësimore, Zyrën e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit për Karrierën, si dhe Departamentin e "Shkencave

⁴⁵⁵ Aneks 108/1 Relacion mbi procesin e provimit të KULogos

⁴⁵⁶ Aneks 61 -Organograma e Kolegjit Universitar LOGOS

	të Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale” dhe koordinatoren për marrëdhëniet me studentët. Koordinatorja ka një rol kryesor në ofrimin e ndihmës dhe informimit, duke ndihmuar studentët në krijimin e planeve të studimit individuale dhe duke kryer verifikimet e nevojshme për detyrimet që studenti duhet të plotësojë. Ky angazhim i përbashkët dhe i koordinuar i zyrave dhe koordinatorit ndihmon në sigurimin e një eksperience informuese dhe mbështetëse për të gjithë studentët në rrugën e tyre akademike dhe jo vetëm. Statuti⁴⁵⁷ dhe rregulloret⁴⁵⁸ e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore. Në godinën e universitetit ka njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit ndaj studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve siç është Njësia Bazë, Zyra e çështjeve studentore dhe ajo Alumni, apo dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës⁴⁵⁹. Këto struktura ofrojnë një sër shërbimesh për studentët përgjatë të gjitha fazave të studimit në Kolegjin Universitar "Logos" dhe vijojnë edhe pas përfundimit të studimeve përmes shërbimeve që këto zyra ofrojnë për alumnit e saj⁴⁶⁰. Strukturat në shërbim të studentëve nga hyrja në dalje, të informimit, trajnimit dhe mbështetjes në punësim janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe kjo konfirmohet edhe nga vetë studentët në takimin që u realizuar me ta.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Kolegji Universitar "Logos" ka implementuar një sistem të specializuar për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit dhe asistencën e studentëve në lidhje me procesin mësimor dhe programin e studimit. Departamenti, Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, së bashku me koordinatoren për Marrëdhëniet me Studentët, bashkëpunojnë për të ofruar mbështetje nga momenti i aplikimit deri në diplomim. Për më shumë transparencë dhe qasje në distancë, faqja zyrtare e internetit e kolegjit ofron informacione të detajuara, duke përfshirë procesin e regjistrimit, pagesat online, dhe prenotimin e provimeve. Platforma digjitale e kolegjit gjithashtu mundëson studentëve të ndjekin dhe monitorojnë vlerësimet e tyre dhe të marrin informacion të

⁴⁵⁷ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

⁴⁵⁸ Aneks 11 -Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Janar 2016; Aneks 9 -Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

⁴⁵⁹ <http://www.kulogos.edu.al/al/>

⁴⁶⁰ Aneks 107 -Materiale Komunikimi

	personalizuar rreth profilin e tyre akademik. Njësia Bazë⁴⁶¹, dhe Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës⁴⁶² janë zyra të posacme që mbulojnë shërbimet që ju nevojiten studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. IAL-ja funksionon mbi një strategji të miratuar⁴⁶³ duke aplikuar dhe standartet më të lartë të informimit e transparencës⁴⁶⁴. Megjithatë Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës⁴⁶⁵ është përgjegjëse specifike për komunikimin, informimin, mbështetjen, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe vijojn bashkëpunimet e mëtejshme me ta përmes orientimit dhe këshimit të tyre me kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë e zgjedhjes. Ajo gjithashtu mbështet Këshillin Studentor dhe ofron udhëzime në lidhje me zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Kolegji Universitar "Logos" dallohet në ofrimin e shërbimeve të avancuara të këshillimit të karrierës përmes Zyres së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës. Përmes kësaj zyre, studentët dhe alumni përfitojnë nga një gamë e gjerë e shërbimeve, duke përfshirë informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës së tyre. Aktivitete si trajnime, forume, projekte, seminare, takime informative, tryeza të rumbullakta dhe ngjarje të tjera zhvillohen për të përmirësuar avancimin e tyre profesional. Kolegji gjithashtu bën të njohur informacion për bursa, konferenca studimore, mundësitë e mobilitetit dhe programe shkëmbimesh ndërkombëtare. Pjesëmarrja tradicionale e institucionit në panairin vjetor Work & Study të organizuar nga MASR dhe koordinimi i praktikave profesionale në bashkëpunim me institucione private dhe shtetërore shënojnë një angazhim të vazhdueshëm në përgatitjen dhe orientimin e studentëve për sfidat dhe mundësitë në botën e punës. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës⁴⁶⁶, nëpërmjet sektorit të këshillimit të studentëve dhe atij të karrierës, i cili jo vetëm mban kontakte dhe krijon rrjetin alumni⁴⁶⁷, por organizon edhe aktivitetet dhe krijon bashkëpunimet e duhura për të diplomuarit e këtij institucioni. Punonjësit e kësaj zyre mirëpresin studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike,

⁴⁶¹ Aneks 9 -Rregullore për organizimin e programit të studimeve "Punë Sociale", Nëntor 2022

⁴⁶² Aneks 183 -Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës në KU Logos 2020

⁴⁶³ Aneks 13 -Plani Strategjik i Zhvillimit, 2018-2024 (Tiranë 2018)

⁴⁶⁴ <http://www.kulogos.edu.al/al/contact.html>

⁴⁶⁵ <http://www.kulogos.edu.al/al/student-affairs-office.html>

⁴⁶⁶ Aneks 183 -Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës në KU Logos 2020

⁴⁶⁷ <http://www.kulogos.edu.al/al/student-affairs-office.html>

	duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Zyra është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësitë e punësimit, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Zyra organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, ëorkshop-e, takime periodike për të marrë mendime, ndarë eksperiencë në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës. Këto aktivitete orientojnë studentët në përzgjedhjen e profilit, dhe më pas në lehtësimin e përzgjedhjes së institucioneve të zhvillimit të praktikës profesionale në linjë me programin e studimit. Seminare të hapura, lektorë të ftuar janë pjesë e promovimit të profesioneve të ndryshme për studentët e saj⁴⁶⁸. Në funksion të të gjitha këtyre proceseve që mbulon Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës ka në funksion të të gjithë studenteve kontaktin e e-mail: studenti@kulogos.edu.al
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës⁴⁶⁹ është një strukturë e ngritur, e cila funksionon në bazë të statutit të KU-së, që ka si objektivi të punës së saj mbështetjen e studentëve përgjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik dhe më tej përgjatë orientimit të punësimit. Shpesh luan një rol të rëndësishëm në orientimin e studentit drejt mundësive të punësimit, por edhe në drejtim të ofrimit të këshillimit për karrierën me qëllim vlersimin më objektivi të mundësive që student ka në dispozicion. Kjo zyrë vendos kontakte me Alumnit⁴⁷⁰ e Kolegjit Universitar "Logos" me qëllim gjurmimin dhe mbledhjen e informacioneve mbi punësimin e tyre e duke evidentuar rastet e suksesit si dhe duke i ardhur në ndihmë atyre që janë të papunë për t'i informuar mbi mundësi punësimi dhe praktikash si dhe ftesa për të zhvilluar orë të hapura leksioni apo seminaresh për studentët ku të tregojnë mbi eksperiencat e tyre profesionale dhe karrierën e tyre të suksesshme⁴⁷¹.

⁴⁶⁸ Aneks 164 -Njoftim email dhe foto nga aktiviteti mbi mobilitetin & Aneks 83 -Takim me Prof. Mr. Nikolaos Manesis drejtuesin e "Department of Educational Sciences and Social Eork", të Universitetit të Patrës
⁴⁶⁹Aneks 183 -Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës në KU Logos 2020

⁴⁷⁰ <http://www.kulogos.edu.al/al/statistics-alumni.html>

⁴⁷¹ <http://www.kulogos.edu.al/al/success-story.html#>

Konkluzione	<i>Procedurat për informimin dhe mbështetjen e studentëve në kolegjin universitar "LOGOS" shprehen në mënyrë të detajuar dhe parashikohen në disa mënyra që përfshijnë si zyra të specializuara, ashtu dhe platforma digjitale dhe faqe zyrtare e internetit.</i> <i>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dhe koordinatoren për marrëdhëniet me studentët ka një rol kyç në ofrimin e ndihmës dhe informimit dhe sigurimin e mbështetjes nga momenti i aplikimit deri në diplomim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve ⁴⁷² .	Kolegji Universitar "Logos" ka hartuar politika dhe ka implementuar udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Udhëzuesit ⁴⁷³ përfshijnë objektivat kryesore dhe specifike të lëndëve, modele të mësimdhënies tradicionale dhe inovative, si dhe praktika demonstruese në laborator. Ata gjithashtu përfshijnë kriteret dhe metoda për vlerësimin e të nxënësve të studentëve dhe performancën e lektorëve. Kjo qasje synon të sigurojë një përmbajtje mësimore të pasur dhe në përputhje me fushën e studimit, duke theksuar njëkohësisht vlerat e përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në raport me politikat e institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe duke u mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, në përputhje me statutin dhe regulloren

⁴⁷² Aneks 186 – Politika për Sigurimin e Cilësisë

⁴⁷³ Aneks 67 -Udhëzuesi Didaktik për Studentët e Programit Punë Sociale

	e institucionit evidentojmë disa elementë të dallueshëm⁴⁷⁴ lidhur me korrektësinë e institucionit në raport me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë si strukturë mbështetëse e IAL-së. Institucioni ka miratur Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK), e cila është një njësi e ngritur në nivel universiteti. Përbërja dhe funksionimi i kësaj njësie është miratuar nga Rektori. Kjo njësi përbëhet nga drejtuesi i zyrës, anëtarë të tjerë të kësaj zyre që janë përzgjedhur nga pedagogët e çdo departamenti, përfaqësues nga administrata, si dhe një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve⁴⁷⁵. Metodologjia e punës së kësaj njësie bazohet në Rregulloren e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Standarteve, Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Statutin e Kolegjit Universitar "Logos", Rregulloren e IAL-së, si dhe të gjitha dokumentet e ASCAL-it⁴⁷⁶. Gjithashtu, institucioni ka hartuar edhe disa dokumente të tjera, të cilat qartësojnë dhe rritin procesin e cilësisë së mësimdhënies, duke ofruar trajnime të vijueshme⁴⁷⁷.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Kolegji Universitar "Logos" dallohet në zbatimin e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Kjo është një dëshmi e qartë⁴⁷⁸ për përkushtimin e institucionit për përmirësimin e cilësisë së mësimimit dhe kërkimit shkencor. Në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Kolegji Universitar "Logos" ka politikë⁴⁷⁹ dhe struktura përgjegjëse si NJSBC që janë të përgjegjshme për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Nënveçojmë se Statuti i Kolegjit⁴⁸⁰, në veçanti Neni 43 Kreu VIII, përcakton strukturën dhe funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë, shprehur në një mënyrë unike dhe të përshtatshme për kontekstin e Kolegjit Universitar "Logos". Po ashtu, ka hartuar Rregulloren e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë⁴⁸¹, e cila rregullon me përpikëri veprimtarinë e strukturave dhe njësive të ngritura për të garantuar dhe përparuar cilësinë në të gjitha

⁴⁷⁴ Aneks 151 -Rregullore për Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Standarteve

⁴⁷⁵ <http://www.kulogos.edu.al/al/external-evaluation.html>

⁴⁷⁶ Aneks 101 -Rregullore e Komisionit të Garantimit të Standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit

⁴⁷⁷ Aneks 187 -Trajnimi i II për stafin akademik, Sarajevë, Gusht 2024, projekt 10112918 – Homo Digitalis/

⁴⁷⁸ Aneks 188 -Raportim mujor me e mail prane Shefit te Depatamentit

⁴⁷⁹ <http://www.kulogos.edu.al/al/quality-policy.html>

⁴⁸⁰ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

⁴⁸¹ Aneks 151 -Rregullore për Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Standarteve

	fushat e veprimtarisë së institucionit. Kjo përfaqësojë strukturore dhe rregulluese evidenton përpjekjet dhe sukseset pozitive në garantimin e cilësisë së arsimit dhe kërkimit shkencor në Kolegjin Universitar "Logos". Institucioni ka në vëmendje parësore sigurimin e cilësisë, realizon vlerësimin e programeve të studimit në të gjitha ciklet dhe format që ofron, ndaj operon për rritjen e saj në bashkëpunim me njësinë bazë. Me vlerësimin e programeve të studimit, përmes procedurave të qarta bëhet vlerësimi i cilësisë të veprimtarisë mësimore dhe të kërkimit shkencor. Qëllimi kryesor është që të vlerësohet nëse programi i studimit i përgjigjet standardeve shtetërore të cilësisë dhe udhëzimeve të Sigurimit të Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se në strategjinë e zhvillimit institucional ka politika që synojnë përmirësimin e cilësisë për programin e studimit. Departamenti i plotëson raportin e vlerësimit të programit. Në këtë raport paraqiten të dhëna për programin e studimit, ndryshimet e mundshme të realizuara, planet për ndryshimet dhe përmirësime në të ardhmen, feedbacku i marrë nga studentët, nga personeli akademik i përfshirë në programin e studimit, të dhëna mbi ecurinë e studentëve, etj⁴⁸², një pjesë e të cilave bëhen publike në faqen web të institucionit.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Kolegji Universitar "Logos" siguron përfshirjen e studentëve në vlerësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies, si dhe në vlerësimin e dijeve dhe të lëndëve⁴⁸³. Duke u bazuar në Rregulloren të veçanta përkatëse, Kolegji u mundëson studentëve të ankohen për rezultatin e provimeve dhe të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies përmes metodave të vlerësimit direkt dhe indirekt (Takime me studentët⁴⁸⁴). Procedurat për ankimim dhe përmirësim të notës janë përcaktuar në detaje në dokumentacionin institucional, duke garantuar një proces transparent dhe të drejtë për studentët. Ky angazhim për transparencë dhe drejtësi është i theksuar në nenin 101 të Kreut XII të Rregullores⁴⁸⁵, duke i dhënë rëndësi të veçantë kësaj sfere. Një aspekt i rëndësishëm është përcaktimi i kriterëve për të drejtën e studentëve për të përmirësuar notën në lëndë nën kushte të caktuara. Kjo sjellje proaktive ndaj studentëve tregon përkushtim ndaj përmirësimit

⁴⁸² Aneks 199 -Raporti i NjSBC 2024

⁴⁸³ Aneks 100 -Formular vlerësimi nga studenti për mësimdhënien e secilit pedagog

⁴⁸⁴ Aneks 85 -Drejtuesi i Njësisë Kryesore, Drejtuesi i Njësisë Bazë dhe Rektori zhvillojnë takime me studentët

⁴⁸⁵ Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

	të tyre akademik dhe thellon lidhjen mes institucionit dhe studentëve. Analiza e pyetësorëve të studentëve, e përfshirë në Raportin e Analizës⁴⁸⁶, është një praktikë e mirë që rrit transparencën dhe përmirëson cilësinë duke marrë në konsideratë pikëpamjet e studentëve. Ky raport, i disponueshëm për të gjithë⁴⁸⁷, shërben si instrument për vlerësimin dhe përmirësimin e klimës së mësuarit dhe bashkëpunimit institucional. Kjo qasje e kujdesshme ndaj proceseve të vlerësimit dhe ankimimit, thekson rëndësinë e transparencës dhe ndërveprimit pozitiv mes institucionit dhe studentëve Kolegji lidhur me këtë standard realizon çdo semestër, apo çdo fundviti akademik, një sërë veprimtarish si vlerësimi i pedagogut nga studenti⁴⁸⁸, trajtimi i ankesave të studentëve si dhe vetëvlerësimi i performancës së personelit akademik si nga kolegët edhe nga drejtuesit. Rezultatet e këtyre sondazheve iu vihen në dispozicion drejtuesit të IAL-së, të njësishë kryesore dhe përgjegjës të departamentit me qëllim reflektimin për të ardhmen. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe ai i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi ku përfshihen pyetësorët dhe fokus grupet e realizuara me studentët⁴⁸⁹. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program me qëllim përmirësimin e cilësisë. Vlerësohet puna e bërë nga institucioni në këtë drejtim. Personeli akademik i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit nuk ushtron detyra në pozicione drejtuese në institucion dhe janë figura me integritet në njësinë bazë.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin	Kolegji Universitar "Logos" ka një transparencë të plotë dhe publikon hapur rezultatet e vlerësimeve dhe arritjeve ⁴⁹⁰ për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Këto

⁴⁸⁶ Aneks 199 -Raporti i NjSBC 2024

⁴⁸⁷ Aneks 193 -Email i Dekanit për njoftimin e stafit mbi rezultatet e Raportit të Vlerësimit të NjSBC

⁴⁸⁸ Aneks 100 -Formular vlerësimi nga studenti për mësimdhënësin e secilit pedagoge

⁴⁸⁹ Aneks 153 -Procervat takimi me studentet

⁴⁹⁰ Aneks 199 -Raporti i NjSBC 2024

e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	rezultate, të përfshira në raportin e Analizës së Pyetësorëve të studentëve, janë lehtësisht të aksesueshëm për pedagogët, ofruar si burim i vlefshëm për të avancuar dhe pasuruar procesin mësimdhënës. Një aspekt kyç i punës së Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) është ndihma e vazhdueshme për përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Rekomandimet e sjella përmes vlerësimit janë një mekanizëm i rëndësishëm që ndihmon në adresimin dhe përmirësimin e çështjeve të identifikuara në mësimdhënie⁴⁹¹. Kjo praktikë e hapur dhe përmirësuese tregon përkushtimin e institucionit për të siguruar cilësi në fushën e arsimit. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është përfshirja aktive e stafit akademik në procesin e vlerësimit, duke bërë të njohura rezultatet e anketimeve dhe duke zhvilluar një komunikim të hapur dhe të drejtpërdrejtë. Kjo shërben si një mjet i rëndësishëm për të mbështetur përmirësimin e performancës akademike dhe përmirësuar efikasitetin e mësimdhënies. Institucioni tregon një angazhim të vazhdueshëm për transparencë dhe përmirësim të cilësisë, duke përdorur rezultatet e vlerësimeve për të përmirësuar kontekstin mësimor dhe për të përmbushur objektivat e njesisë së sigurimit të cilësisë. Kuadri rregullator dhe politikat e institucionit⁴⁹² në drejtim të mbështetjes dhe krijimit të lehtësirave në realizimin e një sërë veprimtarish të mbledhjes së informacionit në funksion të realizimit të një procesi korrekt të vlerësimit të brendshëm. Mekanizmat monitorues dhe kontrollues janë transparente dhe bëhen publike. Gjithashtu GVJ duke iu referuar dokumentacionit të dorëzuar, informacioneve në faqen ëeb të institucionit, si dhe vizitës në institucion, konstatohet se institucioni është i interesuar të vlerësojë cilësinë, ta raportojë atë por dhe të ruajë dhe respektojë të dhënat e privatësisë, lirinë dhe etikën akademike –profesionale. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti ende nuk janë transparente⁴⁹³ dhe sygjerohet të bëhen publike duke u hedhur në faqen e IAL-së.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon	"LOGOS" promovon shembuj të praktikave të mira dhe duke inkurajuar personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Ky përkushtim shfaqet qartë në Raportin Vjetor të KU LOGOS⁴⁹⁴, dhe veçanërisht në Departament, ku

⁴⁹¹ Aneks 192 -Action Plan në përgjigje të Raportit NJSBC 2024

⁴⁹² Aneks 186 – Politika për Sigurimin e Cilësisë

⁴⁹³ <http://www.kulogos.edu.al/al/quality-assurance.html>

⁴⁹⁴ Aneks 48 -Raport Vjetor për Veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Kolegjit Universitar "LOGOS" për vitin Akademik 2023-2024

shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	vlerësimet e studentëve shihen si burim kyç për të përmirësuar cilësinë e veprimtarisë akademike dhe programet mësimore. Vlerësimet e studentëve, që sipas raportit janë jo vetëm një detyrim ligjor, por edhe një burim i rëndësishëm i informacionit, reflektojnë angazhimin e institucionit për të dëgjuar dhe marrë parasysh pikëpamjet e studentëve për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Ky proces i përdorur nga LOGOS është një model i praktikave të mira në fushën e arsimit të lartë, ku theksohet rëndësia e këtij feedback-u drejtuar stafit akademik⁴⁹⁵. Gjithashtu, Departamenti komunikon aktivisht me pedagogët në lidhje me problemet që dalin nga pyetësorët për sigurimin e cilësisë dhe diskuton hapa konkrete për përmirësimet e mëtejshme⁴⁹⁶. Kjo demonstroi një kujdes të vazhdueshëm për përmirësimin dhe zhvillimin e praktikave mësimore, duke u bazuar në informacionin konkret të marra nga studentët⁴⁹⁷. Përbushja e këtij kriteri shpërblen përpjekjet e institucionit për të qenë transparent, për të përmirësuar dhe orientuar nga nevojat dhe perspektivat e studentëve, duke promovuar kështu një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie. Kolegji ka arritur të ngrerë një sërë mekanizmash për të promovuar shembujt më të mirë të studentëve që kanë studiuar në programe të ndryshme studimi në "Logos". Për këtë është përdorur faqja e web si dhe publikimet në media sociale dhe aktivitete që Departamenti ka realizuar. Në to paraqiten rastet e studentëve më ekselentë në programe të ndryshme studimi⁴⁹⁸. Nga ana tjetër, institucioni në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, krijon grupe përmes delegimit të përgjegjësisë, strukturave përgjegjëse dhe mbështet punën e grupit përgjatë kryerjes së detyrës. Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë pas përfundimit përdoret nga vet institucioni edhe për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Nga vizitat në institucion kërkua të na vihej në dispozicion preiodiciteti i vlerësimeve, takimet apo mbledhjet e realizuara në departament për të adresuar problematikat e evidentuara dhe si ishin marrë masat dhe cila ishte situata aktuale; ku na u vunë në dispozicion materialet dhe përmirësimet e realizuara.
--	---

⁴⁹⁵ Aneks 87 -Plani i veprimt në përgjigje të raportit të NJSBC

⁴⁹⁶ Aneks 195 -Relacion Konferenca Nderkombetare 2

⁴⁹⁷ Aneks 194 -Relacion mbi Takimin e Parë të Përgjithshëm të Projektit ERASMUS

⁴⁹⁸ <http://www.kulogos.edu.al/al/events.html> ; <http://www.kulogos.edu.al/al/success-story.html>

Konkluzione	<i>Kolegji universitar "LOGOS" ka shfaqur një përkushtim të dukshëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes implementimit të udhëzuesve dhe mekanizmave të vlerësimit periodik.</i> <i>Institucioni ka hartuar dhe implementuar udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies</i> <i>Kolegji ka implementuar mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik, me theks te transparenca dhe ndërveprimi pozitiv.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Kolegji universitar "LOGOS" përcakton dhe implementon politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC). Kjo iniciativë është në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore aktuale, si dhe me aktet rregullatore institucionale. Politikat dhe procedurat e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë hartuar dhe zbatohen në përputhje me Ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" (Kreu XVII). Në veçanti, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë funksionojnë si organe kyçe për të monitoruar dhe siguruar cilësinë në institucion. Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë⁴⁹⁹, Politika e Sigurimit të Cilësisë⁵⁰⁰, dhe instrumentet e miratuara përcaktojnë strukturën dhe funksionimin e këtyre organeve, duke siguruar një bazë solide për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.

⁴⁹⁹ Aneks 151 -Rregullore për Njësinë e Sigurimit e Brendshëm të Cilësisë të Standarteve

⁵⁰⁰ neks 186 – Politika per Sigurimin e Cilësisë

	Me këtë qasje të strukturuar dhe të përshtatur me kërkesat ligjore, LOGOS demonstroi një përkushtim ndaj përmirësimit të cilësisë në të gjitha nivelet e operacioneve të tij. Kjo gjithashtu krijon një mjedis të qartë dhe të përgjegjshëm. Gjithashtu universiteti ka miratuar edhe planin e zhvillimit strategjik për zhvillimin sa më të strukturuar e transparent të tij⁵⁰¹. Struktura në fjalë e realizon punën e saj duke u mbështetur në një dokument të rëndësishëm për funksionimin e saj siç është Rregullorja e KU "Logos",⁵⁰² si dhe në të gjitha dokumentet e ASCAL-it.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Misioni i Kolegjit Universitar "LOGOS" është t'i shërbejë shoqërisë nëpërmjet arsimimit, kërkimit shkencor, inovacioneve; nxitjes së zhvillimit individual për transformimin e jetëve; garantimit të suksesit të studentëve në një mjedis global; ofrimit të shërbimeve akademike dhe zhvillimit të një komuniteti gjithëpërfshirës⁵⁰³. Kolegji Universitar "Logos" ndjek dhe zbaton me përkushtim një Sistem të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, duke përfshirë një strategji⁵⁰⁴ institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ky angazhim evidenton përkushtimin e institucionit drejt ofrimit të një përvojë arsimore sa më të kualifikuar dhe të pasur me vlerë për studentët e tij. Strategjia e vitit 2021-2026 shërben si një dokument kornizë e cila drejton dhe orienton përpjekjet për sigurimin dhe avancimin e cilësisë⁵⁰⁵. Në veçanti, krijimi dhe funksionimi i Njësisë së Vlerësimit dhe Sigurisë së Brendshme të Cilësisë tregon përgjegjësinë e institucionit ndaj standardeve të larta arsimore. Përfaqësuesi i studentëve në Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë reflekton një angazhim konkret drejt pjesëmarrjes së studentëve në proceset vendimmarrëse, duke i bërë ata një pjesë aktive të përmirësimit të cilësisë. Në këtë mënyrë, Kolegji Universitar "Logos" rrit ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë e të gjithë aktorëve drejt një eksperience akademike sa më cilësore. Plani strategjik i zhvillimit të Institucionit 2018-2024⁵⁰⁶ evidenton se universiteti është i përkushtuar për të siguruar cilësi dhe kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet procedurave

⁵⁰¹ Aneks 13 -Plani Strategjik i Zhvillimit, 2018-2024 (Tiranë 2018) :

<http://www.kulogos.edu.al/al/strategicplan.html> & Aneks 208 -Objektivat vjetore

⁵⁰² Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

⁵⁰³ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS & <http://www.kulogos.edu.al/al/mision.html>

⁵⁰⁴ Aneks 2 -Strategjia Kombëtare e Arsimit, 2021-2026

⁵⁰⁵ <http://www.kulogos.edu.al/al/strategicplan.html>

⁵⁰⁶ Aneks 13 -Plani Strategjik i Zhvillimit, 2018-2024 (Tiranë 2018)

	efektive të menaxhimit dhe organizimit të strukturave, të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e proceseve akademike dhe kërkimore si edhe të veprimtarisë menaxheriale të Universitetit. Për të rregulluar dhe mbikqyrur proceset e cilësisë, institucioni ka hartuar Rregulloren e Komisionit të Garantimit të Standardeve të Cilësisë së Institucionit⁵⁰⁷ dhe programeve të studimit, si dhe një Politikë për sigurimin e cilësisë. Këto dokumente ndihmojnë në udhëheqjen dhe monitorimin e përpjekjeve për përmirësimin e cilësisë në tërësinë e institucionit dhe programeve të studimit. GVJ e konsideron si praktikë të mire faktin që institucioni ka një strategji të qartë dhe politika për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë, e cila është bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Ligji për Arsimin e Lartë përcakton krijimin e një Njësie për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e kërkesave arsimore dhe kjo njësi në këtë IAL është funksionale⁵⁰⁸. Në nivele të tjera nuk ka njësi përgjegjëse për sigurimin e cilësisë ndaj <i>GVJ sygjeron që në politikat që ndjek e zbaton KU Logos për sigurimin e cilësisë së brendshme të ndërtohen njësi edhe në nivel njësisht kryesore (fakulteti) apo dhe në nivel njësie bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore (departamenti), si dhe të shihet mundësia e vlerësimit nga ekspertë të jashtëm për cilësinë e këtij programi studimi. Vlen të theksohet fakti se ky institucion ka përfshirë studentët⁵⁰⁹ në shumë aktivitete, jo vetëm trajnuse të cilat janë një mundësi për rritje cilësie.</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit,	Kolegji Universitar "Logos", përdor instrumente dhe tregues të përshtatshëm dhe të duhur për sigurimin e cilësisë. Për sigurimin e cilësisë, institucioni përdor një gamë të gjerë instrumentesh matës, duke përfshirë vlerësimet e performancës së stafit akademik dhe pyetësorët për studentë për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies⁵¹⁰. Rezultatet e këtyre instrumenteve, së bashku me rekomandimet e tyre⁵¹¹, janë monitoruar nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe janë përcjellë drejt departamenteve

⁵⁰⁷ Aneks 101 -Rregullore e Komisionit të Garantimit të Standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit

⁵⁰⁸ Aneks 186 – Politika për Sigurimin e Cilësisë

⁵⁰⁹ Aneks 205 -Relacion mbi shqetësimet e shprehura nga studentët dhe vendimi për rinovimin e kontratës së pedagoges & Aneks 197 -Ftes e Z. Khalil Ghassan përfaqësues i UNICEF në Greqi • Aneks 198 -Email me Prof. As Marita Flagrer

⁵¹⁰ Aneks 100 -Formular vlerësimi nga studenti për mësimdhënien e secilit pedagogje

⁵¹¹ Aneks 199 -Raporti i NJSBC 2024 • Aneks 192 -Action Plan në përgjigje të Raportit NJSBC 2024

vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	për vlerësime individuale të pedagogëve. Kjo praktikë e bërë sistemikisht ndihmon në identifikimin e fushave për përmirësim dhe kontribuon në zhvillimin e një kulture të cilësisë përmes promovimit të praktikave më të mira⁵¹². Sigurimi i jashtëm cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit dhe vlerësimeve analitike e krahasuese. Institucioni përdor procedurat ligjore dhe procedurat e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për të kryer sigurimin e cilësisë në nivel jashtëm, duke përfshirë hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) në këtë kuadër. Me këto praktika, institucioni demonstroi një përkushtim ndaj vazhdimësisë së përmirësimit të cilësisë në të gjitha nivelet e operacioneve të tij dhe një përdorim efektiv të instrumenteve të cilësisë për të arritur standardet e parashikuara dhe për të përmbushur qëllimet e vet. Institucioni ka ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për përmbushjen dhe plotësimin e procedurave të akreditimit⁵¹³. ASCAL ka ngritur grupin e punës, i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të jashtëm të akreditimit për këtë program studimi, por jo vetëm. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion⁵¹⁴, konstatohet se KU Logos i ka kushtuar një rëndësi të veçantë rekrutimit të stafit akademik dhe është duke i mbështetur ata me financime për avancimin në arritje me tituj e grada shkencore, por sygjerohet që ata të jenë profesionistë dhe akademikë vetëm të "Punës Sociale", pasi tashmë ky është një profesion i rregulluar dhe nevojitet profesionalizëm i lartë në ofrimin e njohurive⁵¹⁵. Për sigurimin e cilësisë institucioni përdor instrumentet e ndryshme si pyetësorë me studentët, stafin akademik, takimet në grup për të garantuar ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë⁵¹⁶ nëse është e nevojshme.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të	Kolegji Universitar "Logos" dallohet për përdorimin e treguesve të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim⁵¹⁷, duke reflektuar një angazhim të vazhdueshëm drejt pasqyrimin të gjendjes, arritjeve dhe sfidave të programit të studimit, të parashikuara në aktet rregullatore institucionale.

⁵¹² Aneks 179 -Raport Analitik për Studentët

⁵¹³ Aneks 206 -Vendim për Ngritje Komisioni të Akreditimit të Punë Sociale • Aneks 207 -Vendimi Dekani për ngritje GVB 2024

⁵¹⁴ Shënime gjatë vizitës në institucion

⁵¹⁵ CV e stafit akademik & Aneks 15 -Biografi e shkurtër, Prof.Asoc.Dr Edo Sherifi • Aneks 16 -Biografi e shkurtër, Dr.proc Juna Muca

⁵¹⁶ Evidenca 30. Procedura e punës me fokus grupet.pdf

⁵¹⁷ Aneks 209 -Raporti i vlerësimit individual hartuar nga P/Departamenti

parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Raportet Vjetore dhe Vlerësimi i Brendshëm janë instrumente cilësorë⁵¹⁸ të cilat shfaqin përpjekjet e institucionit në monitorimin e ecurisë dhe cilësisë të programeve të studimeve. Përmes shqyrtimit të detajuar të këtyre raporteve dhe analizave, një fokus i veçantë është përmirësimi i cilësisë sipas feedback-ut dhe sugjerimeve të studentëve dhe stafit akademik. Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes organizimit të saj⁵¹⁹ të veprimit synon që për këto qëllime të realizojë monitorim të vazhdueshëm të punës së stafit akademik dhe administrativ me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore, ndërkombëtarizimin⁵²⁰ përmes programeve të mobilitetit për stafin⁵²¹ dhe studentët. Pjesë e këtyre veprimtarive do të jenë zyra e burimeve njerëzore, njësisë për kërkimin shkencor, departamentet dhe zyra e kujdesit për studentët, zyra e karrierës, kordinatorët dhe senati akademik⁵²². Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se në strategjinë e zhvillimit institucional⁵²³ ka politika që synojnë përmirësimin e cilësisë për programin e studimit.			
Konkluzione	<i>Kolegji universitar "LOGOS" ka demonstruar një përkushtim të qartë ndaj sigurimit të cilësisë në të gjitha nivelet e operacioneve të tij, duke implementuar politika, struktura dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë (SBC).</i> <i>Institucion përdor një gamë të gjerë instrumentesh dhe treguesish për sigurimin e cilësisë, me një qasje të qartë në monitorimin dhe pasqyrimin e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

⁵¹⁸ Aneks 199 -Raporti i NJSBC 2024 • Aneks 192 -Action Plan në përgjigje të Raportit NJSBC 2024

⁵¹⁹ <http://www.kulogos.edu.al/al/quality-assurance.html>

⁵²⁰ Aneks 196 -Lista e marrëveshje të partneritetit në funksion të programit të studimit

⁵²¹ Aneks 202 -Pjesëmarrja në simpozium

⁵²² Aneks 192 -Action Plan në përgjigje të Raportit NJSBC 2024 & Aneks 208 -Objektivat vjetore

⁵²³ Aneks 20 -Plani Strategjik në Programin Punë Sociale, Kolegji Universitar Logos

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	"Logos" përdor mekanizma dhe procese formale dhe të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin, dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit "Punë Sociale", duke i shërbyer kështu akreditimit të tij. Institucioni ka implementuar një proces vlerësimi që shërben për të evidencuar arritjet dhe dobësitë, motivuar praktikën dhe arritjet më të mira, dhe planifikuar masat për përmirësim⁵²⁴. Çdo vit akademik, institucioni harton një raport vjetor në rang institucioni, duke përfshirë monitorimin e implementimit të Planit Strategjik të institucionit. Raporti përfshin të dhëna të përfuara përmes analizës së informacioneve e të dhënave të Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë⁵²⁵. Ky raport paraqet format dhe mënyrat për përdorimin e mekanizmave për shqyrtimin, miratimin, dhe mbikëqyrjen e here pas here të programeve të studimeve. Proceset periodike për shqyrtimin, miratimin, dhe mbikëqyrjen herëpashere të programit të studimit Bachelor në "Punë Sociale" janë të dokumentuara në procesverbalet e mbledhjeve të departamentit⁵²⁶. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe komunikohen autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. Gjithashtu, ekziston një procedurë e dokumentuar për përmirësimin e kurrikulës, e cila përbën një dimension shtesë në procesin e përmirësimit të programit të studimit⁵²⁷. Këto praktika tregojnë përgjegjshmëri dhe përkushtim të vazhdueshëm ndaj cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulës në institucion Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, por edhe në një sërë dokumentesh që tregojnë anagazhimin e institucionit në hartimin e një plani strategjik⁵²⁸, i cili bazohet në investimin në cilësinë e mësimdhënies, me qëllim që procesi i transferimit të dijeve të jetë gjithnjë e më i harmonizuar me njohuritë më të përparura kombëtare dhe ndërkombëtare; në favorizimin e metodologjive të reja dhe mësimdhënia inovative, që e pozicionojnë studentin në qendër të procesit duke inkurajuar të

⁵²⁴ Aneks 150 -Raporti-Analike e institucioni i veprimtarisë financiare të KU "LOGOS" për vitin akademik 2023-2024.

⁵²⁵ Aneks 48 -Raport Vjetor për Veprimtarinë e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Kolegjit Universitar "LOGOS" për vitin Akademik 2023-2024

⁵²⁶ Aneks 42 -Procesverbal i mbledhjes së departamentit me ekspertin ndërkombëtar të punës sociale PhD Marita Flagrer

⁵²⁷ Aneks 73 -Email i Koordinatorës Drejtuar Pedagoqeve për Dorëzimin e Syllabuseve/ • Aneks 73/1 Procesverbal i DPP 27.08.2024

⁵²⁸ Aneks 13 -Plani Strategjik i Zhvillimit, 2018-2024 (Tiranë 2018) & Aneks 20 -Plani Strategjik në Programin Punë Sociale, Kolegji Universitar Logos

	menduarin kritik, përgatitjen për tregun e punës dhe promovimin e dialogut student-pedagog; si dhe në krijimin e një modeli të përmirësuar të garantimit të cilësisë së mësimdhënies.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Kolegji Universitar "Logos" përfshin elementët e nevojshëm në raportet e vlerësimit për programin e studimit "Punë Sociale". Raportet e vlerësimit⁵²⁹ përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, si dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë në vazhdim. Një nga mekanizmat për këtë është raportimi dhe përpunimi i rezultateve nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)⁵³⁰. Raporti i NJSBC⁵³¹ paraqet në mënyrë të qartë rezultatet e vlerësimit, përfshin pjesëmarrjen dhe sugjerimet e bëra, duke sjellë një analizë të hollësishme të performancës së programit të studimit "Punë Sociale" Këto sugjerime shërbejnë si bazë për departamentet për të ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e cilësisë në vijim. Përparësitë dhe sfidat identifikohen dhe shqyrtohen në mënyrë që departamentet të hapin diskutime mbi çështje pedagogjike dhe të gjejnë rrugët më efektive për të përmirësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien. Këto diskutime janë të dokumentuara në raporte të drejtuar Komisionit dhe Dekanit të Fakultetit. Këto raporte shërbejnë si një mjet për identifikimin e nevojave të trajnimit të personelit akademik dhe përmirësimin e proceseve pedagogjike në të ardhmen. Ky proces transparent dhe përfshirës kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit "Punë Sociale" në institucion. GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni dokumenton në formë shkresore rezultatet dhe raportet e vlerësimeve [DVV]; gjithashtu evidentohet se formati i raporteve të vlerësimit përfshin të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, rezultatet e arritura të studentëve, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, etj.

⁵²⁹ Aneks 111 -Raport për vlerësimin semestral të Lëndës

⁵³⁰ Aneks 174 -Raport Vjetor për Veprimtarinë e Fakultetit Viti Akademik 2022-2023, Kreu IX, fq. 11 & • Aneks 177 -Raport Akademik mbi Arritjet e Studentëve dhe Verifikimin e Saktësisë së të Dhënave 2022 2023

⁵³¹ Aneks 199 -Raporti i NJSBC 2024

Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion por dhe atë të aksesueshëm lehtësisht nga faqja Web e institucionit⁵³² në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, institucioni përdor disa metoda të drejtpërdrejta, këto metoda përfshijnë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësimin e didaktikës, vlerësimin e kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve⁵³³, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime rast pas rasti në leksione e seminare apo të standardizuara, si dhe është shumë i interesuar të ndjekë arritjet e studentëve të këtij programi edhe në rezultatet e testimeve ndërinstitutionale apo kombëtare, ku më i rëndësishmi është testi për marrjen e licensës së ushtrimit të profesionit punonjës social. Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta si anketime, intervista dhe vëzhgime, përfshirë përpunimet statistikore të të dhënave të grumbulluara⁵³⁴. Këto metoda janë të orientuara drejt vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies, performancës së pedagogut, krahasueshmërisë dhe qartësisë së tezave të provimeve, kurrikulave, të mësuarit dhe të nxënësve⁵³⁵. IAL-ja përdor metoda të drejtpërdrejta, rishikim të raporteve të akreditimit të programeve të mëparshme, shkrimi i raporteve të programeve të reja, raportet vjetore periodike. Grupi i punës në kryerjen e vlerësimit bazohet në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të syllabuseve nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësimit të pedagogëve⁵³⁶, studentëve si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, u konstatua se institucioni për kryerjen e vlerësimit përdor metoda e instrumente të ndryshme⁵³⁷ të tilla si: Vëzhgime dhe dëgjime në auditor⁵³⁸ si gjatë kryerjes së procesit mësimor ashtu dhe gjatë testimeve, pyetësori i studentëve, mentorimet e studentëve⁵³⁹, takimet në grup që zhvillohen nga drejtuesi i njësisë bazë. Instrumentat janë të hartuara në mënyrë të tillë që masin dhe vlerësojnë të gjithë komponentët e programit të
--	--

⁵³² <http://www.kulogos.edu.al/al/internal-evaluation.html>

⁵³³ Aneks 177 -Raport Akademik mbi Arritjet e Studentëve dhe Verifikimin e Saktësisë së të Dhënave 2022-2023; Aneks 178 -Raport Akademik mbi Arritjet e Studentëve dhe Verifikimin e Saktësisë së të Dhënave 2023 2024; Aneks 179 -Raport Analitik për Studentët

⁵³⁴ Aneks 100 -Formular vlerësimi nga studenti për mësimdhënien e secilit pedagog

⁵³⁵ Aneks 50 -Udhëzuesi individual për studentët AK, hartuar nga Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë

⁵³⁶ Aneks 100 -Formular vlerësimi nga studenti për mësimdhënien e secilit pedagog

⁵³⁷ Aneks 62 -Format i vlerësimit të stafit akademik

⁵³⁸ Aneks 153 -Procervat takimi me studentet

⁵³⁹ Aneks 65 -Vendim për emërim koordinatori

	studimit. Për të realizuar vlerësimin e programit “Punë Sociale” përdoren disa metoda të drejtëpërdrejta si vlerësimi i cilësisë së programit e provimeve, vëzhgimet në auditor nga titullarët e njësive bazë dhe njësive kryesore, rishikimi periodik i programit, vlerësimi i arritjeve në mësimdhënie, vlerësimi i arritjeve të studentëve⁵⁴⁰. GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, apo në dokumentacionin e shqyrtuar në DVV konstaton se ndër metodat e drejtëpërdrejta të përdorura nga institucioni përfshihen vlerësimet e drejtëpërdrejta nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare⁵⁴¹, rishikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore për secilën lëndë si dhe rishikimit të kurrikulave në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës apo edhe kërkesave të personelit akademik apo studentëve. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtëpërdrejta⁵⁴², si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të silabuseve nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësim të didaktikës përmes vlerësimit të stafit akademik nga një koleg me tituj, si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve.
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në	Kolegji Universitar "Logos" përdor metoda dhe instrumente të tërthorta vlerësimi për të vlerësuar realizimin, mbarëvajtjen dhe cilësinë e programit të studimit të ciklit të studimit BA “Punë Sociale”. Këto metoda dhe instrumente përfshijnë sondazhe dhe intervista me studentët, alumni (të diplomuar), personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, punëdhënësit, dhe institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit. KU "Logos" përdor metoda dhe instrumente të tërthorta vlerësimi⁵⁴³ për të vlerësuar realizimin, mbarëvajtjen dhe cilësinë e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Punë Sociale”. Këto metoda dhe instrumente përfshijnë takime informale⁵⁴⁴, sondazhe dhe intervista me studentët⁵⁴⁵, personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ,

⁵⁴⁰ Annex 182 -Email njoftimi për notën

⁵⁴¹ Aneks 105 -Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15)

⁵⁴² Aneks 188 -Raportim mujor me e mail prane Shefit te Depatamentit

⁵⁴³ Aneks 162 -Takime me studentet në hollin e KU Logos

⁵⁴⁴ Aneks 85 -Drejtuesi i Njësive Kryesore, Drejtuesi i Njësive Bazë dhe Rektori zhvillojnë takime me studentët

⁵⁴⁵ Aneks 181 -Proçesverbal ku ka firmosur Armando dhe margarita

realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	punëdhënësit, dhe institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit. Institucioni zhvillon dy pyetësore periodike për të vlerësuar performancën e stafit akademik dhe cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit. Përveç kësaj, pjesë e rëndësishme e procesit janë vlerësimet dhe sugjerimet nga bashkëpunëtorët e jashtëm⁵⁴⁶ të departamentit, pjesë e projekteve të të cilave ai është si dhe institucionet e realizimit të praktikës studentore⁵⁴⁷, të cilët janë një udhërrëfyes shumë i mirë në tregun e punës. Zyra e Këshillimit të Karrierës mbledh informacione dhe organizon takime periodike me studentët, duke siguruar një kanal të hapur për ata të shprehin sugjerime dhe vlerësime mbi procesin mësimor në Kolegjin Universitar "Logos". Po ashtu, Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë ruan kontaktet e ngushta me institucionet bashkëpunuese⁵⁴⁸, duke marrë raporte mbi performancën e studentëve në praktikë apo në punësim. Këto metoda dhe instrumente ofrojnë një perspektivë të pasur dhe holistike mbi cilësinë e programit të studimit dhe kontribuojnë në identifikimin e veprimeve për përmirësim të vazhdueshëm⁵⁴⁹. Këto sondazhe i vihen në dispozicion përgjegjësit të departamentit me qëllim reflektimin për të ardhmen. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi ku përfshihen pyetësorët dhe takimet fokus grup të realizuara me studentët⁵⁵⁰, të cilat zhvillohen në baza periodike dy herë në vit pyetësorë dhe fokus grupe. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet⁵⁵¹ që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program me qëllim përmirësimin e cilësisë. Vlerësohet puna e bërë nga institucioni në këtë drejtim.
---	--

⁵⁴⁶ Aneks 189 -E mail zyrtar nga Shefi i DPP mbi vizitat reciproke

⁵⁴⁷ Aneks 47 -Format vlerësimi i institucionit për praktikën mësimore

⁵⁴⁸ Aneks 52 -Raport i Vlerësimit të Trajnimit nga Universiteti Patrës, Athinë

⁵⁴⁹ Aneks 205 -Relacion mbi shqetësimet e shprehura nga studentët dhe vendimi për rinovimin e kontratës së pedagoges

⁵⁵⁰ Aneks 86 -Takim i studentëve me Prof As. Edo Sherifi

⁵⁵¹ <http://www.kulogos.edu.al/al/events.html> ; <http://www.kulogos.edu.al/al/employment-and-internship.html>



Konkluzione	<i>Kolegji Universitar "LOGOS" ka implementuar mekanizma dhe procese të dokumentuara për vlerësimin e programit të studimit, duke u përqëndruar në sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm.</i> <i>Proceset periodike për shqyrtimin, miratimin, dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit janë të dokumentuara dhe në procesverbalet e mbledhjeve të departamentit</i> <i>Institucioni përdor një kombinim të metodave të drejtpërdrejta dhe tërthorta për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe realizimit të objektivave të programit të studimit, duke përfshirë dhe feedback e studentëve si bazë për ndërmarrjen e veprimeve konkrete për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Kolegji Universitar "Logos" demonstroi një përkushtim të fortë ndaj sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit, siç tregohet përmes politikave të strukturuar dhe dokumenteve të miratuara, përfshirë Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë ⁵⁵² , Planin e Zhvillimit ⁵⁵³ , Politikën e Sigurimit të Cilësisë ⁵⁵⁴ dhe instrumentet e miratuara ⁵⁵⁵ . Përdorimi i instrumenteve të miratuara, si sondazhe, intervista, dhe vlerësime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, tregon një përqendrim të qëllimshëm në vlerësimin dhe adresimin e cilësisë së mësimdhënies. Përveç kësaj, përfshirja e aktorëve të ndryshëm, si personeli akademik, studentët, dhe alumni, përmes pyetësoreve dhe takimeve periodike, përbën një qasje

⁵⁵² Aneks 101 -Rregullore e Komisionit të Garantimit të Standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit; Aneks 151 -Rregullore për Njësinë e Sigurimit e Brendshëm të Cilësisë të Standardeve.

⁵⁵³ Aneks 13 -Plani Strategjik i Zhvillimit, 2018-2024 (Tiranë 2018)

⁵⁵⁴ Aneks 186 – Politika për Sigurimin e Cilësisë

⁵⁵⁵ Aneks 62 -Format i vlerësimit të stafit akademik; Aneks 100 -Formular vlerësimi nga studenti për mësimdhënien e secilit pedagog; Aneks 47 -Format vlerësimi i institucionit për praktikën mësimore

	të hapur dhe të përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë, të cikën GVJ e konsideron si praktikë të mirë. KU “Logos”, konform detyrimeve ligjore bën përpjekje që të parashikojë dhe garantojë politika dhe procedura që sigurojnë rritjen e brendshme të cilësisë⁵⁵⁶, kjo duke përfshirë edhe aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit⁵⁵⁷. Nga informacioni i paraqitur në DVV dhe në raportin e GVB-së, si dhe në atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni garanton dhe bashkëpunon me ekspertë të jashtëm duke ruajtur dhe mbajtur në konsideratë përmirësimin e vazhdueshëm të parametrave të cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni ka një qasje të caktuar në përcaktimin e përgjegjësi dhe detyrave për të gjithë aktorët e përfshirë në sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Përmes parashikimeve dhe akteve rregullatore, Institucioni përcakton rolin e njësitë, individëve dhe studentëve, të cilët janë të përfshirë në hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm⁵⁵⁸ për programet e studimit. Kjo qasje ndihmon në organizimin e njësisë së përgjegjshme për përpilimin e raporteve, duke siguruar që të gjithë aktorët të kenë detyra dhe përgjegjësi të qarta në procesin e vlerësimit të cilësisë. Kjo gjithashtu mundëson që vendimet për ngritjen e grupeve të punës të merren në përputhje me aktet rregullatore dhe të sigurohet një koordinim efikas në drejtim të sigurisë së cilësisë. KU “Logos” është angazhuar në ruajtjen e standarteve dhe cilësisë dhe në funksion të përmirësimit të programeve të studimit, për këtë ajo bazohet tek indikatorët që përcillen nga njësitë, ku edhe Komisioni i Cilësisë⁵⁵⁹ ka si indikatorë parësorë monitorimin semestral dhe respektimin e Kalendarit Akademik⁵⁶⁰, vlerësimin e pedagogut dhe lëndës nga studenti; fokus grupet e studentëve të të gjitha viteve dhe programeve, takimet me Këshillin studentor si dhe kontakti i vazhdueshëm me ta. Këta indikatorë përdoren si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve dhe cilësisë dhe gjithashtu miratohen nga rektorati si dhe zhvillohen në bazë të udhëzimeve të miratuara

⁵⁵⁶ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS; Aneks 9 -Rregullore për organizimin e programit të studimeve “Punë Sociale”, Nëntor 2022 ; Aneks 20 -Plani Strategjik në Programin Punë Sociale, Kolegji Universitar Logos

⁵⁵⁷ Aneks 19 -Lista e marrëveshjeve në programin Punë Sociale

⁵⁵⁸ Shkresa ASCAL njoftim GVB _ akreditim 5 prog. 2024 pdf

⁵⁵⁹ Aneks 101 -Rregullore e Komisionit të Garantimit të Standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit, neni 16-18.

⁵⁶⁰ Aneks 40 -Kalendari i Aktiviteteve të Departamentit Pedagogji dhe Psikologji

	prej tij. Detyrat dhe përgjegjësitë e secilit individ të përfshirë nga institucioni për sigurimin e cilësisë bëhen të qarta në aktet rregullative të NJSBC⁵⁶¹ dhe udhëzimet për procese të caktuara. GVJ konkludon se referuar planit të zhvillimit strategjik⁵⁶² dhe rregullores për funksionimin e brendshëm të cilësisë (NJSBCZHK) dhe përmes shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga informacioni i paraqitur në DVV dhe atë të siguruar në takimet gjatë vizitës në institucion, detyrat dhe përgjegjësitë konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të përfshira në çështjet e cilësisë janë të parashikuara në kuadrin rregullor⁵⁶³ të cilësisë,
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Në kontekstin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit Bachelor në Punë Sociale, përfshirja e anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentëve në këtë proces është një aspekt pozitiv. Kjo përfshirje shërben për të pasqyruar një perspektivë të gjerë dhe të diversifikuar mbi cilësinë e programit në nivelin e Departamentit dhe Fakultetit. Grupi i punës, i cili është i përbërë nga pesw anëtarë, është një nismë pozitive për të kryer vlerësimin e cilësisë (Shkresa Nr.236/2Prot, datw 19.07.2024)⁵⁶⁴. Në përbërjen e grupit të vlerësimit të brendshëm janë të përfshirë anëtarë të personelit akademik, administrativ dhe studentë. Njësia ka kërkuar bashkëpunimin e përfaqësuesëve të studentëve për pjesëmarrje të lartë në takimet e tutoriatit si dhe sensibilizim të studentëve për të qenë sa më aktiv në jetën studentore. Departamenti është përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë përmes mbështetjes me informacione dhe akses në të gjitha dokumentat që disponon, grupit të vlerësimit të brendshëm. Personeli ndihmës akademik e administrativ ka mbështetur punën e grupit të vlerësimit të brendshëm përmes informacionit dhe statistikave që lehtësojnë procesin. Nga takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion me stafin akademik, administrativ dhe studentë, ata konfirmojnë se vetë ata realizojnë dhe janë pjesëmarrës në hartimin dhe plotësimin

⁵⁶¹ Aneks 151 -Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Cilësisë të Standarteve

⁵⁶² Aneks 13 -Plani Strategjik i Zhvillimit, 2018-2024 (Tiranë 2018)

⁵⁶³ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS; Aneks 13 -Plani Strategjik i Zhvillimit, 2018-2024 (Tiranë 2018); Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017.

⁵⁶⁴ Aneks 206 -Vendim për Ngritje Komisioni të Akreditimit të Punë Sociale; & Aneks 207 -Vendimi Dekani për ngritje GVB 2024

	e pyetësorve dhe takime me studentët, ndërkohë që kjo evidentohet edhe në vlerësimin e sturukturuar ⁵⁶⁵ .
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Proçesi i përfshirjes dhe aktivizimit të aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit, duke patur parasysh nevojën për respektimin e integritetit akademik dhe shmangien e diskriminimit apo pabarazisë ndaj personelit dhe studentëve është i një rendësie të veçantë. Institucioni, sipas Rregullores së Kolegjit Universitar "Logos"⁵⁶⁶, Statutit të institucionit⁵⁶⁷ dhe Kodi i Etikës⁵⁶⁸, ka vepruar në përputhje me këto udhëzime për të rregulluar dhe mbrojtur integritetin akademik, duke ndërmarrë hapa për të parandaluar çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. Në veçanti, përfshirja e anëtarëve të ndryshëm të stafit akademik, administrativ dhe studentëve në grupe pune të ndryshme, duke u siguruar që secili të ketë mundësinë për t'u përfaqësuar, shërben si shembull konkret i kësaj përpjekjeje për të garantuar një mjedis të barabartë dhe të drejtë për të gjithë. Kjo praktikë tregon përkushtimin ndaj diversitetit dhe ndërtimin e një mjedisi të hapur ku çdo individ ka mundësinë të kontribuojë në proceset ciklike të vlerësimit. Në vlerësim të këtij kuadri rregullator dhe të cilësisë së këtij institucioni, dhe takimeve të realizuara në institucion konfirmojmë se ky institucion respekton integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve, duke garantuar pjesëmarrje të drejtë dhe sigurisht duke ju mundësuar instrument të adresimit të shqetësimeve. Personeli akademik i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit⁵⁶⁹ nuk ushtron detyra në pozicione drejtuese në institucion dhe janë figura me integritet në njësinë bazë. Ky institucion i kushton vëmendje edhe diferencave gjinore duke shprehur angazhim në shmangien e pabarazive dhe diskriminimit edhe në këtë fushë⁵⁷⁰. Gjithashtu edhe përfshirja e studentëve të nivelit bachelor në këtë proces është në funksion të respektimit të integritetit dhe barazisë ndaj personelit dhe studentëve.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë,	Ky kriter thekson rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Në rastin e Kolegjit Universitar "Logos," ky

⁵⁶⁵ [5_Raporti i Vlerësimit të Brendshëm pdf](#)

⁵⁶⁶ Aneks 14 -Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar LOGOS, Qershor 2017

⁵⁶⁷ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

⁵⁶⁸ Aneks 72 -Kodi i Etikës i Kolegjit Universitar "Logos"

⁵⁶⁹ Aneks 207 -Vendimi Dekani për ngritje GVB 2024

⁵⁷⁰ Aneks 84 -Të dhëna mbi mobilitetin e stafit & studentëve

duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	angazhim shprehet përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të rëndësishme ndërkombëtare, si Universiteti i Selanikut, Universiteti i Pireut, dhe Universiteti i Trakës. Përmes këtyre marrëveshjeve, pedagogë nga këto universitete ofrojnë ekspertizën e tyre dhe japin mendimet e tyre mbi programin e studimit, cilësinë e studentëve, dhe shërbimet e ofruara. Ky mekanizëm shërben si një burim i vlerësimit objektiv dhe ekspertizës së jashtme për programin, duke sjellë një perspektivë të pasur dhe të diversifikuar që mund të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Përfshirja e këtyre bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm mund të sjellë një përparim të qëndrueshëm dhe një shkëmbim të vazhdueshëm të njohurive dhe praktikave të mira në nivel ndërkombëtar. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm apo bashkëpunëtorëve të ndryshëm, me të cilët institucioni bashkëpunon është realizuar për procese të veçanta, siç janë aktivitetet dhe praktika e punës së institucionit, apo bashkëpunimet me universitete dhe kolegë të bashkëpunimeve të huaja⁵⁷¹, dhe kjo shihet si një mundësi e mirë e vlerësimit, por dhe e përmirësimit dhe përshtatjes me kërkesat e bashkëpunëtorëve të huaj, duke mundësuar realizimin e vlerësimit tërësor të programit nga ekspertë të jashtëm⁵⁷². Vijueshmëria e bashkëpunimeve shihet si një standard i cilësisë dhe marrja e mendimeve dhe e vlerësimeve nga ana e tyre kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë edhe të këtij programi studimi.			
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar "Logos" vazhdon të denonstrojë përkushtimin e tij ndaj sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë në programet e studimit, duke implementuar politika të strukturuar dhe dokumente të miratuara, si dhe duke hibridizuar metodat dhe aktorët e përfshirë në process.</i> <i>Bashkëpunimi me institucione të rëndësishme ndërkombëtare dhe angazhimi i pedagogëve nga këto institucione ofron një perspektivë të pasur ndërkombëtare dhe ekspertizë të huaj.</i> <i>Përfshirja e aktorëve të ndryshëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë shpreh përkushtimin ndaj diversitetit dhe ndërtimin e një mjedisi të hapur dhe të barabartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

⁵⁷¹ Aneks 198 -Email me Prof. As Marita Flagrer

⁵⁷² Aneks 42 -Procesverbal i mbledhjes së departamentit me ekspertin ndërkombëtare të punës sociale PhD Marita Flagrer

				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Kolegji Universitar "Logos" garanton transparencën në politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit. Ky angazhim është shprehur përmes publikimit të dokumenteve kyçe, duke përfshirë Statutin dhe Rregulloren, në faqen zyrtare të institucionit. Përtej kësaj, vendimet e marra nga organet kryesore të institucionit, si Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, gjithashtu janë bërë publike. Kjo transparencë siguron që studentët dhe të gjithë të interesuarit të kenë akses të drejtpërdrejtë në informacionin relevant dhe të jenë në dijeni të strukturës, proceseve dhe politikave që ndikojnë në cilësinë e programit të studimit. Publikimi i këtyre dokumenteve thekson përkushtimin ndaj hapësirës së informacionit dhe dialogut të hapur, duke krijuar një mjedis të besueshëm dhe të qartë për të gjithë. Veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe të drejtuara nga Kodi i Cilësisë⁵⁷³. Politikat e institucionit⁵⁷⁴ në drejtim të mbështetjes dhe krijimit të lehtësirave në realizimin e një sërë veprimtarish të mbledhjes së informacionit në funksion të realizimit të një procesi korrekt të vlerësimit të brendshëm e të jashtëm lehtësisht të aksesueshëm⁵⁷⁵. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë transparente dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen online të Kolegjit Universitar "Logos"⁵⁷⁶.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe	Kolegji Universitar "Logos" demonstroi angazhimin për transparencë në publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programeve të studimit. Faqja zyrtare e institucionit është në dispozicion të publikut, duke përfshirë studentët dhe të gjithë të interesuarit dhe ju ofron informacion mbi rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit. Kjo praktikë është në përputhje me lirinë dhe etikën akademike, duke garantuar që

⁵⁷³ Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me VKM Nr.824, datë 24.12.2021

⁵⁷⁴ <http://www.kulogos.edu.al/al/quality-assurance.html>

⁵⁷⁵ <http://www.kulogos.edu.al/al/external-evaluation.html>

⁵⁷⁶ Aneks 143 -<http://www.kulogos.edu.al/al/index.html>; Aneks 144 -Evidenc perdorimi Edupage/Teams; Aneks 145 -foto te insta fcb.]

legjislaconin për të dhënat personale.	informacioni të jetë i lirë dhe i hapur për të gjithë ata që kanë interes në cilësinë e programeve të studimit në institucion. Për të ruajtur integritetin akademik dhe për të përmbushur kërkesat legislative për mbrojtjen e të dhënave personale, Kolegji Universitar "Logos" punon në përputhje me legjislaconin për të dhënat personale⁵⁷⁷. Ky angazhim është shfaqur në publikimin⁵⁷⁸ e rezultateve të akreditimit institucional dhe ka për qëllim vazhdimin e kësaj praktike edhe për programin Bachelor në "Punë Sociale". Pas përfundimit të procesit të akreditimit, pritet që rezultatet të bëhen publike në mënyrë transparente dhe në përputhje me kriteret e cilësisë akademike.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Kolegji Universitar "Logos" trgon një përkushtim konkret për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit përmes hartimit dhe zbatimit të Planit të Zhvillimit të Departamentit dhe atë të programit të studimit "Punë Sociale"⁵⁷⁹. Ky plan ka si synim adresimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara, duke u fokusuar në përmirësimin e cilësisë për të gjithë aktorët e përfshirë në departament, si studentët dhe stafi akademik. Kjo praktikë shpreh përkushtimin e institucionit ndaj përmirësimit të vazhdueshëm dhe është një hap i rëndësishëm drejt cilësisë së lartë akademike. Duke hartuar dhe implementuar planin e zhvillimit, Kolegji Universitar "Logos" demonstroi një qasje sistematike për të trajtuar sfidat dhe për të avancuar në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm. Kjo përfshirje dhe përkushtim ndaj përmirësimit të cilësisë reflektohen në dokumentet zyrtare, konkretisht në planin e veprimit në përgjigje të raportit të NJSBC⁵⁸⁰. Grupi i vlerësimit të brendshëm ka paraqitur rezultatet e vlerësimit të tij për këtë program studimi. Në përmbyllje të raportit të tij ka një analizë mbi pikat e forta dhe afirmimet dhe pikat e dobëta. Ka një tendencë për t'u fokusuar në evidentimin e pikave të forta dhe afirmimet më tepër, dhe përse i përket sugjerimeve për masat që mund të ndërmerren në drejtim të pikave të dobëta mendojmë se mbeten të paqarta format sesi mund të ndihmohet njësia bazë dhe kryesore, por edhe institucioni për të përmirësuar ato në të ardhmen.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin	Kolegji Universitar "Logos" vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë, të cilat synojnë përmirësimin e

⁵⁷⁷ Aneks 193 -Email i Dekanit për njoftimin e stafit mbi rezultatet e Raportit të Vlerësimit të NJSBC

⁵⁷⁸ <http://www.kulogos.edu.al/al/external-evaluation.html>

⁵⁷⁹ Aneks 20 -Plani Strategjik në Programin Punë Sociale, Kolegji Universitar Logos

⁵⁸⁰ Aneks 87 -Plani i veprimit në përgjigje të raportit të NJSBC

e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Institucioni ka identifikuar dhe paraqitur disa shembuj konkrete nga Departamenti Pedagogjisë dhe Psikologjisë. Në këtë kontekst, disa veprimtari pozitive të Departamentit përfshijnë përmirësimin e kurrikulës mësimore⁵⁸¹, punësimin e pedagogëve të rinj të kualifikuar, zgjerimin e infrastrukturës për mësimdhënie dhe praktika laboratorike, mundësimin e mobilitetit të stafit dhe studentëve në universitete partnere ndërkombëtare për trajnim, pasurimin e fondit të bibliotekës⁵⁸² me literaturë në shërbim të programit mësimor, si dhe përmirësimin e dokumentacionit rregullator për të rritur efikasitetin e procesit mësimor. Ky angazhim për të vlerësuar dhe përmirësuar metodat dhe instrumentet e vlerësimit shërben për të garantuar një cilësi të lartë në ofrimin e programeve të studimit. Institucioni në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë⁵⁸³, krijon grupin përmes delegimit të përgjegjësisë, strukturave përgjegjëse dhe mbështet punën e grupit përgjatë kryerjes së detyrës. Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë pas përfundimit përdoret nga vetë institucioni⁵⁸⁴ për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Ashtu sic ndërmerren reagime nga ana e njësisë bazë në lidhje me pikat e dobëta të evidentuara nga grupi i vlerësimit të brendshëm
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Kolegji Universitar "Logos" organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Nëpërmjet dokumentacionit të shqyrtuar dhe diskutimeve nga takimet me NJSBC, bëhet e ditur se institucioni ka vendosur praktikën e takimeve periodike me stafin akademik, ndihmësakademik dhe studentët. Këto takime shërbejnë për të informuar pjesëmarrësit në lidhje me arritjet e institucionit dhe rekomandimet që duhet të zbatohen për të përmirësuar cilësinë e institucionit në përgjithësi dhe cilësinë e programeve të studimit në veçanti. Kjo përfshirje aktive dhe informimi i pjesëmarrësve ka rëndësi të veçantë në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë. Këto informacione dhe komunikime janë dokumentuar në materiale të veçanta, përfshirë anekset e komunikimeve me

⁵⁸¹ Aneks 44-Sylabuse 2023-2024 dhe Aneks 70-Sylabet dhe Plani Mesimor 2024-2025

⁵⁸² Aneks 80 -Email nga biblioteka mbi pasurimin e listës së librave për Punë Sociale

⁵⁸³ Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me VKM Nr.824, datë 24.12.2021

⁵⁸⁴ <http://www.kulogos.edu.al/al/internal-evaluation.html>

	NJSBC dhe mbledhjet e departamenteve⁵⁸⁵. Angazhimin e stafit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë e kërkon baza ligjore në funksion të cilësisë në mësimdhënie si edhe nga rregulloret⁵⁸⁶ e KU "Logos" dhe statutit⁵⁸⁷, një sër strukturash të ngritura me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e brendshëm të cilësisë përfshijnë në përbërje të tyre (NJSBC). Të gjitha këto struktura që monitorojnë dhe dokumentojnë gjetjet e tyre, i ndajnë me strukturat e tjera me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit⁵⁸⁸.			
Konkluzione	<i>Kolegji universitar "LOGOS" demonstroi përkushtimin e tij ndaj transparencës dhe sigurimit të cilësisë në programet e studimit, duke publikuar dokumente kyçe, përfshirë statutin, rregulloren, dhe vendimet e organit kryesor, në faqen zyrtare të tij.</i> <i>Faqja zyrtare e institucionit ofron informacion të përditësuar mbi rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit.</i> <i>Bashkëpunimi me institucione të rëndësishme ndërkombëtare dhe përfshirja e ekspertëve të jashtëm, ndërmjet të tjerash shërbejnë dhe si burime të krijimit të kulturës së brendshme të cilësisë institucionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

⁵⁸⁵ Aneks 193 -Email i Dekanit për njoftimin e stafit mbi rezultatet e Raportit të Vlerësimit të NJSBC

⁵⁸⁶ Aneks 13 -Plani Strategjik i Zhvillimit, 2018-2024 (Tiranë 2018); Aneks 20 -Plani Strategjik në Programin Punë Sociale, Kolegji Universitar Logos

⁵⁸⁷ Aneks 1 -Statuti i Kolegjit Universitar LOGOS

⁵⁸⁸ Aneks 150 -Raporti-Analike e institucioni i veprimtarisë financiare të KU "LOGOS" për vitin akademik 2023- 2024. • Aneks 151 -Rregullore për Njësinë e Sigurimit e Brendshëm të Cilësisë të Standardeve

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Punë Sociale"

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Praktika të mira, të ndërmarra nga institucioni në drejtim të përfshirjes së stafit akademik dhe ofrimit të mundësive ndaj studentëve në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;
2. Praktika të mira, të ndërmarra nga institucioni në drejtim të mbështetjes me bursa të studentëve nga grupet vulnerabël dhe ofrimit jo vetëm të një mjedisi mbështetës, por dhe të përshtatjes së programeve sipas nevojave të studentëve;
3. Rritja e ndërveprimeve dhe shumëfishimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit në drejtim të praktikave profesionale të studentëve në një numër të gjerë fushash dhe drejtimesh edhe për këtë program studimi;
4. Mbështetja me bursa studimi dhe përfshirja në jetën akademike e studentëve me nevoja të veçanta;
5. Klima pozitive në komunikimin midis stafit akademik dhe studentëve të këtij programi studimi dhe mbështetja e tyre në një sër aktivitetesh ekstrakurrikulare;

b. Pika të dobta:

1. Personeli akademik i programit Bachelor në "Punë Sociale" edhe pse ka tituj akademikë dhe gradë shkencore në përputhje me kuadrin ligjor aktual, megjithatë duke qenë nga profile të ndërmjetme, mund të ndodhin kufizime në ekspertizën e tyre në disiplinën punë sociale, që mund të ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies dhe përmbushjen e objektivave programore; (*Standarti I.1, kriteri 4; Standarti IV.1, kriteri 1;*)
2. Konstatohet se literatura nuk është e gjitha në gjuhën shqipe, siç dhe është detyrimi ligjor, si dhe nuk është plotësisht e përditësuar me literaturën e fundit bashkëkohore në fushën e punës sociale; (*Standarti IV.3, kriteret 1,2,4;*)
3. Konstatohen raste të titullarëve të lëndëve me gradë shkencore "Doktor", në kundërshtim me kuadrin ligjor, që duhet të jenë të kategorisë "Profesor"; (*Standarti IV.1, kriteri 1;*)

Rekomandime:

1. Përzgjedhja e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi duhet të jetë masivisht e profilit të kualifikimit në punë sociale për të gjithë lëndët bazë (tipi A) dhe ato karakterizuese (tipi B) dhe vetëm për lëndët ndërsisiplinore apo integruese (tipi C) dhe ato plotësuese (tipi D) mund të punësohet staf i cili ka kualifikimet e shkencave të tjera, të përafërta sociale dhe psikologjike dhe ata të jenë në raporte më të ulta, më qëllim që të jenë në gjendje të zhvillojnë kompetenca profesionale dhe shprehi pune tek studentët në linjë me profilin për të cilin po studiojnë;
2. Titullarët e angazhuar në hartimin e syllabuseve të lëndëve mësimore duhet t'i përkasin kategorisë "Profesor," në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë, me qëllim që të ndihmojnë në sigurimin e cilësisë së lartë të mësimdhënies dhe në përmbushjen e detyrimeve

ligjore për një kornizë akademike cilësore në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Punë Sociale" në Kolegjin Universitar "Logos";

3. Institucioni të mbajë në vëmendje përmirësimin e syllabuseve duke rishikuar shpërndarjen e krediteve në raport me format e mësimdhënies si dhe rishpërndarjen më të mirë duke rikualifikuar dhe shtuar peshën specifike të disiplinave bazë dhe karakterizuese;
4. Njësia bazë të rrisë vëmendjen në drejtim të monitorimit të syllabuseve mësimore duke treguar kujdes në mënyrën sesi harmonizohen temat mësimore të trajtuara në lëndë të ndryshme në linjë me emërtimin e lëndës dhe fokusin e saj, gjithashtu përdorimi i literaturës në gjuhën shqipe dhe të huaj, të përditësuar të përfshijë disa element sigurie që ruajnë standardet e cilësisë së njohurive akademike që u ofrohen studentëve;
5. Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë duhet të realizojë një analizë tregu të mirëfilltë bazuar në interesin për këtë program studimi duke aplikuar dhe analizuar instrumentë të ndryshëm;
6. Në rregulloren e departamentit sygjerohehet të përcaktohet dhe njohja e programit nga Urdhri i Punonjësit Social, pasi tashmë kemi të bëjmë me një profesion të rregulluar;

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Social Work"

a. Strengths and affirmations:

1. Very good practices undertaken by the institution in terms of involving academic staff and providing opportunities to students for engagement in national and international projects;
2. Very good practices undertaken by the institution in terms of supporting students from vulnerable groups with scholarships and providing not only a supportive environment, but also innovation in adapting programs to the needs of students;
3. Increasing interactions and collaboration in multiplying cooperation agreements, not only in terms of professional practices for students in a wide number of fields and directions, but also for academic study program;
4. Supporting students with special needs with scholarships and including them in the academic life;
5. Positive climate in communication between academic staff and students of this study program and supporting them in a series of extracurricular activities;

b. Weaknesses:

1. The academic staff of the Bachelor's program in "Social Work", although have academic titles and scientific degrees in accordance with the current legal framework, do not have them specifically in social work, and being from intermediate profiles, there may be limitations in expertise in the social work discipline, which may affect the quality of teaching and the fulfilment of program objectives; (*Standard I.1, criterion 4; Standard IV.1, criterion 1;*)



2. It is noted that the compulsory literature for some of the courses is not all in Albanian language, as is the legal obligation, and is not fully updated with the latest contemporary literature in the field of social work; (*Standard IV.3, criteria 1,2,4;*)
3. There are cases where approve instructors for syllabus course are with the scientific degree "Doctor", contrary to the legal framework, which should be in the category "Professor"; (*Standard IV.1, criterion 1;*)

Recommendation

1. The enrolment of academic staff engaged in this study program must be massively of social work profile qualification for all basic subjects (type A) and characterizing ones (type B) and only for interdisciplinary or integrative subjects (type C) and complementary ones (type D) can be employed staff who have qualifications in similar fields, related to social and psychological sciences and they should be in lower ratios; in order to be able to develop professional competencies and work habits for students in line with the profile for which they are studying;
2. Academic authorities' and instructors of department, engaged in the drafting and approving course syllabus, must belong to the category "Professor," in accordance with Law 80/2015 of Higher Education, in order to ensure the high quality of teaching and to fulfil the legal obligations for a qualitative academic framework for the first cycle Bachelor's study program in "Social Work" at the College University "Logos";
3. The institution should pay attention in reviewing and improving syllabus by reallocation the distribution of credits in relation to the lessons components as well as the best redistribution by requalifying and increasing the specific weight of the basic and characterizing type disciplines;
4. The basic unit (Department) should increase its attention towards monitoring the teaching syllabus by showing care in the way the way that how are teaching topics covered in different subjects, and how they are harmonized in line with the subject name and its focus; also by monitoring the use of literature in Albanian and foreign languages, maybe by including some security elements that maintain the quality standards of academic knowledge offered to students;
5. The Department of Pedagogy and Psychology should conduct a proper social worker labour market study based on the interest in this study program by applying and analysing different instruments;
6. The department's regulation suggests that the program be recognized by the Order of Social Workers, as we are already dealing with a regulated profession;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X


